



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13, 14, 20 SHTATOR DHE 15 TETOR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13, 14, 20. SEPTEMBRA I 15. OKTOBRA 2018. GODINE**

**SHTATOR/TETOR - SEPTEMBAR/OKTOBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Votimi i Raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,
5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë,
6. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë,
7. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
8. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”,
9. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS+” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport,
10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferë,
11. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,
12. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,
13. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor,
14. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor,
15. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës,
20. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike,
23. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare,

24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
25. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
26. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017,
27. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,
28. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017.
29. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017,
30. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017,
31. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017,
32. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017,
33. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017,
34. Propozim-rezoluta e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë (7) deputetë të GP të AAK-së, në lidhje me çështjen liberalizimi i vizave para dialogut,
35. Propozim-vendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore,
36. Propozimi i grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
37. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit të RTK-së,
38. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për (1) një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,
39. Propozimi për zëvendësimin e dy (2) anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës,
40. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues nga GP i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Glasanje Godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2017.godinu.,
5. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/ L-010 o javnom beležniku,
6. Glasanje Predlog - rezolucije sa parlamentarne debate o dijalogu sa Srbijom,
7. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-090 o ratifikaciji Finansijskog sporazuma za IPA 2017, prvi deo, između Kosova i Evropske unije,
8. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-094 o ratifikaciji Sporazuma između Kosova i Evropske unije o učešću Kosova u program “Evropa za građane”,
9. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-095 o ratifikaciji Sporazuma između Evropske unije i Kosova o učešću Kosova u “ERASMUS+” Program unije za obrazovanje, obuku, omladinu i sport,
10. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-066 o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-064 o vozačkoj dozvoli,
11. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-067 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-063 o železnicama Kosova,
12. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-068 o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/11 o putevima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 03/L-120,
13. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-069 o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-088 o pravilima drumskog saobraćaja,
14. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-070 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-179 o drumskom transportu,
15. Drugo glasanje Nacrta zakona br. 06/L-071 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-183 o drumskom transportu opasne robe,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka,
17. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-065 o razmatranju i proveru neopravdane imovine,
18. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmenu neokretne imovine opštine,
19. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-084 o zaštiti deteta,
20. Drugo razmatranje Nacrta zakonika br. 06/L-006 o pravdi maloletnika,
21. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-059 o memorijalnom kompleksu “Adem Jashari” u Prekazu,
22. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-035 o hidrometeorološkoj delatnosti,
23. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-038 o poštanskim uslugama,

24. Drugo razmetanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
25. Drugo razmatranje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
26. Razmatranje Godišnjeg izveštaja regulativnog autoriteta za vode za 2017,
27. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o performansi Nacionalne kancelarije za reviziju za 2017,
28. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulativnog autoriteta za elektronske i poštanske komunikacije za 2017,
29. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Fonda za penzijsku štednju Kosova za 2017,
30. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Radiotelevizije Kosova za 2017,
31. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulativnog autoriteta za železnice za 2017,
32. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Centralne Banke Republike Kosovo za 2017,
33. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Autoriteta za civilnu avijaciju za 2017,
34. Predlog rezolucija poslanice Donika Kadaj - Bujupi, uz podršku sedam (7) poslanika PG – AAK u vezi pitanja liberalizacije viza, pre dijaloga,
35. Predlog - odluka Komisije za budžet i finansije za određivanje plate predsedavajućeg i članova Komisije za državnu pomoć,
36. Predlog parlamentarnih grupa AAK i Nisma za zamenu članova pri parlamentarnim komisijama,
37. Izbor tri (3) člana Odbora Radiotelevizije Kosova,
38. Formiranje Komisije Ad-hoc za izbor kandidata za jednog (1) člana Odbora RTK-a iz albanske zajednice,
39. Predlog za zamenu dva (2) člana Parlamentarne istražne Komisije u vezi troškova za lobiranje od strane Kancelarije predsednika i Vlade Republike Kosova,
40. Parlamentarna debata, na zahtev poslanice Donika Kadaj-Bujupi, uz podršku sedam (7) poslanika PG - AAK u vezi dečijih dodataka.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht seancën plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 6 shtator 2018.

A jemi 61 deputetë, po. Së pari e hap seancën, 61-62 deputetë janë, mirë është, ka kuorum.

A vazhdojmë, po shoh se disa kolegë deputetë po vijnë. 75 deputetë janë në sallë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Edhe një herë, po e përsëris, kur e kërkon fjalën, pasi nuk keni paralajmëruar tregoni a e kërkon në emër të grupit parlamentar apo në emrin personal, për shkak të kohës gjithmonë.

Atëherë, 30 minuta, ora është 10:27, vazhdojmë. Në emër të grupit parlamentar, Avdullah Hoti e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Opozita ka kërkuar një seancë të jashtëzakonshme para dy javësh, tanimë, me një qëllim të vetëm që çështja e kufirit të mos bisedohet në dialogun me Serbinë, sepse sipas mendimit tonë, sipas mendimit të ekspertëve, edhe të miqve ndërkombëtarë, plot miqve ndërkombëtarë, kjo do të përbënte zhbërje të shtetit të Kosovës dhe rishikim komplet të shtetësisë së Kosovës.

Me këtë seancë ne kemi propozuar miratimin e një rezolute, e cila do t'ia ndalonte presidentit të bisedojë për këtë çështje në dialogun me Serbinë dhe, mbi të gjitha, do të dërgonte sinjal të qartë te miqtë tanë ndërkombëtarë në Bruksel dhe gjithandej që qytetarët e Kosovës, përmes përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Kosovës nuk dëshirojnë që kjo çështje të diskutohet me dialogun me Serbinë.

Ne vlerësojmë që veprimet e presidentit janë kundërkushtetuese, shumica dërmuese e deputetëve këtu në Kuvend e kanë shfaqur këtë, përfshirë edhe disa grupe parlamentare nga koalicioni qeverisës.

Unë ju ftoj, kryetar i Kuvendit, që të thirrni seancën e jashtëzakonshme sipas kërkesës së opozitës. Nuk është në rregull që të mbahet asnjë seancë tjetër e rregullt e Kuvendit të Kosovës, për pika të rregullta të Kuvendit të Kosovës, pa u kryer seanca e jashtëzakonshme.

Në mbledhjen e Kryesisë ju keni kërkuar që ne të sigurojmë 61 deputetë në sallë për të mbajtur një seancë të jashtëzakonshme, unë mendoj që kjo kërkesë juaja është kundërkushtetuese. Krejt çfarë mund të bëjë opozita është të mbledhë së paku 40 nënshkrime, të kërkojë seancën e jashtëzakonshme dhe në atë kohë që kërkohet mbahet mbledhja e Kuvendit dhe ju si shumicë parlamentare të vini aty, nëse keni vota ta rrëzoni atë rezolutë, ose ta votoni. Nuk është diskrecion juaj që të ftoni ose jo seancën e Kuvendit sipas kërkesës së opozitës.

Me këtë formë të veprimit ju e keni bllokuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme dhe punimet e këtij Kuvendi dhe në shenjë të saj, ne nuk do të marrim pjesë në këtë seancë të rregullt pa u kryer seanca e jashtëzakonshme e kërkuar nga opozita.

Unë ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i bashkohen këtij veprimi të grupit tonë parlamentar për të siguruar që ky Kuvend fillimisht të miratojë këtë rezolutë, të heqë nga rend i ditës nga dialogu çështjen e kufijve dhe pastaj t'i kthehemi punës normale të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për fat të keq, java e kaluar, siç e dimë të gjithë, kaloi me tentim mbajtje të seancave të jashtëzakonshme dhe atë në mënyrë të pasuksesshme si nga opozita, me seancën e jashtëzakonshme që e kërkuam, sikur nga koalicioni qeverisës, me seancën e ftuar nga kryeministri dhe Qeveria.

Ne jemi në një situatë ku, për fat të keq, bojkoti që u iniciua nga deputetët e opozitës e ka sjellë një momentum, ku ne nuk po mund të ulemi që të diskutojmë për temën më të rëndësishme me të cilën po ballafaqohemi dhe do të ballafaqohemi në muajt e ardhshëm, pra me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe me pikat më të rëndësishme sa na përkasin neve në këtë dialog që ndërlidhen me platformën e përbashkët, me ekipin përfaqësues të Kosovës, e deri te vijat e kuqe, për të cilat Kosova në këtë dialog në asnjë mënyrë nuk duhet të diskutojë.

E di edhe opinioni publik që të gjitha partitë e koalicionit kanë paralajmëruar që do të marrin pjesë në seancën e ftuar nga opozita. Kryeministri ka kërkuar një seancë për t'i paraprirë pikërisht rezolutës që po e përmend edhe zoti Hoti, duke e propozuar ekipin në emër të Qeverisë, që do të përfaqësojë Qeverinë në dialogun në Bruksel, opozita nuk mori pjesë fare dhe, fatkeqësisht, pastaj erdhi edhe deri te mospjesëmarrja jonë në atë seancë.

Ne në mbledhjen e fundit të Kryesisë kemi propozuar disa mundësi që dalin nga kjo situatë. I kemi propozuar opozitës që të bëhemi bashkë në njërën prej seancave, cilado qoftë ajo, dhe të zotohemi që bashkërisht ta hartojmë një rezolutë të përbashkët, e cila do t'i harmonizojë qëndrimet dhe qëndrimet realisht nga ajo që deklarojnë publik të gjithë nuk janë aspak larg njëra-tjetrës.

Ne e dimë se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës edhe integriteti territorial i Kosovës, edhe shtetësia e sovraniteti janë të pacenueshme dhe janë të padiskutueshme dhe, pa dyshim, asnjë rezolutë s'mund të jetë më e fortë se Kushtetuta, po normalisht që ne do të ishim jo vetëm të gatshëm, po të interesuar që këtë ta kodifikojmë edhe me një rezolutë të Kuvendit.

Por mendojmë se rezoluta duhet të jetë më gjithëpërfshirëse, të mos e ketë vetëm një pikë, por t'i ketë disa pika, të flasë edhe për qëllimet e Kosovës në dialog, të përcaktojë cilat janë vijat e kuqe për çka nuk diskutohet, por të përcaktojë edhe mënyrën e përfaqësimit të Kosovës atje, duke përfshirë ekipin, po pse jo edhe krijimin të një komisioni apo një ekipi tjetër që do ta monitorojë këtë dialog apo të cilit ekipi do t'i raportojë.

Po ashtu kemi propozuar që nëse opozita nuk dëshiron të shkojmë në një seancë të përbashkët, të zotohen se së paku do të vijnë në seancën e ftuar nga kryeministri dhe le të votojnë edhe kundër ekipit, nëse duan, dhe ne do të zotohemi që do të marrim pjesë në seancën e tyre dhe do të votojmë si do të dakordohemi për rezolutën të cilën ata e kanë propozuar.

Pra, mund të dalim edhe me një seancë të përbashkët, tek e fundit me dy rezoluta konkurruese, rezolutën të cilën e ka propozuar opozita, një rezolutë pak a shumë ngjashëm me atë, siç e thashë që do të ishte më gjithëpërfshirëse dhe që do të trajtonte të gjitha temat e ngritura tashmë që ndërliken me dialogun. Po duket që ky vullnet ka munguar, siç u dëshmuar edhe tash.

Ne në këtë situatë mendojmë që duhet të largohemi nga inati politik dhe duhet t'i shohim interesat e qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës në këtë moment dhe para vazhdimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Nëse vazhdojmë kështu, atëherë ne do të jemi shumë më të dobët të përfaqësuar në këtë dialog dhe me këto ndasi, të cilat pa dyshim që nuk i ndihmojnë pozicionit të Kosovës në dialog.

Tek e fundit, ne kemi pasur edhe një debat për çështjen e dialogut, është shterur debati dhe ka mbetur që të votohet një draft-rezolutë, pikërisht në këtë seancë plenare është pika e gjashtë, ajo draft-rezolutë është propozuar nga një prej partive opozitare, nga PSD-ja.

Nëse vërtet qëllimi është që të merremi vesh për dialogun, unë ju ftoj që sot të mblidhemi përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe ta dakordojmë, ta harmonizojmë rezolutën e propozuar nga Partia Socialdemokrate, për çka kemi diskutuar, t'i marrim parasysh të gjitha ato elemente të propozuara dhe të dalim sot me një rezolutë, e cila i përcakton pikërisht këto që i thashë dhe dalim nga kjo situatë e bllokimit për shkak të pozicioneve apo inateve politike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca fjalën e ka në emër të grupit.

GLAUK KONJUFCA: Po, atë ditë të gjithë ishim dëshmitarë se seanca e opozitës faktikisht u uzurpua nga pushteti, ishte një farë lloj vjedhje e seancës, për shkak që ne shumë qartë e caktuam seancën tonë në orën 10:00 dhe kryeministri intervenoi me qëllim që ajo të mbahet para seancës sonë.

Ku ishte halli i kryeministrit? Qëllimi i tij ishte që pas shantazhit që ia ka bërë presidenti, i cili shantazh funksionoi, në ato dy takimet e dy ditëve me radhë me Qeverinë. Ne e dimë stilin e presidentit tonë qysh shantazhon e qysh kërcënon, e kemi parë këtë stil me vite të tëra këtu në Kosovë. Ai i ka thënë Ramush Haradinajt se ta rrëzojë Qeverinë, kaq e thjeshtë është puna, sepse e ka pjesën më të madhe në Qeveri, ka më së shumti deputetë në koalicionin qeverisës dhe nuk i duhen edhe shumë deputetë Hashim Thaçit për ta rrëzuar Qeverinë e Ramushit. 57 vota i ka opozita, veç me katër deputetë e shantazhon Ramushin, nuk ka nevojë t'i thotë 23 i kam, veç katër deputetë dhe e rrëzon Qeverinë.

Ai i shkreti aq fort e do pushtetin, e ka treguar që e do me çdo kusht, sa që është në gjendje t'i bëjë të gjitha, e pamë atë ditë se përpjekja e tij ishte t'ia bëjë një ekip qeveritar, i cili i bashkohet dhe i shkon si bisht atje në Bruksel Hashim Thaçit.

Ky ka qenë kuptimi i asaj vjedhjes së seancës së opozitës atë ditë! Pra, qëllimi kryesor i Hashim Thaçit është që ta ndërtojë një ekip që të duket që ai nuk është vetë atje, po po shkon bashkë me shokët e tij, janë shumë atje, një farë ekipi, një farë konsensusi dhe t'i hapë kufijtë e Kosovë. Këtë opozita nuk mund ta lejojë dhe unë mendoj që është mirë që Hashim Thaçi ka mbetur vetë atë ditë dhe aktualisht presidenti është pa tri elemente kryesore që janë elemente të domosdoshme për negociatë.

Ai është pa mandat, është vetëmandatuar, ia ka marrë mandatin Qeverisë dhe Ramushi nuk guxon të bëjë zë, se i rrëzohet Qeveria.

E dyta, nuk ka ekip Hashim Thaçi. Atë ditë nuk mund ta votonit ekipin qeveritar këtu, dhe përveç kësaj, nuk ka as platformë. Pra, nuk ka platformë, nuk ka ekip, Hashim Thaçi nuk ka mandat, ku do të shkojë pa këto tri elemente bazike?

Sa i përket bojkotit që e keni bërë atë ditë në seancë të opozitës, kjo nuk ndodh askund në botë. Për nga definicioni opozita gjithmonë ka më pak numra se pozita, për atë i thonë mazhorancë në Kuvend. Nëse është kështu, atëherë ju po të doni, për inati, opozita bash asnjë seancë nuk mund ta mbajë, bash ju po deshët t'i hyni kësaj punës së jetës parlamentare me inati, nëse doni, ne përnjëmend asnjë seancë nuk mund ta mbajmë, ama kjo është vdekje e demokracisë. Kjo e varros demokracinë përfundimisht.

Edhe ju po pritni ne të vijmë në seancën tuaj e të nënshtrohemi, nuk do të ndodhë kjo! Opozita nuk nënshtrohet!

Unë mendoj që më së miri është që të mbahet seanca, të cilën ju e ndërpretë qëllimisht atë ditë, duhet të votohet ajo rezolutë, e cila e pengon Hashim Thaçin të vazhdojë eksperimentin e tij të rrezikshëm për hapjen e kufijve të Kosovës, që t'i vihet një pengesë e pakapërcyeshme. Vetëm në këto kushte opozita pajtohet të vazhdojë jeta parlamentare, përndryshe unë mendoj që po i kontribuoni një presidenti, i cili ka kallëzuar haptas çka po do të bëjë. Po do ta shkelë Kushtetutën e Kosovës, ka dhënë deklarata publike, më 7 shtator, shyqyr, i dështoi takimi me Vuçiqin, por ka thënë që më 24 shtator është e mundshme që atë qëllim të keq ta vazhdojë. Kështu që mos harroni që po bëheni pjesë e këtyre planeve të presidentit edhe ju drejtpërdrejt!

KRYETARI: Janë 3 kolegë deputetë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kush është në emër të grupit? Teuta Haxhiu, fjala për ju.

TEUTA HAXHIU: Kryetar, Për këtë imagjinatën e LDK-së dhe të VV-së desha të flas diçka, por me pa ëndrra me sy çel, veç këta i kam parë. Ato që do të ndodhin në ditët në vazhdim, do t'i shohin qytetarët, ata që duan t'i shohin, normalisht se mëditjet i marrin.

Për temën në fjalë do të flasë kolegu im më vonë, unë po kthehem në diçka që po i prek kategoritë e mësimdhënësve dhe të nxënësve të Republikës së Kosovës, çka kisha dashur të jenë edhe pjesa e VV-së këtu. Në radhë të parë po flas për një temë që mësimdhënësit po obligohen të paguajnë 250 euro për ta ndjekur një trajnim, 'Udhëheqja arsimore', e që janë të involvuar edhe njerëz brenda MASHT-it, por edhe deputetë të VV-së. Me organizata që u mundova t'i gjej edhe ueb faqet e tyre, por nuk i gjeta, megjithatë dola ta marr fjalën për të treguar që a më me rëndësi është të ndiqet një trajnim apo të kryhet një Master për tre semestra, që ka 90 kredi? Dhe, për të konkurruar për një drejtor të një shkolle, më shumë vlerësohet një trajnim i ndjekur nga mësimdhënësit, thashë i paguar nga ta dhe i mbajtur nga ish-kolegë, siç është edhe deputetja e VV-së.

Pra, për mua ky është shqetësim, shqetësim që vjen nga mësimdhënësit që paguajnë vetvetiu 250 euro për ta ndjekë një trajnim, e nuk po flasim për pjesën tjetër se sa mbahet e sa është real. Ky është një shqetësim që unë e thërras ministrin e Arsimit që me shumë seriozitet planifikimin për trajnime në kuadër të MASHT-it që është 700-800 mijë euro, pra të shihet me një seriozitet shumë të madh që trajnimet të mbahen në kuadër të Fakultetit të Edukimit apo të planifikohen, edhe në nivelet Bachelor a Master, në mënyrë që kuadri që është i kualifikuar në kuadër të këtij fakulteti, pra të jetë kuadri adekuat që të mbajë trajnime. Në anën tjetër, është një çështje tjetër shumë me rëndësi: nxënësit që nuk po arrijnë të regjistrohen në shkolla të mesme.

Nëse nxënësit tanë mbesin rrugëve, ky është një shqetësim dhe për mua shqetësim shumë i madh është që ata sot nuk po mund të regjistrohen në shkolla të mesme dhe po mbesin jashtë bankave shkollore. Ky është një shqetësim që duhet të shihet qoftë nga niveli lokal, qoftë nga niveli qendror dhe planifikimet, edhe nëse janë për 32 nxënës në paralele, drejtorët e drejtorive komunale do të duhej ta shohin me shumë seriozitet dhe ndonjëherë të marrin edhe vendime shumë të rëndësishme në interes të nxënësve, në mënyrë që ata të mos mbeten të papërfshirë. Dhe, e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Të lutem! Jo, jo vetëm pak, regjia në qoftë se kjo flet në emër të grupit, pesë minuta i ka, sa minuta kaluan? Ia jep edhe 2 minuta, regjia!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar! Dhe, e treta është Ligji për pagat, i cili ka kaluar në Qeveri dhe u them të gjithë mësimdhënësve që kategorizimi i tyre nuk është meritore dhe ajo do të ndodhë në Kuvend, do të kategorizohen në kategoritë meritore dhe ai Ligj për pagat dhe Ligji për punëtorët e viteve të '90-ta, pra ta dini që nuk do të ndalemi në asnjë moment dhe që të dyja do të kalojnë. Mësimdhënësit do të trajtohen me kategoritë meritore, ngase politika dhe politikë po bëhet pikërisht nga opozita dhe po t'i shihni mbledhjet e komisionit, pra nuk janë për të kaluar Ligji për punëtorët e viteve të '90-ta dhe ju them që ai ligj do të kalojë dhe edhe do të kalojë edhe Ligji për pagat, por do të jenë në kategoritë meritore mësimdhënësit, e të mos bëhet politikë ndër vite, legjislativë pas legjislativë dhe kur të vijë fundi për t'i kaluar këto ligje, vërtet nuk është interesi i opozitës për t'i kaluar këto ligje. Ju them që është koha e fundit që Ligji për punëtorët e viteve të '90-ta të përmbillet dhe është më e pakta që ne do të arrijmë të bëjmë një mirënjohje për të gjithë ato vite, për ata persona që e kanë mbajtur arsimin shqip, në kushtet që secili prej nesh i di.

Pra, edhe një herë, me ëndrrat e opozitës nuk do të merremi ne, ne do të merremi me tema shumë reale që do të ndodhin ditët në vazhdim, për çka do ta shohin edhe qytetarët, pra për çka po punon kjo Qeveri dhe nuk po merret me iluzionet e LDK-së dhe të VV-së.

KRYETARI: Faleminderit! Ka ndodhur një gabim imi, i kërkoj falje Partisë Socialdemokrate, se është dashur radha të jetë e Partisë Socialdemokrate. Dardan Molliqaj në emër të Grupit Parlamentar e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Media,

Përfaqësues të shoqërisë civile,

Unë do të flas për ato që u folën më herët, që ka të bëjë me procesin e dialogut. E kemi thënë disa herë si Parti Socialdemokrate që procesi i dialogut me Serbinë ka filluar përmes një rrugëtimiti krejtësisht të mbrapshtë, absolutisht jonormal dhe i cili është nisur dhe është ndikuar kryesisht nga presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Thaçi.

Përgjegjësinë për këtë çka po ndodh sot në Kosovë, në procesin e dialogut e ka pushteti, përkatësisht shumica dhe presidenti. E keni nisur vetë, e keni nisur me arrogancë, edhe temat, edhe procesin dhe nuk keni pasur as vullnet dhe as dëshirë të ndërtoni kurrfarë platforme të përbashkët në Kosovë. Dhe, tash nuk mund të silleni thujse opozita ose pjesët e opozitës i kanë fajet për këtë çështje. Kryetari i Kuvendit duhet të mbajë përgjegjësi që nuk po e thërret seancën e jashtëzakonshme që e kanë kërkuar 53 deputetë. Është papërgjegjësi totale e kryeministrit pastaj që ka ndërhyrë me thirrjen e një seance të jashtëzakonshme një orë para seancës së opozitës. Me këtë qasje të pushtetit po tregoni që nuk doni konsensus mbi një platformë të përbashkët sa i përket çështjes së dialogut. Po vërtetohet edhe tash që kërkesa e Partisë Socialdemokrate për debat parlamentar qysh në korrik, ka qenë edhe e drejtë, edhe e domosdoshme, edhe në kohë.

Nuk mund të shkojmë në procesin e dialogut pa një konsensus më të gjerë mbi platformën. Zakonisht, Kosova ka bërë konsensus për njerëzit, për ekipe dhe për përfaqësues. Ajo çka duhet, është konsensus për çështjen e platformës, për temat në të cilat do të flasim. Sot do të duhej të ishte seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga opozita. Pushteti po vazhdon të mos e bëjë, ne jemi sot këtu për shkak se pikë e gjashtë e rendit të ditës është rezoluta e kërkuar nga Partia Socialdemokrate.

Unë e ftoj edhe LDK-në, edhe Vetëvendosjen që të kthehen në seancë, të paktën në pikën e gjashtë dhe le të votohet rezoluta jonë, për shkak se është edhe kërkesë e përbashkët që dje përmes një letre ia kemi dërguar përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, ku një ndër pikat e kësaj rezolutive, kërkesë ose letër, më mirë të thuhet, është që Kuvendi të udhëheqë dialogun dhe të ketë 2/3 edhe sa i përket çështjes së platformës, edhe sa i përket çështjes së ekipit negociator.

Çdo tendencë tjetër nuk është e mundshme të kalojë në Kuvend dhe shumica është duke i bërë dëm Kosovës. Sa i përket opozitës, para se ata të deklarohen për ne, po deklarohej unë për

pozicionin tonë. Ne nuk mund të bëhemi bisht i kurrkuajt, edhe opozita, siç e tregoi edhe sot në këtë seancë, pa e dëgjuar fjalën e Partisë Socialdemokrate e lëshoi seancën. Ka disa që po mendojnë që protestat i bëjnë vetë, ka do tjerë që po mendojnë që mbajnë mbledhje të Kryesisë e pastaj partitë e tjera duhet të sillen ngjashëm, edhe opozita që ka dalë sot nga seanca duhet të kuptojë që nëse donë partitë opozitare, siç janë Partia Socialdemokrate, Alternativa që sot është në seancë bashkë me ne dhe me deputetë të tjerë, duhet të mbërrijmë te një koordinim. Pa koordinim, nuk ka ecje përpara dhe ftesa jonë është që partitë opozitare të kthehen të paktën në pikën nr. 6 dhe ta votojmë rezolutën e Partisë Socialdemokrate që e mandaton Kuvendin ose më mirë të thuhet ia kthen fuqinë Kuvendit, ku me 2/3 do të bëhet edhe platforma, edhe ekipi negociator.

Të gjithë e dimë që ky pushtet nuk i ka 2/3 dhe nuk kemi nevojë të frikësohemi si opozitë, sepse votimi i kësaj rezolute ia kthen fuqinë opozitës, jo pushtetit. Dhe, e bart fuqinë në Kuvend me 2/3, ku vetëm opozita mund t'ia bëjë 2/3 një votimi në Kuvend. Kështu që shpresoj që ata do të kthehen në atë pikë dhe shpresoj që pushteti, përkatësisht edhe Kuvendi, edhe kryetari i Kuvendit, do ta korrigjojnë gabimin dhe do të thërrasin shumë shpejt edhe seancën e thirrur nga opozita, që është seancë e jashtëzakonshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kam tre deputetë nga Nisma, Zafir Berisha e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar kolegë!

I nderuar kryetar,

Edhe unë do të flas për çështjen që tashmë është prioritet i prioriteteve në skenën politike, pra rreth bisedimeve, rreth rezolutave, rreth ekipit. Por, para se të futem në këtë temë, unë dua ta jap edhe një qëndrim edhe si deputet, edhe si qytetar, rreth vizitës së Vuçiqit në një pjesë të Kosovës dhe neglizhencës ose reagimit të plogët që kanë pasur institucionet e vendit.

Unë mendoj se Vuçiqi me vizitën dhe fjalimin e vet na ka rikthyer në vitet e '80-ta, njëjtë sikur Milosheviqi kur përgatiste konflikte në ish-Jugosllavinë. Reagimi i qytetarëve të Drenicës edhe një herë tregoi se qytetarët janë shumë, shumë përpara institucioneve kur është në pyetje shteti, Kosova dhe perspektiva e saj. Prandaj, edhe një herë reagoi ndaj atyre qëndrimeve që janë thënë publikisht, veçanërisht në Mitrovicë nga Vuçiqi dhe po mendoj se vizita e tij, fjalimet e tij duhet të shërbejnë edhe si mësim për institucionet e Kosovës, duke përfshirë edhe presidentin. Mendoj se Vuçiqi edhe një herë tregoi se është vazhdimësi e politikës së Milosheviqit, një politikë e cila ka bërë gjenocid në Kosovë dhe, si të tillë, edhe 20 vjet pas luftës duhet ta shikojmë. E thashë këtë për t'u kthyer te ajo që është duke na pritur dhe unë po mendoj se pozita dhe opozita ka nevojë të bëhen bashkë. Të dyja nuk duhet të veprojnë dhe të sillen me logjikën, e cila përdoret nganjëherë në popull: "Për inat të resë, më vdektë djali". Kosova nuk është pronë as e Hashim Thaçit, as jona këtu në Kosovë, prandaj unë po mendoj si të zgjedhur të qytetarëve, duhet të

mblihdemi në këtë sallë dhe të diskutojmë seriozisht për hapat që do t'i marrë shteti i Kosovës dhe ne si përfaqësues të qytetarëve. Unë mendoj se kjo logjikë nëse vazhdon të përdoret, është humbje edhe për Kosovën, edhe për qytetarët dhe është fitore për Serbinë dhe logjikën ruse të ndarjes së territoreve në shtetet e Ballkanit. Do ta përdor një shprehje, por jo sipas zhargonit populist në Shqipëri, por sipas fjalorit të 2006-ës të gjuhës shqipe në Tiranë, rreth presidentit. Ai nuk është aq trap që të mos e dijë se ndarja e territoreve të një vendi, shkëmbimit të territoreve, nënkupton luftë të re në Ballkan.

Prandaj, unë mendoj se talljet e tij me opinionin, me institucionet, me ne deputetët, nuk duhet marrë shumë seriozisht. Ata që e njohin për së afërmi e dinë se është njeriu më i papërgjegjshëm që ka pasur skena politike që nga paslufta. Duke ditur këtë, unë mendoj se deputetët thjesht nuk duhet të merren shumë me deklaratat e tij dhe ne duhet t'i rikthehemi asaj që folën edhe kolegët nga opozita, të cilët e lëshuan mbledhjen. Mendojmë si Nismë se ne duhet ta kemi një seancë, po jo dy seanca, sepse materia e cila pritet të diskutohet në ato dy seanca është e njëjta.

Të dy seancat e thirrura, edhe nga mazhoranca, edhe nga opozita, të jetë një, të formohet Ekipi i Unitetit me zotin Limaj në krye dhe të nxirret një rezolutë për ekipin dhe për ata që do të jenë në bisedime, duke përfshirë edhe Presidentin.

Unë jam shumë i bindur se do të jemi në krye të përgjegjësisë dhe do t'i rikthehemi asaj për çka ne jemi të zgjedhur të zgjedhurit e qytetarëve. Përndryshe, nëse vazhdojmë kështu, unë mendoj se po e fundosim Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi pothuajse edhe një diskutues, po më vjen keq, edhe Ilir Deda, edhe kalojmë përtej kohës. Janë edhe dhjetë pastaj, s'mund ta vazhdojmë më tutje. Ilir Deda, tre minuta!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Në këtë situatë jo të lehtë nëpër të cilën po kalojmë të gjithë, edhe diskutimet e mëhershme nuk na treguan zgjidhje. Ne deklarativisht të gjithë jemi për integritet territorial të Kosovës. Sot ka qenë moment i mirë që ta votojmë rezolutën në mbrojtje të integritetit territorial.

E dyta, të gjithë po themi që duhet një platformë apo parime të përbashkëta për këtë dialog. Pasi ta votojmë këtë rezolutë mund të ulemi të bisedojmë për ndërtimin e përbashkët të kësaj platforme, ndërsa ku vijmë te çështje e tretë është se kush e zbaton atë platformë. Dua të ju them të gjithëve, zonja e zotërinj, që në sistemin politik të Kosovës është vetëm Qeveria e Kosovës ajo që mund ta bëjë këtë punë. Ne mund të merremi pra vesh që ata të cilët i ka autorizuar Qeveria bashkë me opozitën ta krijojnë një delegacion shtetëror, ama ne nuk mund të dalim jashtë sistemit politik të vendit tonë.

E tash, shumica e kësaj kohe është humbur në një betejë të kotë të atyre që duan të na bindin se ne duhet ta ndërrojmë sistemin politik. Nuk duhet ta ndërrojmë sistemin politik të këtij vendi dhe të mos përsëritemi edhe në të ardhmen, të jemi të qartë.

Hapat janë kështu:

1. rezoluta e përbashkët e partive politike për mbrojtje të integritetit territorial,
2. dakordanca për parimet për dialogun me Serbinë,
3. nuk mund të jetë presidenti ai që do ta udhëheqë këtë proces, po mund ta udhëheq Qeveria së bashku me opozitën në një delegacion shtetëror. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë nëntë deputetë që e kërkojnë fjalën. Unë me dëshirë e kisha përfunduar këtu, por jeni ju vetë deputetët, në qoftë se doni, ose duhet të nëntit t'i dëgjojmë, ose asnjërin, nga tre minuta. Ose të nëntit, ose asnjërin!

E respektojmë Rregulloren, po më vjen keq! Me dëshirë të gjithëve do të ju lejoja të flisni, po them drejt, por po e respektojmë edhe Rregulloren, po e shoh edhe reagimin e shumë kolegëve. Ora 10:27, tash është 11:00, ta keni parasysh, ka kaluar pesë minuta.

Qeveria ka mbledhje në orën 11:00, ministrat me arsye janë larguar nga seanca, ta keni parasysh, të kemi mirëkuptim.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, Koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 20 pyetje parlamentare. Ministrat nuk janë. A e kalojmë, pasi ministrat nuk janë, me arsye nuk janë këtu.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave të mbajtura më 5, 14, 28, 5, 9, 12 dhe 23 korrik 2018, urdhëroni! Në qoftë se nuk ka, atëherë unë duhet t'i hedh në votim, por aktualisht jemi vetëm 55 deputetë në sallë. Kisha pasur dëshirë që të verifikohet dhe të bëhet thirrja e deputetëve. Ziles, ju lutem!

(Ndërprerje e incizimit)

61 deputetë janë në sallë. Vetëm ju kisha lutur t'i zini vendet.

Jemi në miratimin e procesverbaleve nga seancat e mëparshme. Nëse ka vërejtje në procesverbalet e seancave të mbajtura më 5, 14, 28, qershor, 5, 9, 12 dhe 23 korrik 2018 dhe... se po e shoh një koleg deputet, 61 deputetë janë në sallë, Nait me ty bëhen 60. Ti, a do të dalësh, a të qëndrosh? Vetëm pak, se nënkryetari i Kuvendit është në zyrë.

(Ndërprerje e incizimit)

Aktualisht janë 62 deputetë në sallë. A ka dikush kundër procesverbaleve me dorë? Abstenim?

Konstatohet se miratohen procesverbalet e seancave të mbajtura më 5, 14, 28 qershor, 5, 9, 12 dhe 23 korrik 2018.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për pikat e rendit të ditës nga 4-15 kanë përfunduar në seancat e mëparshme të Sesionit pranveror, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, prandaj në këtë seancë fillimisht procedojmë vetëm me votimin e tyre.

4. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

54 deputetë kanë votuar, nga 63 sa janë aktualisht. 45 për, 2 kundër, 7 abstenime. Në bazë të një rregulle të pashkruar, votojmë edhe një herë. Janë 63 deputetë në sallë.

Raporti vjetori Agjencisë për Menaxhimin e Kompleksëve Memorialë të Kosovës për vitin 2017. Votojmë tash!

Faleminderit! 55 deputetë, nuk po e konstatoj fare, për arsye se nuk janë 61 deputetë që kanë marrë pjesë.

5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-010 për noterinë

Këtë projektligj janë të propozuar gjithsej 57 amendamente. Janë 9 dhe do të dëshiroja që amendamentet, të cilat janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional t'i vërë në votim të gjitha përnjëherë, pastaj amendamentet të cilat janë pa përkrahjen e Komisionit Funkcional shkojnë një për një.

Amendamenti 1. Këto që i përmendi shkojnë në votim, nëse pajtohemi të gjithë përnjëherë, sepse janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Po i numëroj: amendamentet 1 - 6, bashkë, amendamentet 8 - 9, amendamenti 11, amendamentet 14 - 33 bashkë, amendamentet 35 - 45 bashkë, amendamenti 47, amendamentet 50 - 54, amendamentet 56-57.

Këto i votojmë të gjitha bashkërisht. Amendamentet 7, 10, 12, 13, 34, 46, 48, 49, 55. Shkojmë në votimin në mënyrë formale, pastaj ato që janë dy propozime shkojmë në mënyrë elektronike. A dëshironi kështu?

Këto që janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL në mënyrë formale, vetëm kush është kundër, a ka abstenim? Janë për. Do të thotë, të gjitha amendamentet e përkrahura nga Komisioni FunkSIONAL, me 66 vota janë për.

Tani shkoj me ato që janë dy propozime, apo siç është situata pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Jemi në amendamentin 7. Komisioni FunkSIONAL e ka një propozim dhe nën B është propozimi i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Sipas rregullit, të dyja shkojnë në votim, e Komisionit FunkSIONAL, pastaj e vëmë në votim edhe variantin B, të propozuar nga Grupi Parlamentar Lista serbe. Ajo që merr vota më shumë, kalon, pra e konsiderojmë të kaluar.

Shkojmë, amendamenti 7, njëherë e votojmë vetëm në mënyrë elektronike, vetëm propozimin e Komisionit FunkSIONAL, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Ju lutem, votojmë tash! 55 deputetë, gjersa 66 janë në sallë, s'mund ta konstatoj.

A shkojmë në mënyrë formale vetëm me votim, për arsye se po e shoh që disa po përtojnë? Shkojmë në mënyrë formale me votim, 66 deputetë janë. E konstatoj në momentin që shkon më shumë, në bazë të pranisë votohet ajo. A jeni për? Pra, jo në mënyrë elektronike, por drejt. Po e shoh se nuk ka reagim, janë 67 deputetë. Kush është abstenim, kundër, e këtë pjesën tjetër për e marr gjithmonë të plotën.

Amendamenti 7, janë dy propozime, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, kush është kundër? Ju lutem, regjia! Kush është kundër? Tre janë kundër. Kush është abstenim. 67 deputetë janë në sallë. Abstenim nuk ka. Kundër janë tre, pjesa tjetër është për, pra nga 67 deputetë.

Tani shkojmë te varianti i dytë. Amendamenti 7, propozimi i grupit parlamentar pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër, ju lutem! Kush ka abstenim? Kush është për? Ju lutem! Vetëm ta marr rezultatin. Janë 51 kundër, 1 abstenim, 9 për. Kalon varianti i parë A i Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 7.

Jemi te amendamenti 10. Propozimi i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit Funkcional. Pra, ta keni parasysh, qenka një propozim. Kush është kundër? E marrim për, pastaj të gjithë ta keni parasysh. Kush është kundër? Po! A ka mundësi kryetari i Komisionit ose anëtari i Komisionit, amendamenti 10. Hajdar Beqa, na trego për çka bëhet fjalë, të lutem! Dëgjojeni, ju lutem!

HAJDAR BEQA: Kryetar!

Ndoshta është dashur ta bëjmë sqarimin në emër të Komisionit edhe në fillim. Grupi punues ka mbajtur disa takime në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Oda e Noterëve, Oda e Avokatëve, projekti i BE-së, USAID-i, Shoqata e Vlerësuesve të Kosovës, Organizata Polis, si dhe përfaqësues të OSBE-së. Anëtarët e grupit punues bashkërisht kanë harmonizuar qëndrimet për ndryshimin dhe plotësimin e projektligjit, të cilat janë propozuar në formën e amendamenteve për miratim në Kuvend.

Andaj, bazuar në komisionet, ju rekomandoj që të përkrahen amendamentet e Komisionit dhe ju lus që të kemi kujdes që amendamentet e grupit 6+ dhe Listës serbe nuk duhet të përkrahen, sepse ato veç janë të përfshira në amendamentet e Komisionit dhe rastësisht nëse kalojnë amendamentet do të shkaktojnë kolizion ndërmjet dispozitave të këtij ligji.

Unë kërkoj nga kolegët deputetë që ta përkrahim, t'i hedhim në pako vetëm të Komisionit të kaluar, t'i hedhim këto që nuk e kanë përkrahjen e Komisionit dhe të ecim tutje e ta votojmë ligjin. Mendoj se ka bërë një avancim ky ligj dhe amendamentet 10, 12, 13, 34, 46, 48, 49 dhe amendamenti 55 të hidhen menjëherë në votim dhe kërkoj nga kolegët deputetë që kanë qenë në Komision, edhe ata të 6+, edhe të Listës serbe që ta përkrahin ligjin ashtu siç e ka marrë përkrahjen e Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: E kemi një propozim nga Komisioni, por është pak e vështirë, sepse në rastin e caktuar ka edhe dy variante. Sido që të jetë, grupet parlamentare 6+ dhe Lista serbe të na tregojnë a shkojmë një për një. A shkojmë një për një apo paketë? Një për një dëshironi. Atëherë një për një shkojmë. Shkojmë me dorë, votojmë dalëngadalë.

Janë 67 deputetë në sallë, në fakt 69. Jemi te amendamenti 10. Grupi parlamentar 6+ pa përkrahje të Komisionit funksional. Kush është për? Amendamenti 10 është pa përkrahje të Komisionit funksional, vetëm 6+. Kush është për, ju lutem? Po, si jo! Urdhëroni, zonja Balje. Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Faleminderit, kryetar!

E para kryetar, mos e përziëni amendamentin 6+ me amendamentin e Listës serbe, sepse nuk janë e njëjta. E para.

E dyta, Kao drugo, u svim komisijama, nije samo u Komisiju za Legislaturu, i kod Javnog beleznika trazili smo da ako ima tri članova, četiri članova, dva članova, jedan bude iz manjinskih zajednica. Nismo konkretno rekli iz koje, nego jedan. Mislim da to neće uništiti nikakav sistem u Javnom beležništvu, i nije tačno to je što kolega rekao da su svi ti amandmani inkorporisani već u zakon. To absolutno nije tačno, i mi kao Parlamentarna grupa 6+ radimo svoj posao, i trazimo da se u ovom sistemu Javnog bileznika bar negde ubaci neko ko nije iz većinske albanske zajednice. Toje bio naš zahtev. Tu ne radi se samo o bošnjacima, nego posebno se radi o manjinama koje nisu albanske i srpske zajednice. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Po një sqarim, po e shoh 6+, vetëm sqaroje pozicionin. Jasmina Zhivkoviq, a e ke kërkuar fjalën? Urdhëro, pastaj nga Komisioni, Hajdari e merr fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvalujem, presedsedavajući!

Ja bi samo kratko pojašnjenje, jer u meterialu koje smo mi dobili pripremljen od strane Skupštinske administracije, u amandmanu 10, predlog grupe 6+, piše i tako su navedeni iz koje redova zajednice: turske, bosnjačke, romske, aškalijске, egipćanske ili goranske. Pitam to samo zato što da ne dodje do zabune za koji amandman glasamo, i dali je to amandman grupe 6+, a naravno to treba odvojiti amandmane grupe 6+ i Srpske liste. Hvala!

KRYETARI: Hajdar Beqa e ka fjalën. Gjërat janë të qarta. Amendamenti 10 është propozuar nga Grupi Parlamentar 6+, nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional, si do që të jetë. Z. Beqa nga Komisioni, të lutem na e sqaro!

HAJDAR BEQA: Po, kryetar!

Këtu janë edhe deputeti Bahrimi dhe Igori që kanë qenë në Komision. Problemi ka qenë, tash po flitet për anëtarë të komisioneve që kanë qenë atje dhe nënkomisioneve diku anëtarë, sepse ne kemi diskutuar para sesionit, pra para pushimit, kanë nga katër anëtarë, kurse komunitetet, në këtë rast 6+, edhe Lista serbe kanë kërkuar t'i kenë nga dy anëtarë, ose një anëtar. Atëherë është e pakuptimtë nëse e përcaktojmë komunitetin kush të marrë pjesë. Është shumë e drejtë nga ana e tyre që të kenë edhe komunitet, por jo që ta caktojmë numrin këtu, sepse mbetemi keq, pasi kur bëhen komisionet i pengojmë. Ligji është për të bërë zgjidhje, jo për t'i komplikuar. Unë i mbështes që të jenë edhe nga komuniteti, në këtë rast edhe nga komuniteti Lista serbe, e edhe nga komunitetet 6+, por të mos e caktojmë, se pastaj shumica nuk do ta ketë asnjë anëtar nëse shkojmë me këto amendamente. Unë edhe një herë ju kisha lutur që t'i përkrahim amendamentet e Komisionit dhe të kemi ligj shumë të mirë për noterët e Republikës së Kosovës, për noterinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Amendamenti 10, propozimi i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit funksional, 69 deputetë në sallë. Kush është për? Abstenim, kush është? Ju lutem, vetëm të ketë mundësi Administrata ta kryejë punën.

Në total janë, 9 janë për, 14 abstenojnë. Do të thotë, nga 68, pjesa tjetër është kundër. Nuk kalon amendamenti 10.

Amendamenti 12.

Propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Ju lutem për vëmendje. Kush është për, se çdo herë shkoj nga propozuesi? 9 janë për. A ka abstenim? Pjesa e mbetur janë kundër.

62 deputetë janë, 9 për, 11 abstenime, pjesa tjetër kundër.

Nuk kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Janë tri propozime.

I Komisionit FunkSIONAL, Grupi Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Propozimi i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Shkojmë në bazë të rregullit, amendamentin e parë, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 13.

Kush është kundër, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, kush është kundër, ju lutem? Jemi në a, me përkrahje, kush është kundër? 63 deputetë janë në sallë.

Abstenim? Pjesa tjetër është për. Nuk ka abstenim. Nga 63 deputetë, 60 janë për, 3 kundër.

Amendamenti 13, propozimi i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. A ka dikush për? Nuk ka. A ka abstenim? 3 abstenime po i shoh unë. Për asnjë, abstenim 3.

Milaim, je për, atëherë, të lutem për, edhe ju Veton jeni për. Ju lutem, edhe një herë, për ishte Milaimi dhe Vetoni, ta bëjmë sa më transparente. Kush është.. abstenim? Një. Fatmir Xhelili dhe Emilija Rexhepi abstenojnë. Pjesa tjetër është kundër. 61 deputetë janë në sallë, do të thotë 57 kundër.

Nuk kalon amendamenti i Grupit Parlamentar 6+.

Jemi te propozimi i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Abstenim, ju lutem? Pjesa tjetër është kundër.

62 deputetë janë në sallë: 9 abstenime, 45 për, 8 kundër.

Edhe një herë ma konstato këtë a është në rregull.

Lus deputetët të kthehen në sallë.

Jemi te amendamentet 34, 46, 48, 49, 55.

Në qoftë se ka mundësi deputetët që janë në bufe të kthehen në sallë, përndryshe 60 deputetë janë, në qoftë se është qëllimi të dilet, bile të na tregojnë.

Një grup i deputetëve janë në pjesën e bufesë, edhe pak ne po qëndrojmë, ose shkojmë në pauzë. Kryetarët e grupeve parlamentare marrin përgjegjësi, për arsye se s'kam obligim ta mbaj të bllokuar seancën.

Janë 62 deputetë aktualisht në sallë.

Shkojmë në votimin e amendamentit 34.

Propozimi i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? 62 deputetë janë në sallë. Abstenim?

62 deputetë janë në sallë, për janë 8, abstenim janë 10, pjesa tjetër e deputetëve janë kundër.

Nuk kalon amendamenti 34.

Amendamenti 46.

Propozimi i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është për? Abstenim?

62 deputetë janë. 8 për, 7 abstenime, 47 janë kundër. Nuk kalon amendamenti 46.

Shkojmë amendamenti 48, propozimi i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? A ka abstenim? 63 deputetë janë në sallë. Për? Asnjë, abstenim 14. 49 kundër.

Nuk kalon amendamenti 46.

Amendamenti 48, propozim i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? S'ka! Abstenim? Ju lutem, konstatimin! 62 deputetë janë në sallë. 15 abstenim.

Kundër 47. Nuk kalon amendamenti 48.

Amendamenti 49, propozim i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Kush është për abstenim? 8 deputetë abstenojnë. Për asnjë, 54 kundër, nga 62 deputetë që jemi. Nuk kalon.

Amendamenti 55, janë dy propozime. Propozimi i Komisionit FunkSIONAL dhe propozimi i Grupit Parlamentar 6+. Kush është kundër propozimit të Komisionit FunkSIONAL? A ka abstenim? 1 abstenim. Për? Janë të gjithë të tjerët, do të thotë 62 deputetë, një abstenim, 61 janë për.

Shkojmë te propozimi i Grupit Parlamentar 6+, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është për? Abstenim a ka dikush?

60 deputetë janë në sallë, i kisha lutur deputetët, jemi në përfundim të ligjit, edhe ky amendament. I kisha lutur deputetë, në pjesën e sallës pas. Jemi në proces të votimit, zonja Emilija, proces i votimit, çështje që s'e ndërroj as unë, as ju. Ju e ndërroni me votim.

61 deputetë janë në sallë. Jemi në votimin e propozimit të Grupit 6+, pa përkrahjen të Komisionit FunkSIONAL. Kush është për? A ka abstenim?

61 deputetë, 10 abstenime. 51 kundër. Për asnjë.

Kalon varianti i amendamentit 55 me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Tani jemi në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Kush është kundër? Me elektronikë, si të doni. Regjia, të përgatitet, kini parasysh se nuk e bëra me dëshirë as këtë pjesën e votimit deri tani.

Regjia ka vështirësi në votim elektronik, unë do ta provoj. A ka mundësi që ta votojmë një herë pjesëmarrjen? Ta shohim funksionalitetin, vetëm pjesëmarrja në seancë, nuk jemi duke votuar projektligjin, për test, testim është.

Ju lutem, votoni tash vetëm pjesëmarrjen. Edhe kështu me kartela i kemi 74, në fakt, tash 58 është prezenca. Po, po, se nuk po funksionon, për atë gjatë krejt procesit të amendamentimit e bëme gjithë atë mundim, për shkak se s'është duke punuar elektronika.

Edhe kështu i kemi 58 deputetë, sa janë aktualisht? 58. Kisha kërkuar nga kolegët deputetë që të kthehen në sallë ata, të cilët donë, ose e bëjmë një pauzë.

A ka mundësi kryetarët e grupeve parlamentare të kemi një takim, një minutë këtu në prani, tash. Kryetarët e grupeve parlamentare si përfaqësues, një minutë, përfaqësuesit kryetarët e grupeve parlamentare...

(Ndërprerje e incizimit)

Edhe përfaqësuesi i Alternativës, në qoftë se ka mundësi? Për mbarëvajtjen e seancës, vetëm kjo...

Dhjetë minuta pauzë! Ka mundësi të shkojmë në pauzën e drekës, por dhjetë minuta pauzë. Qëndrojmë dhjetë minuta në pauzë.

Në orën 13:00 e vazhdojmë seancën. Ta kini parasysh, Parlamenti Evropian në orën 13:00 voton për ne, ne do të jemi në seancë. I ftoj ata të cilët dëshirojnë të vijjnë. Është me rëndësi shumë të

madhe për qytetarët e Kosovës, bëhet fjalë pikërisht për liberalizimin e vizave në orën 13:00 dhe e vazhdojmë seancën. Shfrytëzojeni për kohë dreke. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Faleminderit, të nderuar kolegë deputetë!

Në emrin tuaj, në emrin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe një herë e falënderojmë Parlamentin Evropian për një vendimmarrje shumë pozitive për qytetarët tanë - liberalizimin e vizave.

(Duartrokitje në sallë)

Urime, qytetarë të Republikës së Kosovës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tani neve na mbeten detyrat tona në përmbushjen e ligjeve. Vetëm në këtë rend dite sot që e kemi janë edhe disa projektligje dhe ratifikime, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me partneritetin e Bashkimit Evropian me Republikën e Kosovës. Janë edhe ndihma financiare dhjetëra milionëshe, të cilat Bashkimi Evropian i jep për qytetarët e Republikës sonë, pa dallim pozite dhe opozite.

I ftoj edhe kolegët deputetë parlamentarë nga opozita që të jenë bashkërisht me ne, në mënyrë që të marrim vendime që janë në interesin e qytetarëve. Ne do ta vazhdojmë këtë seancë parlamentare në pajtueshmëri edhe me kolegët deputetë të grupeve parlamentare nesër në orën 10:00.

Vetëm pak! Nesër e kemi Ditën e Demokracisë. Zonja Shqipe, në orën 12:00? Në 11:00! Atëherë, e lëmë në orën 11:00, pasi është Dita e Demokracisë. Vetëm ora ndërron. Në orën 11:00 fillojmë.

Faleminderit! Suksese! Mirupafshim nesër!

* * *

E premte, 14 shtator 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 13 shtator 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në vazhdimin e seancës,

Vazhdojmë deri në momentin kur jemi 61 deputetë, pastaj rikthehemi në votimin e projektligjeve.

5. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit numër 06/L-010 për noterinë

Amendamentet 1 deri në 57 kanë kaluar në formën e votimin, të cilin e kemi pasur nga fillimi i seancës.

Tani jemi në votimin e projektligjit në tërësi, në momentin kur bëhen 61 deputetë, futemi në votim.

6. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë

Kemi një propozim-rezolutë të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, nuk jemi 61 deputetë, e shtyjmë deri në momentin e duhur për votim.

Ju kisha lutur, kolegë deputetë, bini ziles, më herët ishin më shumë se 60, është e Dita e Demokracisë sot, një pjesë e deputetëve janë në aktivitete në objekt të Kuvendit, i kisha thirrur të vijnë në seancë ata të cilët mundën.

7. Votimi i Projektligjit numër 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Duhet 2/3, në fakt. Është një marrëveshje shumë me rëndësi për Republikën e Kosovës, janë para të taksapaguesve evropianë, të cilat jepen për qytetarët e Republikës së Kosovës, i ndihmohet Kosovës.

Sa deputetë janë në sallë?

51 deputetë janë aktualisht, po presim edhe pak. Ndërkohë, në momentin që bëhen 61, futemi në procesin e votimit.

(Pauzë)

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale

Jemi në shqyrtimin e parë të Projektligjit numër 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale. Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbrojtjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Do të shkojmë me projektligjin në leximin e parë, në momentin që i kemi mbi 61 deputetë, rikthehemi në votimin e projektligjeve në lexim të dytë, të cilat janë pika të rendit të ditës.

Në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, e ftoj ministrin Abelard Tahiri që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E mora fjalën në mungesë të kryeministrit e zëvendëskryeministrave për ta prezantuar projektligjin në fjalë, siç e tha edhe kryetari i Kuvendit.

Komisioni e ka miratuar dhe i ka rekomanduar seancës që të miratohet projektligji në fjalë.

Unë kërkoj që sot ju ta miratoni në parim këtë projektligj dhe pastaj do të mundemi që çdo koment që keni ta inkorporojmë gjatë periudhës para se të vijë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Haxhi Shala, nuk është, zoti Fatmir Xhelili e merr fjalën në emër të komisionit.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ju,

Kabinetin,

Të nderuar deputetë,

Për të qenë korrekt, unë kam qenë i autorizuar në komision. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22. 6. 2018 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin numër 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë votimin e tij në parim.

Gjithashtu mund të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ku e kemi shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe i kemi disa sugjerime, disa vërejtje, të cilat do të mundohemi t'i inkorporojnë gjatë punës në grupin që do të formohet prej komisionit.

Vërejtjet janë duke filluar prej nenit 1, paragraf 1, ku në rreshtin e dytë faktikisht e bën një konfuzion se a është ligj për mbrojtjen e të dhënave personale, apo edhe për qasje në dokumentet publike, duhet të definohet, pasi ekziston ligj i veçantë për qasjen më dokumentet publike. Domethënë, ose duhet të fuzionohen dy ligjet, ose duhet të tërhiqen vija ndarëse mes Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjit për qasje në dokumente publike.

Kemi gjithashtu edhe vërejtje në nenin 3, në paragrafin e 1, në paragrafin 27, në paragrafin 28, kemi vërejtje edhe në nenin 9, në nenin 29, në esencë duhet të përcaktohet se si do të emërohet ky ligj, ose udhëheqësi i kësaj strukture që do të kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale. A do të mbetet emërtimi “agjenci”, apo do të kalohet në emërtimin “komisionar”, që është një dallim esencial, varësisht prej emërimit, është edhe strukturimi i strukturës të kësaj agjencie.

Kisha propozuar që në të ardhmen grupet punuese, të cilat hartojnë projektligje në Qeveri, të na prezantohen me emra dhe mbiemra, në mënyrë që të kemi më lehtë të konsultohem me ekspertë, të cilët i bëjnë hartimet e projektligjeve dhe të kemi qasje më të drejtpërdrejtë se kush po i harton dhe interesat e cilave segmente dhe instrumente të shtetit po mbrohen, e cilat po lihen paksa anash.

Kështu që i propozoj Kuvendit ta miratojë në parim këtë projektligj dhe do të kujdesemi në grupin punues që ky projektligj të jetë jo vetëm i zbatueshëm, po të jetë edhe cilësor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe deputetët e ka kërkuar fjalën vetëm nënkryetarja Aida Dërguti.

AIDA DËRGUTI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar qytetarë të Kosovës që po na përcillni,
Siç e dimë të gjithë, mbrojtja e të dhënave personale është e rregulluar në mënyrë hierarkike që nga dispozitat kushtetuese, ligjet, e deri te udhëzimet administrative.

E për këtë çështje ne kemi ratifikuar nene të caktuara në Marrëveshjen për Stabilizim-Asocim në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Kosova duhet të sigurojë një minimum, një standard të nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, i cili u përgjigjet kriterëve të ‘acquis communautaire’ të BE-së.

Dërgimi pa zarf i faturave të shpenzimit të energjisë elektrike, të shpenzimeve të ujit dhe mbeturinave, janë çështje që Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave i ka dërguar në gjykatë, për shkak që kompanitë që merren me dërgimin e tyre nuk iu kanë përmbajtur rekomandimeve të agjencisë.

Tani ky ligj i jep të drejta ekzekutive agjencisë, për çka ka të drejtën e shqiptimit të gjobave, njëjtë sikur një gjykatë për kundërvajtje, e rëndësishme në projektligjin e ri është plotësimi i përkufizimeve, ku e dhënë personale do të konsiderohet, përveç tjerash, edhe çdo informacion jo vetëm me personin fizik të identifikueshëm, por edhe me atë online. Zhvillimi teknologjik dhe informativ ka ecur më shpejt se sa një ligj i miratuar në Kuvend. Projektligji sjell të reja në lidhje me organizimin dhe funksionimin e institucionit përgjegjës, siç është Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, projektligji tashmë është në përputhje edhe me Rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave.

Për mua mbetet shqetësuese shndërrimi i agjencisë nga një organ kolegjal në organ individual, nga Këshilli në komisionar. Për këtë çështje pres nga ministri përkatës të japë sqarime përse tentohet të bëhet ky ndryshim. Pozitive sërish është rritja e kompetencave ekzekutive të agjencisë, së cilës i jepet e drejta e shqiptimit të gjobave administrative, gjë që pritet të rrisë efikasitetin në punë. Gjobat janë harmonizuar me Ligjin për kundërvajtje. Pozitive është që tashmë agjencia do të ketë mbikëqyrjen në dy ligje: Ligjin për qasjen në dokumentet publike dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Vlerësoj që është shumë i rëndësishëm fakti se me projektligjin e ri komisionari do të zgjidhet me konkurs publik dhe do të emërohet nga Kuvendi dhe jo siç është në ligjin bazik, ku anëtarët e këshillit janë propozuar nga Qeveria dhe janë emëruar në Kuvend.

Partia Socialdemokrate do të japë kontributin e saj me amendamentet, të cilat i ka parasysh ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në momentin kur bëhemi 61 deputetë, më duket se janë, shkojmë me votimin e projektligjit të dytë, pastaj rikthehemi, po, po, tani. Ndërkohë, zonja Pantina ishit vetëm ju, por janë lajmëruar nga grupet parlamentare Ganimete Musliu, pastaj vazhdojmë në bazë të grupeve.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më lejoni që edhe unë ta përshëndes ardhjen e këtij projektligji në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh që është një ligj shumë i rëndësishëm, pasi që të dhënat personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës çdo ditë, në çdo segment i janë ekspozuar rrezikut dhe thjesht qytetarët e Republikës së Kosovës në asnjë mënyrë nuk kanë gjetur mbështetjen

institucionale deri më tani. Duke pasur parasysh që gjykatat e Republikës së Kosovës kanë lëndë të stërngarkuara dhe jo shumë shpesh kanë mundur të marrin në shqyrtim ankesat e qytetarëve ose paditë private që qytetarët e Republikës së Kosovës i kanë bërë edhe për shkeljen e të dhënave personale, siç u përmend nga parafolësja Aida Dërguti, sidomos në shërbimet publike, siç janë Posta dhe Telekom, pastaj faturat e ujit, të rrymës, të telefonit, e kështu me radhë.

Më vjen shumë mirë dhe dua ta përsërisht që në këtë projektligj parashihen masat ekzekutive që do t'i ketë në të ardhmen Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Edhe një herë, besoj shumë që ekspertët, të cilët do ta kenë në duar këtë projektligj gjatë rishqyrtimit dhe amendamentimit të kenë parasysh që qytetari i Republikës së Kosovës duhet të jetë prioritet në mbrojtjen e të dhënave personale, sepse deri më tani si agjenci nuk kanë mundur ta kryejnë punën me efikasitet, duke pasur parasysh që përveç që i kanë rekomanduar ose thjesht i kanë shqiptuar dhe i kanë verifikuar shkeljet, ata nuk kanë pasur kompetenca të ekzekutimit të çështjeve. Kështu që si anëtare në dy mandate, edhe në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës kam kërkuar vazhdimisht që qytetari i Republikës të ruhet dhe të mbrohet nga shkeljet e përditshme që u janë bërë nga korporatat në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë si anëtar i ri i komisionit po flas me rekomandime të Muharrem Nitajt, do t'i japim përkrahje këtij projektligji në parim dhe shpresoj se kontributin do ta japim në kuadër të komisionit. Pajtohem se është një ligj tepër i rëndësishëm dhe natyrisht që do ta zgjidhë mishmashin që ka qenë deri tash. Në të kaluarën, ju e dini që mbas presionit të madh ndërkombëtar ky ligj është hequr prej Komisionit të Sigurisë dhe është drejtuar te Komisioni për Integritet Evropian, gjë që s'ka pasur asgjë të përbashkët dhe tash shpresoj që me këtë projektligj do t'i zgjidhim shumë probleme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zafir Berisha nga Nisma.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Në mungesë, pasi kryetari i këtij komisioni nga Nisma, zoti Shala, është jashtë Kosovës, në emër të Nismës e mbështesim projektligjin. Natyrisht do të japim kontribut, e llogarisim në mesin e ligjeve tepër të nevojshme, për arsytet që përmendën edhe më herët kolegët, kështu që po mendojmë se ky projektligj besoj se do të mishërohet deri në lexim të dytë dhe thjesht qytetarët do të vazhdojnë të jenë më të sigurt kur janë në pyetje të dhënat e tyre, të cilët po keqpërdoren veçanërisht nga ndërmarrjet publike, siç tashmë e di edhe opinioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Sa i përket Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, komentet tona i prezantoi nënkryetarja e Kuvendit, zonja Dërguti, megjithatë unë kam një propozim, e që ndoshta është vendim që Kryesia duhet ta marrë më shumë se sa vetë komisionet.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale parasheh disa risi, e njëra prej tyre është kalimi nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në Komisioner, i cili përveç detyrës për mbrojtje të të dhënave personale, detyrë parësore dhe mendoj se ky është një hap pozitiv, do ta ketë lejimin, gjegjësisht garantimin e qytetarëve në qasjen e dokumenteve publike. Çka do të thotë se Ligji për qasje në dokumente publike duhet të shqyrtohet në pako me këtë ligj, pra me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi parashihet të krijohet i njëjti komisionar, i cili do të kujdeset për zbatimin e këtyre dy të drejtave, pra edhe të drejtës për qasje në dokumente publike, edhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, e që është një hap pozitiv, sepse tani më i njëjti institucion, ndonëse është vijë shumë e hollë ndarëse mes asaj se çka është publike dhe çka duhet të lejohet për t'u qasur qytetarëve dhe çka janë të dhënat personale dhe si duhet të mbrohen ato. Ne kemi diskutuar pak a shumë brenda Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që e kemi përgjegjësi shqyrtimin e Ligjit për qasje në dokumentet publike dhe, ndonëse mund ta konfirmojë dhe kryetari, po pak a shumë kemi rënë dakord që të bashkëpunojmë me Komisionin për Siguri, i cili ka për detyrë shqyrtimin e këtij ligji, por propozimi im është që të dy komisionet, sa i përket këtij ligji, të bëhen një ose një grup punues i përbashkët, apo t'i shqyrtojnë së bashku, sepse ndryshe mund të ketë ndërhyrje nga njëri komision në tjetrin, gjegjësisht nga njëri projektligj në tjetrin.

Përndryshe, ne në parim do ta përkrahim projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Kryetar!

Desha veç një sqarim prej ministrit, ndoshta dikush prej deputetëve mund të më shpjegojë diçka. Unë mendoj se sado ligje që bëjmë, përderisa Agjencia Kundër Korrupsionit neve na jep të dhënat personale të deputetëve, të ministrave, të çdo fytyre publike, na i publikon edhe kontonumrat, sa kemi para! A nuk është kjo shkelje e të drejtave të njeriut të çdo personi dhe rrezikim i jetës. Kështu që kisha pasur dëshirë ministri të na shpjegojë, me këtë ligj a shuhet agjencia dhe pse ai është veç të bëjë shantazh, se ai kurrfarë funksioni tjetër s'ka, pos të shantazhojë njerëzit e veçantë.

E keni parë, Naitit i ka rënë tri herë t'ia kontrollojnë pasurinë private, kishe shorti i ka rënë ashtu. Po sidoqoftë, ai është tjetër muhabet, ndonjëherë debatojmë për ta, po a zhduket kjo agjenci, në qoftë se ata vazhdojnë që të na i publikojnë të dhënat tona personale, pse të hyjë në fuqi ky ligj?

KRYETARI: I nderuar deputet, kryetari i komisionit qenka nga Nisma, trajtoni në komisioni. Në anën tjetër, agjencitë profesionale nuk është mirë të etiketohen për vetë ndjeshmërinë e tyre dhe punën shumë profesionale, ligji ua rregullon, ligji janë deputetët e Kuvendit, në komision përcaktohuni.

Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Ne kemi vendosur në komision që t'i qasemi seriozisht dhe të organizojmë debate publike rreth këtij ligji, është ligj me rëndësi që vlerësohet, ka qenë edhe domosdoshmëri kohe të nxirret një ligj kualitativ në këtë drejtim.

Unë besoj që me qasjen serioze ndaj këtij ligji dhe përcaktimin e strukturës për mbrojtjen e të dhënave do të determinojmë që Ligji për qasjen në dokumente zyrtare t'i përshtatet strukturës së re të krijuar në bazë të asaj që a do të mbetet të quhet Agjenci për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, apo komisionar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sepse nëse përcaktohem për komisionar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, atëherë normalisht që do të ndërrojë edhe emërtimi i komisionarit, ku do të quhet komisionar për të dhënat personale dhe për ofrimin e qasjes në dokumente publike dhe përcaktimin se çka mund të jetë publike dhe çka nuk është publike.

Sa për komentit e deputetit Zeka, besoj që ky Kuvend ka përcaktuar se cilat do të jenë kompetencat e agjencisë në fjalë dhe në të vërtetë ndoshta doni diskutim shumë serioz se çka është publike dhe çka të mos jetë publike te të ardhurat personale e te pasuria personale e zyrtarëve të shtetit dhe të institucioneve. Kjo më shumë është paramenduar në atë drejtim që organet hetimore të kenë qasje në ato deklarime pa pasur nevojë për marrjen e autorizimeve të instancave gjyqësore, mirëpo me të vërtetë duhet të jetë një pikëpyetje e madhe te të ardhurat edhe te pasuria financiare se a duhet të ketë qasje çdo qytetar te ajo shumë e të hollave apo jo? Njerëzit kanë pasur në të kaluarën edhe probleme të kësaj natyre.

Besoj që është e mjaftueshme që organet hetimore pa kompetencë gjyqësore të kenë të drejtë në qasje të pasurisë të individëve, por edhe unë jam ithtar i asaj që pasuria e patundshme të jetë publike dhe të ketë qasje çdo qytetar në pasurinë publike të njerëzve që e drejtojnë shtetin dhe njerëzve që janë ranguar në listat si obligues të prezantojnë deklarin e pasurisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të vazhdojmë këtë pikë, pasi jemi 62 deputetë, po votojmë, se disa nga kolegët deputetë po kërkojnë. Po, po, e vazhdojmë gjithqysh.

(Ndërhyrje)

Dëgjo, mos voto! Po më vjen mirë, kjo farë gjendje në Kuvendin e Republikës së Kosovës! Urdhëro, merre fjalën, faleminderit zoti Zeka që më afrove këtë mundësi, zakonisht në partitë politike kur i bëjmë listat për deputetë, kemi problem, pastaj kjo është gjendja. Sekretari i përgjithshëm më tha se deri në 2008-ën kurrë nuk ka pasur Kuvendi i Kosovës problem me kuorumin. 89 vetë në koalicionin e kaluar kemi qenë, njëjtë ka qenë edhe opozita atëherë, shumë zor ka qenë të bëhen 61. Nuk është situata e tashme, edhe në koalicionin e kaluar për tre vjet shumë zor ka qenë të bëhen 61, Milaim Zeka ka replikë, 2 minuta, pastaj shkojmë në votim.

MILAIM ZEKA: E para, kryetar, nuk më pëlqen metodika jote të mos ia prishësh kurrkujt e të na gjuash neve 'kungja'. Unë në mënyrë absolute pajtohem me fjalën e Fatmir Xhelilit, ato agjenci i keni krijuar ju, Kuvendi, i keni bërë 34 a 35, ti s'ke qenë atëherë kryetar kur janë krijuar. Është e vërtetë, ne e dimë të gjithë, ne nuk hamë këtu krunde të Novi Sadit, e dimë për çka janë bërë shumica e agjencive. Sidoqoftë, esencën e shpjegoi shumë mirë deputeti Xhelili, unë jam për atë, para gjykatës, para prokurorisë çdo deputet duhet të jetë i gatshëm të deklarojë pasurinë personale dhe kah i ka ardhur pasuria, por jo more të na i publikojnë ata kontonumrat dhe sa para i kemi, jo veç neve, por edhe të grave tona. Kaq pata, s'ke këtu për të mbrojtur agjencinë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zeka! Po shkojmë në pikën e dhjetë, ku kemi mbetur:

10. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin-ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 7 amendamente, do të vazhdojmë votimin e amendamenteve, të cilat kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, të gjitha përnjëherësh, edhe ato të cilat janë pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL veçmas.

Amendamentet 1, 3, 4, 5 dhe 6 janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë vetëm në mënyrë formale.

A ka dikush kundër? Nuk ka! Abstenim? Nuk ka!

62 deputetë janë në sallë, 62 janë për.

Janë dy amendamente, amendamenti dy, dy propozime, nën "a" nga Komisioni FunkSIONAL dhe nën "b" pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, propozimi i deputetit Korab Sejdiu.

Amendamenti 2, propozimi i Komisionit FunkSIONAL "a". A ka dikush kundër? Abstenim? Me 62 vota aprovohet "a-ja". Tash shkojmë te propozimi "b". A ka dikush për, propozim i deputetit Korab Sejdiu, a ka dikush për? S'ka! Abstenim? 1. 61 vota për, një abstenim. Do të thotë, në bazë rregullit shkon amendamenti 2, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Dhe amendamenti 7, propozim i deputetit Korab Sejdiut, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. A ka dikush për? Nuk ka! Janë 62 deputetë. Abstenim? 1. 61deputetë janë kundër. Nuk kalon ky amendament.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 53 për, 9 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-066 për ndryshim-plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi.

11. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësim- ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 4 amendamente. Të katër amendamentet janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. regjia dhe deputetët i votojnë së bashku katër amendamentet në mënyrë elektronike. A shkojmë në mënyrë elektronike, apo me dorë? Me dorë, ka reaksion! 63 deputetë janë në sallë, katër amendamente. Kush është kundër? Kush ka abstenim? 63 deputetë janë për.

Shkojmë në votimin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë në mënyrë elektronike. Votojmë tash! Nuk e kemi arritur kuorumin e mjaftueshëm, votojmë edhe një herë në bazë të praktikës. Deputetë, ju kisha lutur ta shfrytëzoni të drejtën e votës, aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese e bën të qartë rregullën e votimit. E votojmë edhe një herë për projektligjin në fjalë, për Hekurudhat e Kosovës. A shkojmë me dorë, apo në mënyrë elektronike? Prapë nuk kemi arritur, a doni me dorë, a jo? Shkojmë te pika e radhës, pastaj do të kthehemi prapë.

12. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësim- ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120

Në këtë projektligj janë tri amendamente, të tria amendamentet janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. I votojmë të tri amendamentet me ngritje dore. Kush është kundër? Abstenim? 63 deputetë janë për.

E votojmë në mënyrë elektronike projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

62 deputetë, 53 për, 9 abstenime. Kalon projektligji.

13. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësim- ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor

Në këtë projektligj janë propozuar 7 amendamente. Të 7 amendamentet janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Me ngritje dore kush është kundër për shtatë amendamentet? Nuk ka! Abstenim? Nuk ka! Atëherë, sa deputetë janë në sallë? 63 janë për, kalojnë shtatë amendamentet.

E votojmë në mënyrë elektronike projektligjin në tërësi, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 62 deputetë që kanë votuar, 53 për, 9 abstenime. Kalon projektligji.

14. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësim- ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej katër amendamente. Të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Kush është kundër, të gjitha bashkë, katër amendamentet? A ka abstenim? Prania fizike është 63 në sallë, 63 deputetë janë për 4 amendamentet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash, në mënyrë elektronike.

62 deputetë kanë votuar, 53 për. 9 abstenime. Kalon projektligji, miratohet!

15. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësim- ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme

Në këtë projektligj janë propozuar 3 amendamente, të gjitha me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Shkojmë me dorë se po i shoh që më shpejt po shkojmë. Kush është kundër? S'ka! Kush ka abstenim? Nuk ka!

Aprovohet me 63 deputetë ky projektligj.

A e votojmë me dorë edhe projektligjin në tërësi, a ka reagim? Nuk ka! Kush është kundër? A ka abstenim? 63 deputetë janë në sallë, 8 abstenime nga 63 deputetë në sallë.

Kalon projektligji me 55 deputetë për. Pra, edhe ky projektligj kalon.

Shkojmë në votimin po ashtu edhe një herë, mbeti pika e 11 pa u votuar për shkak të kuorunit:

11. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

A votojmë me dorë? Kush është kundër? Urdhëro, zoti Milosavljeviq. Elektronikë, prapë? OK! Në bazë të reagimit tuaj. Shkojmë atëherë me elektronikë, elektronika është duke punuar.

E votojmë Ligjin për Hekurudhat, katër amendamentet u aprovuan, herën e kaluar nuk patëm kuorum. Votojmë tash!

Kemi probleme me elektronikën, ta kini parasysh, kemi pasur dje, edhe sot. Duhet të votojmë edhe një herë, a ka mundësi regjia, a mund të votojmë me elektronikë? A shkojmë me dorë, kolegë deputetë? Zoti Milosavljeviq, ju mund ta jepni votën edhe me dorë, njëjtë është. Prania, mosprania është e juaja, edhe me dorë është njëjtë, por kemi problem. 63 deputetë janë në sallë, a mund të shkojmë me dorë? Urdhëro, zoti Milosavljeviq. Zoti Millosavljeviq e ka fjalën, ju lutem!

SASA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Ono što mi koristimo danas svi ste koristili milion puta, a to je da date fizički kvorum, a za određene zakone u opšte ne glasate za nijedno od opcija niti za, niti protiv, niti uzdržan. Nije Srpska lista izmislila ovu proceduru. To smo svi koristili milion puta.

Tako da je to nepisano pravilo, koje mi želimo danas da iskoristimo. Mi za ovaj Zakon ne želimo uopšte da glasamo, da ne bih izlazili napolje ako ne može elektronski da se glasa, ja vas molim da glasanje za ovaj Zakon ostavite za neku drugu sednicu ili kasnije da se glasa ponovo.

Ali mi želimo da iskoristimo to naše pravo koji ste, još jednom ponavljam, svi koristili mnogo puta, da fizički budemo prisutni ovde, a da ne glasamo za nijednu od opcija, niti za, niti protiv, niti uzdržan. Hvala!

KRYETARI: Zoti Milosavljeviq, për korrektësi për këtë herë edhe për çdo herë të tjera, për të gjithë kolegët deputetë. Në qoftë se elektronika nuk punon, deputetët kanë të drejtë, edhe pse kanë praninë fizike ose grupet parlamentare të thonë “konstato se nuk ka pjesëmarrje fare në votim”, qoftë deputeti, qoftë grupi parlamentar. Thotë “nuk ka pjesëmarrje” pa lëvizur fare nga vendi, thotë “nuk ka fare pjesëmarrje në votim”, ose në emër të grupit parlamentar, ose deputeti në emër të vetë. Kjo nuk e vështirëson fare situatën, të jem më korrekt dhe më i qartë për procedurat e votimit, pavarësisht. 63 deputetë janë aktualisht në sallë, ju lutem, në qoftë se dëshironi, kur ta bëj unë votimin kundër, për, abstenim, ju thoni se ne nuk jemi fare të pranishëm. Atëherë vlen aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, të jemi korrektë.

Po, nuk po punon... Ka mundësi, vetëm një moment. A mund të kaloj në disa pika të rendit të ditës, të cilat po ashtu janë shqyrtim i dytë. A mund të kaloj me pajtimin e plotë, janë në shqyrtim të dytë?

20. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projekt-kodin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e miratuara. Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL nuk është e pranishme. Janë 43 amendamente. Jemi në votim, vetëm ta marr konfirmimin nga Administrata, ju lutem, menjëherë do të kthehem. Janë 43 amendamente në Projekt-kodin, të gjitha me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

A ka vërejtje në këtë që ta votojmë pikën 20? Të gjitha janë me përkrahje, nga 1 deri 43, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Në qoftë se ka reagim ndonjë nga grupet parlamentare, reagoni, ose nga deputetët.

Votojmë në tërësi, jemi në pikën e 20, ta kini parasysh, amendamentet, s'ka reagim. Kush është kundër? Nuk ka! Kush është në abstenim? Nuk ka! Janë 64 deputetë, votohen në tërësi amendamentet, 1 deri 43. A mund ta votojmë me dorë në qoftë se s'ka reagim, me ngritje dore Projekt-kodin në tërësi me amendamentet e propozuara.

Do të shkojmë kështu, kush është kundër? Tani jemi në tërësi për Projekt-kodin, si projektligj. Kush është kundër? Nuk ka! Abstenim? Nuk ka! 64 deputetë janë për.

Miratohet Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur.

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz

I kemi 22 amendamente. Komisioni i ka shqyrtuar, të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. A mund të shkojmë po ashtu me ngritje dore në këtë projektligj? Urdhëro, z. Sasha Milosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniće!

Znači ovako, da ne bi išli tačku po tačku, mi ne želimo da učestvujemo na glasanju ove tačke, od 21 do 25 tačke. Znači od 21 do 25 tačke, gde su druga čitanja Zakona, mi ne želimo da učestvujemo u glasanju.

KRYETARI: Ky është një qëndrim politik. Sa deputetë i kemi? Janë 65 deputetë. Ka plotësisht të drejtë Sasha Milosavljeviq, për vetë faktin se 120 deputetë janë në Kuvendin e Republikës së

Kosovës, nuk janë 65. Do ta provoj praninë fizike. Vetëm të provoj praninë fizike në mënyrë elektronike, sepse edhe për mua është mundim votimi me dorë, në kuptimin kur është projektligji.

Ju kisha lutur vetëm për praninë në mënyrë elektronike për çfarëdo votimi që bëni vetëm ta shohim votimin elektronik, votojmë tash, çfarëdo suste që e prekni. Votojmë tash!

Kemi problem me elektronikë, sa deputetë janë në sallë? 67 kartela janë në fakt, 63. Po vazhdojmë në këtë formë edhe një herë. Të kthehemi te 25, shkojmë tutje. 16-shin s'e kemi votuar ende.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale

Janë shqyrtuar. A ka deputet që ka dëshiruar? Jo! Atëherë shkojmë me votimin e 16-shit. A ka mundësi? A prish punë edhe një herë ta votojmë projektligjin për herë të parë se unë nuk besoj se e kemi votuar, por në ndërkohë unë e vërtetoj me administratë. Nuk është votuar. Për korrektësi nuk është votuar. Administrata ma konfirmon. Janë 67 deputetë në kartelë, sa janë në prani? 62. Përgatitemi për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë shkojmë me votimin e projektligjit. Jo, ka kaluar, më falni. Keni të drejtë, faleminderit! 61 deputetë kanë votuar. 60 ishin për, 1 abstenim më duket.

60 për dhe një abstenim, Kuvendi e miraton në parim Projektligjin 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të vijnë në sallën e Kuvendit për arsye se kemi nevojë për votim.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme

Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Kush dëshiron fjalën? Hajdar Beqa. Vetëm pak! Jo, nuk mund të trajtohet. Mungon propozuesi që e ka propozuar, kështu që e lëmë për një moment tjetër. Pika 17 shtyhet.

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e ftoj Abelard Tahirin që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin në fjalë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit.

Të nderuar ministra,

Pra, në mungesë të përfaqësuesve të Zyrës së Kryeministrit, e prezantoj për shqyrtim në shqyrtimin e parë Projektligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Pra, në fakt, në mungesë të ministrit të Pushtetit Lokal, Lista serbe, siç e dini, i ka ngrirë pozicionet e veta, mirëpo ata dalin në zyrë, por nuk vijnë t'i prezantojnë projektligjet e veta.

Andaj, mendoj që është në interes të kuvendeve komunale dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës që ky projektligj të miratohet në parim, dhe pastaj në lexim të dytë të vazhdojë me komentet tuaja që i keni t'i inkorporojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! Zoti Nait Hasani, në emër të Komisionit FunkSIONAL.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni, më 11. 7. 2018, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka kërkuar atëherë që me një seancë urgjente të miratohet, por meqë nuk ka pasur kuorum edhe nuk është pajtuar Kuvendi, ne po kërkojmë që në seancën e rregullt të miratohet në parim Projektligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Është në interes të thuhet që në projektligj është bërë një kapërcim te neni 11 dhe kërkohet që gjatë shqyrtimit ai të plotësohet dhe të ndryshohet, të amandamentohet.

Prandaj, kërkoj që deputetët ta miratojnë në parim dhe të jepet mundësia për plotësim-ndryshimin gjatë shqyrtimit në komisione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Partia Demokratike e Kosovës, zonja Sala Berisha-Shala, a e keni kërkuar ju fjalën? Jo. Atëherë, zonja Shqipe Pantina a e keni kërkuar fjalën? Po, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, projektligji është një avancim prej asaj që ka qenë më herët, sidomos në shkurtimin e afateve kohore për dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të komunave, por po ashtu

përcakton qartë edhe procedurat të cilat duhet ndjekur për dhënien, respektivisht për të aplikuar për ta marrë në shfrytëzim pronën e komunave.

Ajo çka duhet ta shqyrtojmë më me kujdes në komision dhe të përcaktohet qartë është roli i Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Mendojmë se tashmë janë pjekur kushtet që, qoftë komunat, qoftë Qeveria, do të thotë institucionet tona, të marrin vendime dhe të kenë fjalën përfundimtare sa i përket edhe pronës së ndërmarrjeve shoqërore, të cilat ende nuk janë privatizuar dhe vendimin për to duhet ta marrë Qeveria, përkatësisht kuvendet komunale në rastet kur kjo pronë është me interes të një komune të caktuar për ta shfrytëzuar, përkatësisht për ta dhënë atë në shfrytëzim.

Unë i ftoj deputetët që ta miratojnë në parim projektligjin. Megjithatë, i ftoj edhe të tjerët që ta lexojnë më me kujdes dhe të sjellin propozime sesi do të ishte mënyra më e mirë që edhe të lehtësohen procedurat për dhënien në shfrytëzim të pasurisë së patundshme, por në të njëjtën kohë të mbrohet interesi i publikut dhe të mos krijohet hapësirë që kjo të shfrytëzohet, qoftë për interesa grupore apo edhe personale, siç ka ndodhur, dhe për fat të keq vazhdon të ndodhë edhe tani në disa raste. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ky ligj që po e trajtojmë sot krijon mundësinë për këmbimin e pronës së paluajshme të komunës dhe përfitimin e të drejtës së pronësisë për komunat, duke përfshirë këtu edhe pronat që janë në administrimin e AKP-së. Ky ligj ka qenë i domosdoshëm dhe i shumë pritur nga komunat, duke pasur parasysh problemet praktike, procedurat e gjata dhe burokratike me të cilat janë përballur komunat për një kohë relativisht të gjatë.

Jo rrallë komunat kanë humbur investitorë potencialë për shkak të këtyre procedurave. Me këtë ligj, komunave u jepen shumë mundësi; thjeshtohen dhe shkurtohen procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim dhe këmbimin e saj, duke i mundësuar kështu komunave qasje më të lehtë në investime dhe zhvillim ekonomik lokal. Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim këtë projektligj. Në vazhdim si deputetë dhe si njeri me një përvojë modeste në pushtetin komunal, kam disa propozim-ndryshime në projektligjin që sot po e diskutojmë në parim.

Te kapitulli IV, e Drejta e komunës për bartjen e pronës së menaxhuar nga institucionet shtetërore, te neni 36, pika 3.2, 3.4, 6 dhe 9.

Te pika 3.2, ku shkruan: “Deklaratën për mënyrën e kompensimit të pjesës së 20%-shit të kapitali pronësor dhe 5%-shit të taksës menaxhuese dhe shpenzimeve të tjera administrative, - ku

shkruan; ‘i kompenson komuna’, mendoj se në projektligj duhet të jetë ‘me qëllim të ndihmës për komunat, ato duhet të lirohen nga këto obligime’”. Pra, të njëjtat t’i marrë përsipër Qeveria.

Te pika 3.4, ku shkruan: “Komuna duhet sigurojë vlerësimin e pronës nga zyrat për vlerësimin e pronës në Ministrinë e Financave”, mendoj se duhet të zëvendësohet. Shpenzimet për vlerësimin e pronave nuk duhet t’i heqë komuna, por ministria përkatëse. Edhe këtu për shkak të kostos së papërbalueshme nga komunat, vlerësimin duhet ta kryejë ministria përkatëse, ose të ceket se vlerësimi bëhet pa pagesë, ndërsa komunat obligohen që komisionit për vlerësimin t’ia ofrojnë dokumentacionin përkatës.

Dhe, pika 6. “Në rast të aprovimit të kërkesës nga Qeveria, AKP-ja është e obliguar që në afat prej 30 ditësh të bëjë bartjen e pronës te komuna”, këtu duhet bërë ky ndryshim. Pra, jo AKP-ja, por zyrat kadastrale të komunave ose direkt Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar që në afat prej 30 ditësh të bëjë bartjen e pronës te komuna.

Te pika 9, “Kompensimet e cekura në pajtim me ligjin për AKP-në i merr përsipër komuna”. Te kjo pikë, po ashtu duhet të bëhet ky ndryshim; kompensimet i merr Qeveria, sepse ka komuna të cilat nuk mund ta përballojnë implikimin buxhetor për këtë kompensim.

Të nderuar deputetë,

Pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji, Qeveria e ka mundësinë t’i zgjidhë shumë probleme të pronave në komunat e Kosovës. Ky ligj i zhbllokon problemet nëpër komuna dhe krijon mundësi për investime, jo për të bërë komplimente, por Qeveria Haradinaj në këtë vendim të përcjellë këtë ligj në Parlament ka bërë një veprim të mirë dhe gjithsesi të guximshëm. Pra, unë mendoj se ky është vendimi më i rëndësishëm që drejtpërdrejt i ndihmon komunat, duke krijuar mundësi për zhvillimin e tyre në shumë drejtime.

Deri më sot AKP-ja ishte piramida e paarritshme për problemet që i kishin komunat me prona. Me këtë ligj kjo piramidë bie dhe vendimet zbresin te komuna dhe Qeveria.

Deri më sot kanë bërë kërkesa komunat për pronat e menaxhuara nga AKP-ja, po ashtu edhe Qeveria, por kjo ka qenë e kotë, sepse AKP-ja ishte në një farë mënyre pushtet mbi pushtetin.

Në fund, ja një shembull për dy probleme që mund të zgjidhen në një nga komunat e Kosovës, më konkretisht për Deçanin.

Pushimorja e fëmijëve është një vendim që mund ta marrë Qeveria që t’i kthehet komunës dhe po ashtu të ndajë fonde për ta funksionalizuar këtë pushimore.

Dhe po ashtu dëshiroj ta përmend edhe një problem që, sipas mendimit tim, ka qenë dhe mbetet më shumë problem politik se sa ligjor.

Vendimi për ndërmarrjet ‘Apiko’ dhe ‘Iliria’ që realisht shkalla e dytë e Gjykatës Supreme ka marrë vendim në favor të ndërmarrjeve publike dhe komunës, por Gjykata Kushtetuese që realisht është inkompetente ka ndërhyrë në këtë proces dhe ka marrë vendim që këto t’i takojnë manastirit.

Me këtë ligj, në momentin kur hyn në fuqi, Qeveria e Kosovës ka mundësi që në mënyrë ligjore t’i përmirësojë këto gabimet të cilat kanë ndodhur.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës i jep përkrahje këtij projektligji në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti, fjala për ju!

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Është mirë që ky projektligj ka ardhur në shqyrtim në Kuvend dhe Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate e ka trajtuar.

Ne gjatë shqyrtimit të dytë do të japim kontributin, por që në fillim dua të theksoj dy çështje që mendoj se janë të rëndësishme.

Nuk do t’i përsëris ato që i tha deputeti nga Aleanca, që ka të bëjë me Kapitullin IV të këtij projektligji dhe një çështje tjetër që duhet ta kemi të gjithë parasysh se një pjesë e resurseve të pronave janë dhënë në shfrytëzim ose janë privatizuar në disa komuna dhe ne duhet të kemi kujdes se çfarë duhet të ndodhë në ato komuna, të cilat resurset e atyre komunave tanimë veç janë përmbyllur në procesin e privatizimit dhe mendojmë që kjo gjendje aktuale nëse i kthehemi pak mbrapa krijon një farë diference, do të thosha, në mes të qytetarëve, një padrejtësi sociale dhe një mundësi të kufizuar për zhvillimin ekonomik.

Ne mendojmë që ky projektligj do t’i ndihmojë komunat që të marrin angazhim shtesë, u krijon mundësi shtesë për të zhvilluar vetveten. Po në të njëjtën kohë e bën një diferencë në ato komuna, të cilat tani mund të themi se procesi i privatizimit është mbyllur dhe mundësitë e atyre komunave në pronat e tyre dhe në resurset, të cilat i posedojnë janë të përfunduara dhe nuk i gëzojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta.

Jemi në një proces, i cili do të krijojë një diferencim qytetar mes komunave dhe qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Përshëndetje, kolegë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

Media të nderuara,

Dhe kor diplomatik,

Sigurisht që sot po e trajtojmë një projektligj, i cili me të vërtetë është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, për arsye që shpeshherë ka pasur ngatërtime Agjencia e Privatizimit, komunat dhe ka mundur të hupin investitorët.

Prandaj, sot ky ligj, nëse të gjithë e përkrahim, sigurisht që kjo do t'i ndihmojë edhe komunat për zhvillim, po në përgjithësi Republikës së Kosovës.

Prandaj, ne si AKR e kemi mirëpritur, e përkrahim dhe shpresoj që të mos zvarritet shumë deri sa të vijë te realizimi i këtij projektligji. Ne e përkrahim.

KRYETARI: Xhevahire Izmaku, ka problem me teknikë.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar, për fjalën!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Projektligjin në fjalë e ka shqyrtuar edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, është një projektligj shumë i rëndësishëm, për të cilin kanë lobuar kryetarët e komunave dhe të gjitha organizatat që të vijë në diskutim dhe në miratim.

Meqenëse kishim një ligj, i cili i pamundësonte, për arsye të burokracisë të madhe, që të konkurronë organizatat e ndryshme dhe grupe të biznesit, shpeshherë kemi humbur investime, ku kanë ikur në rajon, sepse burokracia dhe mënyra se si është dhënë në këmbim kjo pronë ka qenë aq afatgjate sa që e ka humbur edhe interesin në një fazë.

Pra, duhet të gëzohen të gjithë kryetarët e komunave, të cilët kanë një prioritet për zhvillimin ekonomik të komunave, sepse periudha kur jepet në shfrytëzim është në mënyrë të negociueshme në një afat shumë më të shkurtër. Mirëpo, një risi është e veçantë, sepse për herë të parë në afat të shkurtër jepja në shfrytëzim prej 1 deri 12 vjet u mundësohet edhe organizatave të shoqërisë civile, që nuk ka qenë më parë.

Këtu kanë marrë pjesë edhe gjatë hartimit të ligjit në Qeveri dhe në Komisionin Parlamentar, ku e kemi shqyrtuar dhe besoj që do të jetë një mundësi shumë e madhe që këtu të gjenden favore për zhvillim ekonomik në komunat tona.

Pra, në parim e mbështesim dhe do të vazhdojmë të punojmë në fazat e mëtuajtshme. Faleminderit!

KRYETARI: Andin Hoti, a e ka kërkuar fjalën. Jo.

Sa deputetë janë në sallë, administrata? Kemi kuorum të mjaftueshëm, do të shkojmë në votimin e projektligjit:

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

64 deputetë janë të pranishëm.

Përgatitemi për votim, regjia, a mund të votojmë në mënyrë elektronike, ju lutem!

Jemi 64 deputetë, në qoftë se shohim se ka probleme, nuk ka reagim, do të shkojmë prapë me dorë.

Do të shkojmë në mënyrë elektronike herën e parë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, në mënyrë elektronike, votojmë tash projektligjin në shqyrtim të parë.

Ky është votim bindës: 66 deputetë, 61 për dhe 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi.

68 deputetë janë në sallë.

Lus deputetë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kemi ende projektligje, të vijnë në sallë t'i votojmë.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL e komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

68 deputetë janë në sallë, na duhen nja 73 a 74 për t'i miratuar edhe disa projektligje.

19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës

Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Në emër të Qeverisë, e ftoj ministrin Skender Reçica ta prezantojë projektligjin.

68 deputetë jemi në sallë. Kisha kërkuar nga kolegët deputetë që na përcjellin të vijnë në sallë, t'i kryejmë detyrat që i kemi. Të lutem, zoti ministër!

SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Sot para jush gjendet projektligji që ka për qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupit më të cenueshëm, jo vetëm në Kosovë, por edhe në mbarë botën, pra mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

Ne të rriturit, deputetë, kabinet qeverisës e institucione të tjera, kemi para vetes detyra dhe obligime të politikës së brendshme e të jashtme dhe kjo duhet kuptuar nga të gjithë ne, por duhet të pranojmë se tashmë e shumë vjet pas çlirimit e pas pavarësisë nuk kemi bërë aq sa duhet për fëmijët tanë, për ardhmërinë e vendit tonë, për ata që ne duhet t'u krijojmë barazi, arsim më të mirë, shëndetësi më të mirë dhe njëherësh t'i bëjmë krenarë për vendin tonë.

E mora fjalën nga shkakut se dikasteri i cili drejtoj është përgjegjës për zhvillimin e politikave sociale, hartimin e legjislacionit, standardeve dhe planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, e me theks të veçantë në mbrojtjen e fëmijëve.

Shërbimet sociale dhe familjare, në kuadër të cilave bëjnë pjesë edhe shërbimet për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, janë të rregulluara me Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare, por për të avancuar të drejtat e fëmijëve Qeveria e Kosovës ka aprovuar Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe tashmë ky projektligj gjendet para jush dhe ky është një moment i veçantë, sepse kemi filluar të merremi seriozisht me çështjet me të cilat është dashur të merremi me kohë.

Të nderuar deputetë,

Me aprovimin e Projektligjit për mbrojtje të fëmijëve do të avancohen shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe do të krijohet mundësi për respektimin e Konventës të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës dhe akteve të tjera ligjore ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve.

Ky projektligj rregullon mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Ai do të garantojë dhe do të sigurojë përgjegjësinë e prindërve, familjes, shoqërisë dhe shtetit për kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës, duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Ky projektligj është një risi në kuadër të infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e fëmijëve dhe përcakton parimet bazë ku mbështeten politika kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, përmes të cilave përcaktohen mekanizma dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e lokal, si dhe kompetencat e tyre në përputhje me fushëveprimin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Është e rëndësishme të theksohet se ky projektligj përcakton qartë rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe institucioneve lokale si dhe përcakton mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës, rolin e institucionit të Avokatit të Popullit, Komitetit ndërmnistror për të drejtat e fëmijës, Këshillit për të drejtat e fëmijës, ekipit për të drejtat e fëmijëve, tryeza për ndihmë në menaxhimin e rastit nëpër komuna, e të tjera.

Në aprovimin e këtij projektligji do të krijohen mundësi për krijimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve, të cilët do të ofrojnë shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, ofrimin e shërbimeve këshilluese, të terapive të ndryshme si dhe do të shërbejnë si vendstrehim i përkohshëm i fëmijëve, të cilët nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpi dhe nuk mund të strehohen në strehim familjar.

Të nderuar deputetë,

Po theksoj, meqenëse është fjala për një akt ligjor në mbrojtjen e fëmijës, përmes së cilës sigurohet ngritja e një sistemi të integruar e funksional për mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e eksploatimit ekonomik të fëmijëve si dhe ofron përgjigjen më efikas ndaj të gjitha formave të dhunës apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Kërkojmë nga të gjithë ju që të ofroni kontributin tuaj, me qëllim që ky projektligj të marrë aprovimin e Kuvendit të Kosovës, sepse Kosovës dhe fëmijëve tanë u mungon qe sa kohë një ligj i tillë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: E ftoj kryetaren e Komisionit Funksional, zonjën Duda Balje.

DUDA BALJE: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione në bazë të nenin 56.2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 11.7.2018 e shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandimet dhe në parim të miratohet projektligj.

Komisioni për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores të Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin në parim.

Edhe në emër të Grupit 6+ ne e përkrahim këtë projektligj dhe do të punojmë në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Shefat e grupeve parlamentare, LDK nuk janë këtu, po ju jap fjalën qysh jeni paraqitur. Zonja Mexhide Mjaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht më duhet të them se ky projektligj për mbrojtjen e fëmijëve që një kohë të gjatë është në fazat e rishikimit dhe se gjithëherë gjatë mbajtjes së mbledhjeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut kanë bërë thirrje që ky projektligj të silltet në Kuvend, sepse ky projektligj do të rriste mundësinë për implementimin më të mirë të të gjitha politikave që synojnë mbrojtjen më të mirë të fëmijëve dhe që synojnë respektimin e të drejtave të tyre. Ky projektligj për mbrojtjen e fëmijëve është një hap ose një element që i kontribuon këtij procesi në tërësi.

Sfidat të cilat i ka potencuar institucioni i Avokatit të Popullit në raportin për vitin 2017, siç ishte mungesa e një ligji për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve, do të eliminohen me miratimin e këtij ligji, i cili do të jetë mekanizmi adekuat për të respektuar të drejtat e fëmijëve.

Deri më tani sfidat ishin të shumta, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevojë të kenë qendra të përkujdesjes ditore që janë për rehabilitim, trajtim dhe riintegrim të atyre fëmijëve në shoqëri. Po ashtu, edhe një gjithëpërfshirje më e madhe e fëmijëve në procesin e arsimimit gjithëpërfshirës. Sfiduese gjithashtu ka qenë edhe fakti i fëmijëve që gjenden në rrugë, të cilët janë në gjendje të vështirë socio-ekonomike, prandaj e braktisin shkollimin dhe zgjedhin të qëndrojnë në rrugë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, duke ditur qëllimin e këtij projektligji, të mbrojtë fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzime dhe keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës, e mbështet në parim ligjin në fjalë.

Ndërsa kjo qeverisje planifikon politika kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, krijon mekanizma efikas dhe garanton mirëqenien dhe përmirësimin e jetës së fëmijëve, ku përmes këtij ligji ndihmon dhe përkujdeset në mënyrë efektive për fëmijët, shëndetin dhe mirëqenien.

Të nderuar qytetarë,

Qeveria e Kosovës, si objektiv kryesore ka krijimin e një sistemi të mirëfilltë ligjor për mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me standardet evropiane e ndërkombëtare.

Përmes këtij ligji ne po krijojmë një ambient të sigurt për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve tanë.

Andaj, duke e ditur se hartimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës parashihet në planin kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe njëherësh është edhe si kërkesë nga Raporti i Progresit për Kosovën.

Ne si grup parlamentar e mbështesim në parim projektligjin në fjalë dhe kontributin do ta japim në mes të dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Që nga viti 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një varg rekomandimesh për të drejtat e fëmijëve në Kosovë, ndër këto rekomandime ka qenë edhe hartimi i Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Projektligjin që kemi para nesh ka kaluar nëpër shumë faza konsultimesh si ndërinstitucionale, ashtu edhe në shoqërinë civile që i kanë prioritet fëmijët.

Derisa ky ligj parasheh mekanizma koordinues dhe zbatues si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin komunal, ka shumë nevojë për një financim të qëndrueshëm të shërbimeve, si në parandalim të çfarëdo forme të dhunës ndaj fëmijëve, ashtu edhe për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e fëmijëve. E kjo kërkon burime njerëzore të përgatitura mirë dhe burime financiare adekuate konform standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.

Ndarja e buxhetit për Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve është e domosdoshme, në mënyrë që ky projektligj pas aprovimit të gjejë zbatim dhe të ndikojë në mbrojtjen dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve.

Për të siguruar një financim të qëndrueshëm, ky ligj ndërlidhet me Ligjin për shërbime sociale dhe familjare, ku Qeveria duhet të krijojë një grant specifik për shërbime sociale, i cili do të siguronte mbrojtjen për të gjithë fëmijët me nevojë dhe, në anën tjetër, këtë duhet ta lejojë Ligji për financat e pushtetit lokal, derisa komunat do të duhej të obligohen të ndajnë buxhet adekuat për shërbime rreth mbrojtjes së fëmijëve.

Patjetër që ky projektligj ndërlidhet edhe me fusha të tjera, sidomos të arsimit, e në veçanti me parimin e gjithëpërfshirjes në arsim, parandalimin e braktisjes dhe parandalimin e dhunës si në shkolla, ashtu nga vetë prindërit, duke marrë parasysh se dhuna dhe ndëshkimi fizik i fëmijëve si një normë sociale është ende e pranuar dhe e aplikuar nga prindërit dhe shoqëria jonë si një formë e disiplinimit.

Këto norma duhet ndaluar dhe ndryshuar nga profesionistët e ndryshëm si në arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, të cilët punojnë me fëmijët dhe familjet e tyre, duke promovuar programe të prindërimit të mirë dhe forma alternative dhe pa dhunë të disiplinimit të fëmijëve.

Monitorimi i zbatimit të këtij ligji dhe strukturat përgjegjëse për zbatim janë ndërsektoriale, derisa sponsoruese e këtij ligji është Zyra e kryeministrit. Shumë dispozita ligjore i bie të zbatohen nga ministritë e linjës, sidomos nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit Publik, respektivisht komunat, pasi që parashihen struktura, ekipe për mbrojtjen e fëmijëve edhe në nivel komunal.

Përgjegjësitë dhe llogaridhënia për të drejtat e fëmijëve duhet të jenë të qarta, sidomos kur ka të bëjë me shërbime të integruara për fëmijë.

Grupi ynë parlamentar e përkrah këtë projektligj, do të votojë pro dhe do të japë kontributin në komision nga anëtarë ynë i grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve, është shumë me rëndësi që ky projektligj ka ardhur, fatkeqësisht që edhe në legjislaturën e kaluar në përfundim kur pritnim edhe votimin e fundit, pra votimin e dytë, në mënyrë që të hyn në fuqi projektligji në fjalë, ndodhi ajo që ndodhi dhe sot e kemi për herë të

dytë këtë projektligj, edhe pse ka disa ndryshme, disa amendamente shtesë dhe disa nene që kanë ardhur nga ministria përkatëse.

Ne jemi shumë të përkushtuar, të gjithë anëtarët e Komisionit, po njëkohësisht në mungesë të një ligji adekuat për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimeve përmes rrjeteve sociale, do të jetë mirë përmes punës në komision, afateve ligjore që kemi në komision, por njëkohësisht edhe përmes shumë organizatave që operojnë në Kosovë, qoftë vendore dhe jovendore, që me ndihmën e tyre t'i kemi disa amendamente të propozuara, në mënyrë që t'i mbrojmë fëmijët tanë nga çdo abuzim, por njëkohësisht edhe nga ndëshkimet fizike që janë shumë të nevojshme.

Pra, ne do të japim kontributin tonë maksimal që ky ligj jo vetëm të hyjë në zbatim, por njëkohësisht të jetë ligj i zbatueshëm dhe në interes për mbrojtjen e fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Edhe Nisma Socialdemokrate e mbështet Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe brenda dy leximeve do ta japë kontributin e vet dhe llogarisim që bashkërisht do të bëjmë një ligj, ku do t'i mbrojmë fëmijët tanë, fëmijët e Kosovës, nga shumë aspekte dhe besoj që ky ligj është më se i domosdoshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht sot po më vjen mirë që po e trajtojmë një ligj, i cili është shumë i rëndësishëm dhe po më vjen mirë që Qeveria e Republikës së Kosovës po vazhdon avancimin e ligjeve, sidomos të rëndësishme për jetën e qytetarit të Republikës.

Sot e kemi Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, u kisha bërë thirrje prej këtu drejtorit të Policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'i përcjellin abuzimet e fëmijëve që i bëjnë lypsa nëpër rrugë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, ky ligj është i rëndësishëm dhe ka edhe 100 arsye të tjera pse ky ligj duhet të shkojë përpara. Ne fuqishëm e përkrahim dhe më gëzon që ky ligj po trajtohet sot dhe besoj që të gjithë deputetët ta kenë parasysh dhe ta përkrahin fuqishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë,

Të dashur fëmijë,

Ndjehem jashtëzakonisht mirë që sot, më në fund, po diskutohet Projektligji për mbrojtjen e fëmijës, ku për herë të parë përcaktohen në mënyrë të qartë jo vetëm të drejtat që kanë fëmijët, por krijohen masat konkrete për realizimin e këtyre të drejtave, duke plotësuar edhe legjislacionin në fuqi.

Që nga viti 2013, kur ka filluar hartimi i këtij projektligji, ka kaluar përmes shumë konsultimeve të hollësishme vendore e ndërkombëtare si dhe shoqërisë civile, mirëpo nuk kemi arritur te miratimi, të paktën në parim, të këtij projektligji të një rëndësie shumë të veçantë.

Projektligji ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, ku synohet të garantohet mirëqenia dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së fëmijëve në Kosovës.

Përmes marrjes së masave për të siguruar jetesën, mbijetesën, zhvillimin si dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, duke i parashikuar të gjithë mekanizmat mbrojtës efektivë dhe duke e ngritur një sistem të integruar e funksional që mbron dhe garanton të drejtat e fëmijëve në të gjitha format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve.

Ky projektligj po ashtu synon të përcaktojë në mënyrë të qartë mekanizmat për garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe institucioneve përgjegjëse përmes ngritjes së një sistemi efikas mbrojtës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave abuzuese të të drejtave të fëmijëve.

Ligji parashikon për herë të parë një sistem gjithëpërfshirës të këtyre masave mbrojtëse.

Pavarësisht kushteve ekonomike, identitetit të vendbanimit, etnisë të çdo fëmijëve, ne duhet t'u garantojmë një rritje, siguri, ruajtje të identitetit, zhvillim fizik e mendor, privatësi, mirëqenie, arsimim, ushqim, strehim, argëtim, shërbim shëndetësor, arsimim, dëgjim të mendimit e të drejtat e informimit.

Në vijim ligji përmban dispozita në lidhje me masat konkrete të mbrojtjes së fëmijëve, po rëndësi të veçantë konsideroj që duhet t'u jepet dispozitave, të cilat kanë të bëjnë në lidhje me monitorimin dhe raportimin mbi respektimin e të drejtave të këtyre fëmijëve, duke përcaktuar si persona të cilët kanë detyrim për raportimin e rasteve, mbi çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, ku e shohin abuzimin, neglizhimin apo shfrytëzimin e fëmijëve, qoftë person fizik a juridik, i cili ka informacion, qoftë punonjës i institucioneve publike apo private që vjen në kontakt me fëmijët për shkak të profesionit, që janë mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social, punonjës të institucioneve shëndetësore apo edhe njerëz, të cilët përkujdesen për fëmijët.

Fëmijët janë gjëja më e shtrenjtë, jo vetëm për familjen, por për gjithë shoqërinë dhe nuk guxojmë të lejojmë që ata të dhunohen, qoftë edhe nga prindërit e tyre.

Kush punon drejtpërdrejt me fëmijët duhet të kuptojë që ka një përgjegjësi të madhe, jo vetëm që fëmija të jetë i sigurt edhe të marrë ushqim të mjaftueshëm, por për ta mbështetur në çdo moment, kur kupton që fëmija mund të jetë i rrezikuar jashtë institucionit.

Ne këtu duhet të kemi një fokus të vëmendjes dhe ta qartësojmë të marrim masa konkrete ndaj secilit person, i cili abuzon me fëmijët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

E kam lexuar me shumë kujdes Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Vërtet ky ligj përcakton përgjegjësitë e familjes, komunës, Qeverisë, por nëse mendojmë se me këtë ligj do t'i mbrojmë fëmijët, e kemi gabim, sepse si shtet, si Qeveri, si komuna, si shoqëri në përgjithësi, nuk i kemi krijuar kushtet kryesore për mbrojtjen e fëmijëve.

Tash u fol këtu për mbrojtjen e kategorive të veçanta të fëmijëve. Në fakt, ligji mbron të drejtat e të gjithë fëmijëve në Kosovë, pavarësisht çështjet nëse i takojnë një grupi të caktuar ose jo.

Mendoj që ky ligj, në fakt, është vetëm një proklamim vlerash, por nuk është një ligj i cili vërtet mbron fëmijët, një ligj i cili konkretisht krijon kushte që mbrojtja e fëmijëve të jetë e mundshme.

Fëmijët kanë nevojë për çështje shumë të thjeshta, kanë nevojë për bukë, kanë nevojë për ushqim kualitativ, të cilin ne as si shtetas, as si ekonomi nuk i afrojmë.

Kemi 120 mijë qytetarë të Kosovës që jetojnë me ndihma sociale dhe që mezi arrijnë t'i përmbushin nevojat kryesore, pra nuk arrijnë që t'i përmbushin nevojat kryesore, kështu që në këtë ambient, ku të ardhurat e familjes janë aq të ulëta, ku një numër kaq i madh i qytetarëve jetojnë nga ndihmat sociale, në një ambient ku kemi Ligjin për sigurimet shëndetësore prej vitit 2014, e ligji nuk zbatohet, në një ambient ku nuk ka hapësirë të banueshme të banimit, ku hapësira e banimit është shumë e shtrenjtë, ku fëmijët kanë nevojë për pjesën e vet të banimit, në një vend ku arsimi është degraduar bukur shumë, atëherë ne mund të bëjmë ligje jashtëzakonisht të mira, por nuk sigurojmë mbrojtjen e mirëfilltë të fëmijëve, as nuk i krijojmë kushtet e nevojshme që e ardhmja jonë, pra fëmijët të zhvillohet ashtu siç është e paraparë, ashtu siç e bëjnë shoqëritë e zhvilluara.

Po e përsëris edhe një herë, ky ligj është më shumë një ligj, i cili pak a shumë i përcakton vlerat dhe përgjegjësitë, por askush të mos mendojë që po i mbrojmë fëmijët, nëse nuk i krijojmë kushtet elementare, pra ushqimin, ambientin e sigurt, shëndetin dhe arsimin, atëherë nuk kemi mbrojtje të fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Si duket, duhet të marrim pauzë për drekë, se nuk ka tjetër rrugë, nuk kemi kuorum.

Vazhdojmë seancën në orën 18:00 pasdite. Kemi një situatë të tillë për shkak të kuorumit, në qoftë se doni ta vazhdojmë seancën, mundësitë i kemi veç në orën 18:00. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po e vazhdojmë seancën, po i mënjanojmë pikat nga 21 deri në 26 për shkak të kuorumit dhe po vazhdojmë me shqyrtimin e raporteve, të cilat po qe se bëhet kuorumi votojmë, nëse jo i lëmë vetëm për votim, për shembull...

26. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator për ujëra për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zotin Muharrem Nitaj, për arsyetimin e raportit të Komisionit Funkcional. Zoti Nitaj, e keni fjalën!

MUHARREM NITAJ: Zoti kryesues i seancës,

Raporti është miratuar më herët, në fakt nuk kam çka të shtoj më tepër nga ajo që thatë ju, prandaj i ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që t'i japin mbështetje raportit vjetor për vitin 2017.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Nitaj! E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku..., nuk është këtu, atëherë zonja Hadërgjonaj besoj që mund t'i bëjë rekomandimet edhe raportet në lidhje me raportin vjetor financiar.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujërat për vitin 2017, ku kanë qenë të pranishëm në mbledhje edhe përfaqësuesit të Autoritetit Rregullator për Ujëra. Komisioni për Buxhet dhe Financa, për të gjitha çështjet, të cilat i ka ngritur brenda komisionit, ka marrë përgjigje nga Autoriteti Rregullator për Ujëra dhe e ka përkrahur raportin financiar të Autoritetit Rregullator dhe rekomandojmë që edhe Kuvendi ta bëjë miratimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, zoti Andin Hoti e ka fjalën, në emër të PDK-së.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ju njoftojmë se e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017 dhe nuk kemi çka të shtojmë. I ftojme kolegët deputetë që ta votojnë, ta përkrahin këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu, është e njëjta situatë, ky është miratuar në komision. Edhe ne si Aleancë e kemi shqyrtuar me kujdes dhe mendoj që është njëri prej raporteve më të mira që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, kemi pasur edhe një plotësim-ndryshim të ligjit, i cili do t'i rregullojë problemet, të cilat i ka të gjetura ky raport dhe shpresoj që do të jetë në Kuvend shumë shpejt. Aleanca do ta përkrahë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

27. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2017, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim me rekomandimet e Komisionit Funkcional. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet

dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kush e do fjalën në emër të Komisionit? Zoti Andin Hoti, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Edhe një herë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe të komisionit, ne e kemi dhënë vetëm kontributin tonë në Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe i ftoj kolegët deputetë që ta përkrahin raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit në vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Raporti vjetor është dorëzuar brenda afatit ligjor dhe sipas të dhënave të kërkuara raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe klasifikimet në vitin paraprak.

Buxheti fillestar i ndarë për Zyrën Kombëtare të Auditimit ka qenë në shumën prej 2 milionë e 397 mijë euro, buxheti pas rishikimit ka qenë 2 milionë e 416 mijë euro, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë 2 milionë e 381 mijë euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 2 milionë e 273 mijë euro. Sipas kategorive ekonomike për paga dhe mëditje janë realizuar 99,4%, mallra dhe shërbime 83,9% dhe shpenzime komunale 81,5%.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar të hyra vetjake në shumën prej 2 mijë e 415 euro, të cilat janë depozituar në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017 vlerësoi se raporti i përmbush obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zoti Faton Topalli, në emër të PSD-së, e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Deputete,

Raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është njëri prej raporteve të rralla të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës, i cili është në nivelin e detyrave dhe përgjegjësive që i takojnë një institucioni të pavarur. Unë e shfrytëzoj këtë rast ta falënderoj Auditorin dhe të gjithë punonjësit e këtij institucioni të pavarur për punën e mirë që bëjnë dhe t'i inkurajoj të vazhdojnë të bëjnë punën e cila u takon. Unë nuk kam vërejtje të punës së këtij institucioni në tërësi, megjithatë dua ta shtroj një çështje që nuk ka të bëjë me rezultatet e punës, por me barazinë gjinore brenda këtij institucioni.

Në vitin 2015, thuhet në raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017, numri i drejtoreshave në këtë institucion ishte 41,2%, ndërsa numri i drejtorëve 58,8%. Një vit më vonë, në vitin 2016, numri i drejtoreshave në këtë institucion është 36,8%, ndërsa numri i drejtorëve në përqindje 63,2%. Në vitin 2017, përqindja e drejtoreshave në këtë institucion është 29%, ndërsa i drejtorëve 71%. Nga raporti del që prej vitit 2015 deri në vitin 2017, jo vetëm që nuk është ngritur numri i grave drejtoresha, por ka shënuar një rënie të vazhdueshme.

Çështja e dytë e cila dua ta shtroj ka të bëjë me raportimin për rekomandimet që ia jep Auditori Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucioneve të pavarura dhe komunave. Ajo që mua më shqetëson është fakti që jepet në raportin e Auditorit, se jo vetëm që nuk kemi përmirësim në zbatimin e rekomandimeve, por në përgjithësi kemi përkeqësim të të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë këtu edhe komunat që kanë bërë një përparim shumë të vogël prej 4%. Për të qenë më konkret, dua t'i paraqes këto shifra të nxjerra nga raporti: në vitin 2016 janë zbatuar 28% e rekomandimeve në institucionet qendrore, ndërsa 37% kanë qenë në proces.

35% e rekomandimeve nuk janë adresuar fare. Nëse i bëjmë së bashku rekomandimet e paadresuara dhe ato që janë në proces, në vitin 2016 në nivelin qendror, 72% e rekomandimeve nuk janë zbatuar. Në nivelin e institucioneve të pavarura, sipas së njëjtës logjikë, 72% e rekomandimeve nuk janë zbatuar, ndërsa në nivelin lokal gjithashtu nuk janë zbatuar 76% e rekomandimeve. Në vitin 2015 në nivelin qendror moszbatueshmëria e rekomandimeve është 62%, pra më e mirë se një vit më herët. Në nivelin e institucioneve të pavarura moszbatueshmëria e rekomandimeve kap shifrën 53%, që është shumë më e lartë se në vitin 2016. Në vitin 2015, 80% e rekomandimeve për komuna nuk janë zbatuar fare. Kjo situatë do të duhej të ishte shumë shqetësuese për Qeverinë, pavarësisht faktit se po flasim për shifra që lidhen me qeverisjen e kaluar, problemet e implementimit të rekomandimeve mbeten shumë shqetësuese, sepse vitet kalojnë ndërsa situata mbetet e njëjtë, pra e pandryshueshme.

Zyra Kombëtare e Auditorit është instrumenti më i mirë që kemi në shërbim të qeverisjes së mirë. Bazuar në faktet e prezantuara, del se ky institucion sikur punon kot, pasi deri më tani nga asnjëra prej qeverive të deritanishme nuk është marrë seriozisht me çështjen e zbatimit të rekomandimeve.

Kuvendi i Kosovës, duke pasur parasysh rezultatet që prezanton Auditori i Përgjithshëm, ka mjaft fakte për ta detyruar Qeverinë që të ndërmarrë hapa konkretë për implementimin e rekomandimeve, ndryshe ne i paguajmë kot 2 milionë euro në vit për auditim dhe humbim dhjetëra miliona e qindra të tjerë për shkak të moszbatimit të rekomandimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rasim Selmanaj, në emër të AAK-së.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Auditori i Përgjithshëm për dallim nga disa institucione tjera sot na ka sjellë në Kuvend një raport i cili është shumë i mirë dhe i strukturuar mirë, pra është i matshëm në një kornizë të pranuar ndërkombëtare të raportimit dhe i ilustruar me shifra dhe fakte.

Së dyti, raporti vjen pasi në fillim të vitit e kemi pranuar një plan të punës dhe kështu kemi mundësi të bëjmë krahasimet e nevojshme. Prandaj, mund të themi se kualiteti i raportimit në Kuvend është për t'u vlerësuar. Nga raporti shihet se Zyra Kombëtare në këtë vit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë auditimit, performansës në fusha me interes strategjik, paralelisht me realizimin e auditimeve të rregullsisë së të gjitha organizatave publike. Po ashtu, Zyra ka arritur mbulueshmërinë e auditimeve të ndërmarrjeve publike që është interes i Kuvendit dhe i publikut dhe besoj edhe i vetë ndërmarrjeve publike të audituara.

Auditimi i 92 organizatave buxhetore është shumë i rëndësishëm pasi raportet përmbajnë informata dhe rekomandime të rëndësishme për përmirësimin e menaxhimit ekonomik dhe financiar, dhe për shfrytëzimin më të mirë të fondeve publike.

Ky raport jep një informacion të bollshëm për punën e kësaj zyre gjatë vitit 2017, por nëse e lexojmë me kujdes misionin e saj që nëpërmjet auditimeve cilësore ta fuqizojmë llogaridhënien në Administratën Publike për përdorimin efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare dhe nëse e shtrojmë pyetjen nëse është arritur ky qëllim, natyrisht se jo. Që zbatimi i rekomandimeve të ndodhë duhet që ne në Kuvend t'i mbajmë në llogaridhënie krerët e institucioneve për moszbatimin e rekomandimeve.

Pra, nga ky raport del që ne duhet të punojmë më shumë që këto rekomandime të zbatohen. I ftoj deputetët që këtij raport t'i japin përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Balaj-Halimaj e ka fjalën. Zoti Hoti, mos i ndërroni kartelat.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate e ka trajtuar në të gjitha analizat e saj raportin vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Duam të theksojmë se ky raport është i konstruktuar mirë, përmban fakte, por ajo që kisha dashur të ngre dhe ta trajtoj këtu është që raporti ende konstaton të meta në menaxhimin e financave publike dhe në sistemin e prokurimit publik.

Ajo çka është më shqetësuese është që rekomandimet, të cilat i nxjerrë ky raport, Auditori i Zyrës Kombëtare për organizatat buxhetore në të gjitha nivelet, nuk zbatohen nga organizatat buxhetore dhe për më keq mendoj se edhe sistemi i drejtësisë ende nuk ka marrë veprime dhe ky raport nuk po trajtohet siç duhet dhe nuk është bërë një pikënisje do të thosha për institucionet, të cilat duhet të jenë në krye të detyrës për ta siguruar një menaxhim të financave publike real sipas ligjeve në fuqi dhe për ta përmirësuar punën e sistemit të prokurimit publik në të gjitha organizatat buxhetore.

Më tej mund të konstatojmë se raporti si i tillë dhe puna e respektuar e këtyre njerëzve që punojnë aty ende mbetet vetëm si një informacion për ne si deputetë këtu, ndërsa për institucionet përkatëse, qoftë ato të cilat janë të thirrura për të marrë ndoshta edhe pikënisjen për t'i trajtuar disa çështje në aspektin e sistemit të drejtësisë, qoftë si organizata buxhetore, nuk kanë asnjë veprim dhe asnjë aktivitet, i cili do të ndikonte dhe do ta shtonte masën e sigurisë dhe përmirësimin e sistemit të Prokurimit publik edhe të menaxhimit të financave publike.

Përndryshe, si të tillë ne e përkrahim, e mbështetim punën e atyre njerëzve atje, mirëpo ndoshta një ditë edhe ata do të gjenden në një situatë që do ta shohin se puna e tyre është vetëm sa për një informacion para Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Vazhdojmë:

28. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Zhvillim Rajonal, zonjën Shala-Berisha, nuk është. Zoti Muharrem Nitaj, në vend të kryetares, për arsyetimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL. Zoti Nitaj, e keni fjalën!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mungesë të kryetares së Komisionit për Zhvillim Ekonomik mund të them se raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017 ndoshta është njëri prej raporteve të mira, prej raporteve cilësore, me vlerësimin se është ndër raportet e plota dhe të sakta.

Komisioni, siç e thatë edhe ju, e ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta miratojë atë. Sa u përket deputetëve të Aleancës, në të njëjtën kohë ta shfrytëzoj edhe qëndrimin e tyre, në fakt edhe ne e kemi analizuar, e kemi shqyrtuar dhe vota jonë do të jetë pro këtij raporti. Ndoshta i vetmi defekt i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike, sikur edhe i shumë raporteve tjera, është se të gjitha raportet vijnë me një vonesë të konsiderueshme në Kuvendin e Kosovës, por ky duket që është një defekt i funksionimit të Kuvendit dhe jo i këtyre autoriteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2017 brenda afatit ligjor dhe sipas të dhënave të kërkuara.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet, të cilat kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitet paraprake. Buxheti fillestar i ndarë për Autoritetin Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare ka qenë 1 milion e 178 mijë euro, buxheti me rishikim ishte 778 mijë euro, ndërsa buxheti përfundimtar 707 mijë e 762 euro. Duke përfshirë ndryshimet që kanë ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe shkurtime sipas vendimit të Qeverisë, nga kjo shumë janë shpenzuar 672 mijë e 525 euro, apo 95,02% të buxhetit.

Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare ka realizuar të hyra vetjake në shumën prej 4 milionë e 478 mijë euro, të cilat janë depozituar në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Sa u përket shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, buxheti për paga dhe mëditje është realizuar qind për qind, kurse për mallra dhe shërbime 88%, dhe për shpenzime komunale 92,62%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 20. 6. 2018, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2017 vlerësoi se ai i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për

menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e diskutueshme, në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kryetari i Grupit, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017, dhe kemi konsideruar që ky raport ka paraqitur një gjendje reale, faktike të të gjitha angazhimeve dhe aktiviteteve të këtij rregullatori gjatë vitit në fjalë. Ne i japim mbështetje miratimit të këtij raporti, më duhet të them që edhe në punën tonë në komision kemi pas rastin që udhëheqësit e ARKEP-it t'i takojmë dhe të diskutojmë për shumë tema, të cilat ndërlidhen me punën e tyre dhe me autoritetin që kanë dhe besojmë që edhe si institucion meriton, jo vetëm që të mbështetet nëpërmjet miratimit të raportit, por edhe nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme për t'i ngritur kapacitetet, të cilat janë vlerësuar edhe në këtë raport që janë një nga problemet, të cilat kanë ngecur në këtë autoritet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Vazhdojmë:

29. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, respektivisht zëvendësen Safete Hadërgjonaj për arsyetimin e raportit të Komisionit Funkcional.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017 është dorëzuar në Kuvend në pajtim me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës.

Raporti përmban të dhëna për financimin dhe shpenzimet e fondit, duke përfshirë dhe aktivitetet, investimet, kontributin dhe pensionimet. Pjesë e raportit vjetor është edhe raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrave financiare për vitin 2017.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 18. 7. 2018, e shqyrtoi raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017 dhe vlerësoi se raporti përmban informacione që kërkohen sipas ligjit, ku jepen informacione për investimin, për sigurinë e Fondit Pensional, shumëllojshmërinë e investimit, fitimin maksimal në përputhje me sigurinë e Fondit Pensional dhe me mbajtjen dhe likuiditetin adekuat, gjë që tregon edhe performansa pozitive në kthimin e mjeteve të investuara në vlerë nominale prej 102,6 milionë euro.

Raporti përmban edhe të dhëna për shpenzimet operationale të fondit në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin përkatëse. Si rezultat, komisioni ka vlerësuar se raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017 përmban obligimet ligjore për raportim dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim të këtij raporti.

Një çështje tjetër, me të cilën dëshirojmë ta informojmë Kuvendin, ka të bëjë me vendimin e Bordit për nivelizimin e pagave të stafit menaxherial të Fondit në paga të stafit të ngjashëm të Bankës Qendrore të Kosovës.

Sipas rekomandimeve të Kuvendit, me rastin e shqyrtimit të raportit vjetor në vitin 2016, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka komunikuar me Bordin Drejtues dhe ia ka drejtuar një shkresë për zvogëlimin e këtyre pagave, respektivisht për harmonizimin e pagave të stafit menaxherial të Fondit me ato të Bankës Qendrore të Kosovës. Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit, Bordi ka njoftuar me shkrim se ka bërë nivelimin e pagave të stafit menaxherial të Fondit sipas kërkesave të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ky harmonizim është bërë me stafin e Bankës Qendrore të Kosovës. Kjo është komunikuar edhe gojarisht nga kryesuesi i Bordit në rastin kur ky ka paraqitur arsyeshmërinë e Raportit të Fondit në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare, e dëshiron dikush fjalën? Zonja Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Raporti i Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2016 është në harmoni me Ligjin që e rregullon fushëveprimtarinë e këtij institucioni. Është raport i detajuar dhe përmbajtjesor. Nga raporti vërejmë se në vitin 2017 ka kthim nga mjetet e investuara prej 102,6 milionë euro, me një vlerësim neto të çmimit të njësisë prej 6,5%.

Investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, në vitet e fundit kanë pasur kthim pozitiv në 9 vjetët e fundit në vlerë 464,8 milionë euro, ose me një rritje të çmimit të njësisë prej 70,2%.

Fondi në fund të vitit 2017ka pasur nën menaxhim 1 miliard e 634 milionë euro, kurse rritja neto gjatë vitit ka qenë 216 milionë euro. Numri i kontribuuesve aktivë gjatë vitit 2017 ka qenë 591 mijë e 527 kontribuues, ku shohim se llogari të reja të hapura në vitin 2017 kanë qenë 49 mijë e 688 sosh.

Sipas raportit që kemi në shqyrtim, Fondi i Kursimeve Pensionale ka investuar në tregjet financiare globale 90,3% të mjeteve nën menaxhim, kurse ekspozimi në Kosovë është 9,7%. Më gëzon fakti që deri më tani ka pasur stabilitet në tregjet financiare ndërkombëtare dhe ka pasur kthim pozitiv të këtyre mjeteve. Një tronditje e lehtë e tregjeve financiare ndërkombëtare pa dyshim që do të reflektojë edhe në mjetet tona, siç ka ndodhur në vitet e krizës financiare ndërkombëtare gjatë viteve 2008-2009, kur kemi pasur kthim negativ të mjeteve të investuara.

Nga raporti shohim se investimet janë bërë në 40 shtete, përfshirë këtu edhe Afrikën, Azinë dhe shumë vende të tjera. Mjetet tona, pra kursimet tona qarkullojnë në 40 shtete të botës, kurse një përqindje shumë e vogël e këtyre mjeteve qarkullon në vendin tonë, sepse kështu e ka paraparë edhe ligji.

Mendoj se është koha të mendohet më me seriozitet për mundësinë e qarkullimit të këtyre mjeteve në Kosovë, e në të njëjtën kohë, të ruhet vlera e mjeteve të fondit.

Ne kemi një shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik, me një disbalancë të madhe në mes të eksportit dhe importit si pasojë e nivelit të ulët të prodhimitarisë vendore, e në anën tjetër miliona euro të privatizimit dhe të kursimeve pensionale qarkullojnë jashtë vendit, ku ne po kontribuojmë në zhvillimin ekonomik të vendeve të tjera, e nuk po kontribuojmë me mjetet tona në zhvillimin e vendit tonë.

Në disa faqe të raportit shohim të shkruar se ne po investojmë në të ardhmen me këto mjete, ku të gjitha mjetet qarkullojnë në tregjet ndërkombëtare.

Nëse shikojmë demografinë e kontribuuesve, vërejmë se vazhdon trendi i njëjtë, 68,8% e kontribuuesve janë meshkuj, kurse 31,2% të kontribuuesve janë femra. Kosova duhet të ketë politika që stimulojnë punësimin e grave dhe vajzave në Kosovë.

Për shpenzime operationale Fondi i Kursimeve Pensionale ka shpenzuar një milion e 181 mijë euro, ku 760 mijë e 852 euro, apo 64% të mjeteve janë shpenzuar për pagat e stafit dhe të Bordit.

Nga raporti shohim se mesatarja e shpenzimeve të stafit është 1 919 euro, kurse mesatarja e shpenzimeve të Bordit drejtues është 1 927 euro. Edhe përkundër faktit se këtu të gjithë anëtarët e Bordit e kanë si punë dytësore këtë punë.

Këtij raportit i është bashkangjitur edhe raporti i auditorit, ku auditori ka dhënë në opinion se pasqyrat financiare japin një pasqyrë të drejtë në të gjithë aspektet materiale dhe pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për miratimin e raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe rekomandon që të miratohet ky raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grup ynë Parlamentar e ka shqyrtuar këtë raport, raporti përmban informacionet e duhura dhe ato që kërkohen sipas ligjit.

Grupi ynë Parlamentar ka qenë i fokusuar në dy çështje kryesore që ne mendojmë se janë kryesore për Fondin Pensional.

Nën një është siguria e investimeve të këtij fondi dhe ne rekomandojmë që Bordi i fondit ta japë çdo herë brenda raportit një analizë të sigurisë së investimeve të fondit për vitet e ardhshme, qoftë për një periudhë dyvjeçare ose trevjeçare, edhe pse e dimë që është e vështirë, po prioritet për këtë fond është siguria e investimeve.

Nën dy, kemi qenë të fokusuar apo çështja e dytë që kemi qenë të fokusuar si grup parlamentar dhe e shohim të udhës që fondi, po edhe Kuvendi të dalë me një rekomandim që këto fonde t'i drejtojmë drejt investimeve në Kosovë.

Duke pasur parasysh se struktura apo koncepti ynë financiar, buxheti i Kosovës është një ndër buxhetet më stabile në rajon, ndoshta edhe në Evropë, për arsye që ne vetë i dimë, atëherë pse nuk shihet mundësia e investimeve në Kosovë të këtij fondi?

Çdo shtet, i cili ka një seriozitet që e di që është shtet, këtë fond e përdor për rritjen e treguesve ekonomikë brenda vendit të vet. Është koha edhe momenti i duhur që edhe ne ta shqyrtojmë këtë mundësi, duke i rekomanduar Bordit edhe fondit që investimet e ardhshme të planifikohen për investime në Kosovë.

Ne shpesh marrim kredi të buta dhe kredi zhvillimore me kushte, të cilat ky fond u jep investuesve të tjerë jashtë Kosovës. Atëherë pse nuk është një praktikë e tillë edhe ky fond të hyjë në raporte me shtetin tonë për të investuar në Kosovë?

Sidomos kjo analiza e riskut duhet të bëhet për vitet e ardhshme, sivjet, për shembull, është një treg jo shumë i sigurt dhe nuk e di ky raport çfarë do të jetë për vitin 2018, trendët janë të tilla që risku në vitin 2018 të jetë shumë më i madh se në vitin 2017. Atëherë pse të mos të bëhet një analizë edhe për vitin 2019. Është momenti i duhur që Komisioni për Buxhet dhe Financa ta japë një rekomandim, ta japë një propozim për shfrytëzimin e këtij fondi, në një, prioritet risku, nën dy prioritet investimet e këtij fondi në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate e ka trajtuar raportin e Fondit të Kursimeve Pensionale dhe nuk dua t'i përsëris parafolësit, por ajo që vlen të theksohet them se më shqetëson qasja e mosangazhimit fare të këtij Bordi që të gjejë në mënyrë analitike dhe shumë vlerësuese një mundësi se si këto investime të kthehen në vend. Kjo është shqetësuese se vit pas viti nuk kemi asnjë qasje, asnjë ndryshim nga politikat e ndjekura deri më tani.

Prandaj, ne bëjmë thirrje, ashtu siç tha edhe zoti Kuçi, që Komisioni për Buxhet dhe Financa t'i rekomandojë, por edhe Kuvendi këtij fondi që të hartohet një projekt, një plan, i cili do të mundësonte investime brenda në vend, sepse përndryshe ne nuk mund të quajmë edhe nuk ta pranojmë se ky fond po bën një zhvillim ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë nuk jam ekspert i ekonomisë, veç është tepër shqetësuese kur e dimë që në Kosovë bankat japin kamata deri në 11 e 17%, ndërsa Kosova i posedon rreth një miliard e gjysmë euro jashtë Kosovës dhe shiten me 1%.

Unë mendoj që edhe si Parlament, po pse të mos e ftojme edhe ministrin e Financave, qoftë edhe në një interpelancë ose të kemi edhe debat parlamentar, po ashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa që t'i nxjerrim disa konkluzë, të kërkojmë prej Ekzekutivit t'i ndërmarrim masat që këto mjete të kthehen në Kosovë, sepse absolutisht nuk ka logjikë kur e dimë çfarë gjendje ekonomike është në Kosovë, ndërsa këto mjete, siç e tha deputetja Hadërgjonaj, janë të investuara në shtetet afrikane.

Ne kemi më shumë nevojë këtu për këto mjete, edhe ne ta kryejmë detyrën tonë si Parlament, të kërkojmë prej ekzekutivit që të veprojë që ato fonde të kthehen në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

30. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zotin Nait Hasani, për arsyetimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL, zoti Hasani e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegë,

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin e Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017 më 22.6.2018, ka analizuar këtë raport dhe të gjeturat që janë në raport janë konform të gjitha atyre rregullave që Radiotelevizioni i Kosovës ka vepruar dhe ka punuar me gjithë buxhetin që e ka pasur.

Ka arritur objektivat, për të cilët edhe është aty edhe Bordi, por neve na duhet që ky raport me disa sugjerime duhet të miratohet në seancë dhe të jepet një mundësi dhe vërejtjet e tjera që i ka, po ashtu që i kemi dhënë, të miratohen.

Prandaj, po kërkoj nga kolegët që ky raport për Radiotelevizionin e Kosovës, të cilin jemi në procedim edhe të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, është në Qeveri, presim që edhe ajo të na kthehet shpejt, ta miratojmë edhe atë ligj e të japim mundësi që Radiotelevizioni i Kosovës të jetë konkurrent me televizionet e tjera në Kosovë dhe në rajon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj zonjën Safete Hadërgjonaj, nënkryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, për arsyetimin e raportit me rekomandim në lidhje me raportin vjetor financiar.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Radiotelevizioni i Kosovës e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2017 sipas të dhënave të cilat i kërkon Ligji i Radiotelevizionit. Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe të hyrat e realizuara të këtij institucioni për vitin 2017.

Buxheti total i RTK-së për vitin 2017 ka qenë 13 milionë e 215 mijë euro, kurse buxheti i shpenzuar ishte 13 milionë e 67 mijë euro, apo 98,88 për qind. Sa i përket burimit të të hyrave nga buxheti i Kosovës, ka qenë 11 milionë euro, të hyrat nga marketingu kanë qenë 1 milion e 973 mijë euro, ndërsa të hyra të tjera 241 mijë e 707 euro.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike është si në vijim:

Shpenzimet për paga dhe mëditje janë realizuar 100 për qind, mallrat dhe shërbimet janë realizuar 121 për qind. Kemi një tejkalim të shpenzimeve në këtë kategori për 21,95 për qind, ndërsa buxheti i realizuar për kategorinë shpenzime komunale është 81,51 për qind dhe investime kapitale, buxheti është shpenzuar 50,91 për qind.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen, të cilën e ka mbajtur dhe ka shqyrtuar këtë raport ka ngritur disa çështje të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e këtij institucioni, siç janë shpenzimet për produksionet e pavarura, shpenzimet e kontraktuara për korrespondentë të jashtëm. Po ashtu është kërkuar sqarim edhe për numrin e madh të punëtorëve, i cili po shkon gjithnjë duke u rritur në këtë institucion, pra nga viti në vit.

Përfaqësuesit e RTK-së kanë dhënë sqarime për të gjitha këto çështje, të cilat janë ngritur nga deputetët, anëtarë të këtij komisioni dhe në fund komisioni më 18.07. e ka vlerësuar se raporti i përmbush të gjitha obligimet të cilat parashihen me ligj për t'u raportuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport të RTK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka znj. Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues! Ndonëse në dukje të parë raporti i RTK-së duket se është më i mirë, sepse është me ngjyra, e kanë bërë në formë të përmbledhur, por në fakt, kur e sheh përmbajtjen, për fat të keq ajo mbetet pothuajse e ngjashme me atë të viteve të mëhershme, ndonëse duhet përshëndetur disa përpjekje të Bordit, në veçanti për të bërë disa ndryshime, gjegjësisht përmirësime në punën e RTK-së.

Por, për fat të keq, RTK ende nuk drejtohet nga njerëz profesionistë, por ai drejtohet nga politika dhe përderisa vazhdon të drejtohet nga politika, gjendja aty nuk ka për të ndryshuar dhe do të vazhdojë të mbetet e njëjtë.

U tha edhe nga Komisioni për Buxhet e Financa se ka pasur dhe vazhdon të ketë keqpërdorim të buxhetit, ku linja për paga dhe mëditje, gjegjësisht ato për mallra dhe shërbime tejkalojnë parashikimin, derisa asnjëherë nuk kanë arritur që as t'i planifikojnë si duhet, e aq më pak t'i shpenzojnë si duhet ta zëmë pjesën që u dedikohet investimeve kapitale.

RTK-ja ende vazhdon të mbetet oazë për punësime partiake të militantëve, por edhe familjarëve dhe po ashtu vazhdojnë të promovohen njerëz, të cilët as nuk i plotësojnë kriteret për pozitat në të cilat ata promovohen, por as nuk ndiqen të gjitha procedurat, të cilat duhet ndjekur për promovimin e tyre në pozita të caktuara.

Kohët e fundit hapësira e RTK-së po përdoret më shumë për promovime personale qoftë të deputetëve të ndryshëm apo të drejtuesve të RTK-së, sesa një hapësirë që i dedikohet interesit të publikut. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për edicionet informative, të cilat i dedikohen politikës, por tashmë politikanët dhe drejtuesit e tjerë kanë filluar të zënë hapësira të dedikuara për argëtim dhe sport. Pra, politikanët janë shndërruar tashmë edhe në ekspertë të argëtimit dhe sportit. Ndoshta kjo disave u shkon më mirë.

Nuk ka asnjë strategji, e aq më pak një vizion të qartë se cili është interesi i publikut, të cilin duhet ta promovojë RTK-ja. Shembulli më i mirë për ta ilustruar këtë, pasi që programet e tjera i kemi përmendur herëve të tjera, është programi satelitor, i cili i dedikohet diasporës. Këtë verë ne kemi takuar përfaqësues të ndryshëm të diasporës nga vende të ndryshme, kryesisht të Evropës, e të cilët kanë pasur ankesa të mëdha me programet që RTK-ja i transmeton përmes programit satelitor, e që kryesisht i dedikohet diasporës sonë. Ata transmetojnë muzikë që është pa shije dhe aspak nuk promovon as vlerat kulturore të shoqërisë sonë në përgjithësi dhe aq më pak interesat shtetërore të Kosovës.

Pra edhe një herë, për ta ndërruar gjendjen në RTK, duhet të ndërrohet mënyra e menaxhimit të saj. Ky institucion duhet të menaxhohet nga profesionistët dhe jo nga politikanët. Derisa menaxhohet nga politikanët, gjendja aty nuk do të përmirësohet. Prandaj edhe grupi ynë parlamentar nuk do ta japë votën pro për raportin e RTK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka z. Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë!

Raporti vjetor i RTK-së për vitin 2017 paraqet pothuajse gjendjen reale të transmetuesit publik, të arriturat dhe vështirësitë në të cilat është përballur ky transmetues gjatë vitit 2017.

Dy problemet kryesore për transmetuesin publik vazhdojnë të mbeten çështja e financimit dhe e pronës. Këto dy sfida e rrezikojnë të ardhmen e RTK-së. Po besojmë se me procedimin e ligjit të ri të RTK-së që pritet të procedohet shpejt këtu në Parlamentin e Kosovës, këto dy probleme, pra prona dhe financimi, të zgjidhen. Po ashtu me ligjin e ri do të krijohen kushte për pavarësinë editoriale të transmetuesit publik dhe për të gjitha këto pakënaqësi, të cilat po shfaqen jo vetëm këtu në Kuvend, por në përgjithësi në publik.

Raporti i punës së RTK-së paraqet kryesisht aspektin përmbajtjesor editorial që tregon për përmbajtjen e programit në katër shtyllat e misionit të këtij transmetuesit, pra informimit, edukimit, argëtimit dhe kulturës. Sa i përket informimit, RTK mund të them se është relativisht e pasur me lajme, pasi që në kuadër të saj ka edhe kanalin e tretë që ofron lajme 24 orë, por edhe i magazinave të ndryshme informative.

Gjithashtu RTK ka edhe ueb-faqen e vet që përmbush mjaft mirë segmentin e informimit në RTK. Ndërsa sa i përket aspektit kulturor dhe argëtues, edhe këtu shohim se ka mjaft programe të kësaj natyre.

Nga raporti del se programet sportive në RTK janë të pasura. Pothuajse të gjitha ngjarjet e rëndësishme sportive me interes nacional transmetohen. RTK ka mungesë të programit edukativ. Ende nuk po shohim mjaft programe edukative. E dimë që realizimi i këtyre programeve është mjaft i shtrenjtë dhe e dimë po ashtu mundësinë financiare të RTK-së. Por, menaxhmenti duhet të gjejë forma për të pasur sa më shumë program edukativ.

Ndërsa sa u përket pasqyrave financiare, mendoj se auditori e ka dhënë opinionin e vet dhe përtej kësaj nuk kam çka të shtoj dhe auditori e ka dhënë vlerësimin se ka pasur menaxhim të drejtë të mjeteve në RTK.

Ne si grup parlamentar i japim përkrahje këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Diskutimet kanë përfunduar. Po, zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: E dëgjova z. Selmanaj, i cili në fund tha se ne si grup parlamentar do ta votojmë raportin lidhur me RTK-në. Unë dua të them se unë personalisht nuk do të votoj për këtë raport. Pra, nuk është qëndrimi unik i AAK-së. Ka probleme shumë të mëdha RTK-ja. Unë nuk po dua t'i numëroj këtu, por po i përmend vetëm disa, duke filluar nga menaxhmenti, anshmëria politike, borxhet që i ka RTK-ja, dikush thotë 4 e dikush thotë 6 milionë, marketingu me kompensim e deri te kontratat e dyshimta dhe të dëmshme për këtë medium. Prandaj për hir të opinionit publik dua të them që nuk do ta jap votën pro këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Nitaj. Të tjerë nuk ka të paraqitur. Atëherë i përmbysim diskutimet edhe për pikën e 30-të të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës.

31. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017 dhe Kuvendit i rekomanduar për miratim. Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zhvillim Rajonal, zonjën Sala Shala-Berisha, për arsyetimin e raportit të Komisionit Funkcional.

Donika, ulu ose ejani uluni bashkë e flisni! Zonja Shala, e keni fjalën.

SALA SHALA-BERISHA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018 shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2017 të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Kuvendit i rekomandon të miratohet ky raport.

Arsyetim: Në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 03L-076 për Hekurudhat e Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ia paraqet Kuvendin raportin vjetor të punës.

Komisioni bazuar në nenin 72 të Rregullores e ka shqyrtuar këtë raport dhe ka vlerësuar se raporti i punës për vitin 2017, i parashtuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, është në pajtim me nenin 4 të këtij ligji dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Gjithashtu, po shfrytëzoj rastin që edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të shpreh mbështetjen tonë të miratimit në parim të këtij raporti të punës të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Autoriteti Rregullator i Hekurudhave e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2017 brenda afatit ligjor dhe në pajtim me Ligjin për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave.

Buxheti fillestar i ndarë për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave ka qenë në vlerë prej 303 mijë e 823 eurosh. Buxheti përfundimtar ishte 313 mijë e 823, kurse buxheti i shpenzuar ishte

291 mijë e 300 euro, apo 92,82%. Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë në paga dhe mëditje 96,26%, mallra dhe shërbime 87,12% dhe shpenzime komunale 98,47%. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ka realizuar të hyra në shumë prej 2 mijë e 450 euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 25 korrik, pasi që shqyrtoi raportin vjetror financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017, ka vlerësuar se ky raport i plotëson të gjitha obligimet ligjore të parapara me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare nuk janë paraqitur për diskutim, domethënë raporti është në rregull, nuk ka ndonjë vërejtje. Diskutimi konsiderohet i përfunduar, ngelet vetëm votimi për këtë pikë.

32. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, zotin Fehmi Mehmeti, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017. Zoti Mehmeti, e keni fjalën.

FEHMI MEHMETI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të kërkesës të paraparë me Ligjin e Bankës Qendrore, kam kënaqësinë të jem para jush për ta prezantuar raportin vjetor për vitin 2017. Raporti vjetor është përgatitur në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në muajt e parë të vitit 2017. Në pajtim me nenin 35 të Ligjit të Bankës Qendrore, raporti është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 31 maj 2018 dhe rrjedhimisht, në pajtim me nenin 58 të Ligjit të Bankës Qendrore ai i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë qershorit të vitit 2018.

Gjatë vitit 2017 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur që me sukses t'i realizojë objektivat e saj ligjore, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm dhe në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Gjatë këtij viti, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar t'i avancojë kapacitetet e saj institucionale në të gjitha sferat e fushëveprimit të saj. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe ofrimit të shërbimeve efikase për autoritetet publike, institucionet financiare dhe publikun në përgjithësi.

Në vijim më lejoni të prezantoj para jush një përmbledhje të raportit vjetor të Bankës Qendrore për vitin 2017, duke përfshirë zhvillimet ekonomike në sektorin e jashtëm në Kosovë, zhvillimet

në sistemin financiar të Kosovës si dhe zhvillimet në kuadër të funksioneve të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ekonomia e eurozonës gjatë vitit 2017 ka vazhduar të regjistrojë normë pozitive të rritjes, ndërsa inflacioni ka vazhduar të jetë edhe në objektivin e Bankës Qendrore Evropiane, përkundër që ka shfaqur shenja të përmirësimit ndaj caktimit prej rreth 2%.

Shkalla vjetore e rritjes së bruto produktit vendor për vitin 2017 ishte 2,4%, rritje e mbështetur kryesisht nga konsumi privat, investime dhe përmirësimi i pozicionit neto të eksporteve, si rezultat i rikuperimit ekonomik në nivel global. Bazuar në parashikimet e Bankës Qendrore Evropiane, ekonomia e eurozonës vazhdoi të rikuperohet edhe në vitin 2018.

Performansa e favorshme e ekonomisë së eurozonës kishte ndikim pozitiv edhe në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, duke u manifestuar me përmirësim të pozicionit neto të eksporteve, si dhe rritje të investimeve të huaja direkte, të cilat dhanë kontribut të rëndësishëm në vazhdimin e rritjes së këtyre ekonomive. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik si dhe ngritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare kanë shtuar presionet inflacioniste në rajon, të cilat u reflektuan me një ngritje të nivelit mesatar vjetor të inflacionit në rreth 1,9%, nga 0,3% sa ishte një vit më parë.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të rritet edhe gjatë viti 2017. Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, norma reale e rritjes ekonomike në vitin 2017 ishte 3,7%. Kjo rritje e aktivitetit ekonomik është gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve prej 10,7%, përderisa vlerësimet preliminare të Agjencisë së Statistikave japin që konsumi gjatë këtij viti ka shënuar një rënie prej 1,6%. Mbështetja e lartë e ekonomisë së Kosovës në importe në mallra nga jashtë si dhe niveli i ulët i eksportit, vazhdojnë të jenë ndër sfidat kryesore të ekonomisë së vendit.

Përkundër rritjes më të shpejtë të eksporteve prej 22,1%, në krahasim me rritjen e importeve prej 9,2%, deficitit tregtar vazhdon të jetë i lartë, ku në vitin 2017 deficitit tregtar ishte 2,7 miliardë euro, apo 41,5% e bruto produktit vendor. Deficiti i lartë tregtar i mallrave vazhdon të jetë kontribuuesi kryesor në deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, ku në vitin 2017 arritën në 425,1 milionë euro, apo 6,6% të bruto produktit vendor. Sidoqoftë, kontributi i deficitit tregtar në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale vazhdon të neutralizohet në masë të konsiderueshme nga remitencat.

Në vitin 2017 vlera e remitencave të pranuar në Kosovë arriti 759,2 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 9,9%. Përveç remitencave që në vazhdimësi janë dëshmuar të jenë burim i qëndrueshëm i financimit të konsumit në Kosovë, kontributi i diasporës në ekonominë e vendit shprehet edhe nëpërmjet shpenzimeve që ata bëjnë gjatë qëndrimit në Kosovë, si dhe investimeve të tyre direkte. Në vitin 2017, investimet e huaja direkte u karakterizuan me një rritje të konsiderueshme, duke shënuar vlerën prej 287,8 milion euro, në krahasim me vlerën prej

220 milionë euro, sa ishte në vitin 2016. Struktura e investimeve të huaja direkte në Kosovë vazhdon të dominohet nga investimet e sektorin e patundshmërisë, të cilat në vitin 2017 përfaqësuan rreth 65 për qind të gjithë investimeve të huaja direkte.

Republika e Kosovës vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm fiskal të karakterizuar me nivel të ulët të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Zhvillimi i tregut të letrave me vlerë në Kosovë gjatë viteve të fundit ka rritur mundësitë e financimit nëpërmjet borxhit për Qeverinë e Kosovës dhe në të njëjtën kohë ka arritur alternativat investive në tregun e brendshëm për institucionet financiare që operojnë në Kosovë.

Zhvillimet e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë vazhdojnë të jenë mjaft të ngjashme me zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Rikuperimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare u reflektua edhe në Kosovë, me ç'rast ekonomia e vendit shënoi një normë inflatore prej 1,5 për qind në vitin 2017, për dallim nga viti paraparak, i cili ishte karakterizuar me një normë inflacioni prej 0,3 për qind.

Aktiviteti i sistemit financiar është zhvilluar edhe gjatë vitit 2017. Sistemi financiar po vazhdon të rritet me ritëm të qëndrueshëm, duke përfaqësuar një nga komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit dhe njëkohësisht të stabilitetit të ekonomisë së vendit.

Aktiviteti kreditor i sektorit bankar ka vazhduar të karakterizohet me ritëm të përshpejtuar të rritjes si rezultat i përmirësimit të kushteve të kreditimit nga bankat dhe rritjes si rezultat i përmirësimit të kushteve të kreditimit nga bankat dhe rritjes së kërkesave për kredi nga ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Në vitin 2017, vlera e kredive arriti në gjithësej 2,5 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11,5 për qind. Gjatë vitit 2017, kreditimi i gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi rritje, ku vlen të theksohet veçanërisht rritja e kredive për sektorin e ndërtimit, bujqësisë dhe prodhimit, 26,1 për qind, 3,4 për qind dhe 9,3 për qind respektivisht. Struktura e kredive të sektorit bankar mbetet e ngjashme me vitet e kaluara, kur kreditë për sektorin e tregtisë përbëjnë rreth 50,4 për qind të gjithësej kredive për ndërmarrjet.

Struktura e kredive të sektorit bankar në masë të madhe reflekton vetë strukturën e ndërmarrjeve që operojnë në Kosovë, ku ndërmarrjet tregtare kanë pjesëmarrje më të lartë. Një shpërndarje më e madhe e strukturës së kredive drejt sektorëve më pak të kredituar të ekonomisë, por që kanë potencial për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik do të ishte mjaft i dobishëm për ekonominë e Kosovës. Zvogëlimi i theksuar i normave të interesit në kredi nga bankat që po ndodh në dy vjetët e fundit paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm për lehtësinë në qasjen në financa edhe për këta sektorë.

Rol të rëndësishëm po luan edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes dhe ka kaluar vlerën mbi 30 milionë euro në fund të vitit

2017. Përveç ritmit të përshpejtuar të kreditimit, ekonomia e Kosovës në vitin 2017 përfitoi edhe nga përmirësimi i mëtejshëm i kushteve të kreditimit nga bankat. Norma e interesit në kredi që për një kohë të gjatë ishin konsideruar si një ndër pengesat kryesore të zhvillimit të biznesit në vitin 2017 vazhduan të shënonin rënie, duke zbritur në nivelin mesatar të vendeve të rajonit. Në fund të vitit 2017, norma mesatare e interesit në kredi ishte 6,8 për qind, krahasuar me normën prej 7,2 për qind që ishte një vit më herët. Zvogëlimi i normës së interesit në kredi, ndërmjet tjerash, reflekton rritje të vazhdueshme të konkurrencës dhe efikasitetit në sektorin bankar, por edhe përmirësime të vazhdueshme në ambientin e përgjithshëm afarist.

Prandaj, vazhdimi i reformave që përmirësojnë ambientin afarist do të mundësojë përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të financimit në ekonominë e vendit.

Zvogëlimi i kostos së financimit kreditor është ndikuar edhe nga norma e interesit në depozita, e cila në vitin 2017 ishte 1,3 për qind. Përfundimi i rritjes së kreditimit së bashku me zvogëlimin e normës së interesit tregon se Kosova ka shënuar një progres të theksuar në lehtësimin e qasjes në financa, e cila paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të pasur një zhvillim më të madh ekonomik.

Burimi kryesor i financimit në sektorin bankar vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura brenda vendit të cilat gjatë gjithë periudhës së funksionimit të sektorit bankar janë dëshmuar të jenë një burim i qëndrueshëm i financimit. Në vitin 2017, vlera e përgjithshme e gjithsej depozitave në sektorin bankar arriti vlerën në 3,1 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 6,8 për qind. Kjo përqindje e lartë e depozitave shpreh besimin e lartë të publikut në sektorin bankar, të ndërtuar mbi bazën e stabilitetit që e ka karakterizuar këtë sektor që nga fillimi i funksionimit të tij.

Gjatë vitit 2017, treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar, përgjithësisht shënuan përmirësim të mëtejshëm duke sforcuar kështu edhe më tutje fundamentet e shëndosha të këtij sektori. Norma e kredive performuese ndaj gjithsej kredive gjatë vitit zbriti në 3,1 për qind krahasuar me normën prej 4,9 për qind sa ishte në vitin 2016.

Kosova vazhdon të ketë një cilësi dukshëm më të mirë të portfolios kreditorë krahasuar me vendet e rajonit. Sektori bankar vazhdon të ketë pozicion të fuqishëm të likuiditetit, që do të thotë se bankat kanë aftësi më të lartë për t'i përmbushur detyrimet e tyre. Treguesi i likuiditetit të bankave vazhdon të qëndrojë në rreth 37,9 për qind, që paraqet nivel mjaft të lartë sesa minimumi i kërkuar rregullator prej 25 për qind.

Po ashtu sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit të normës prej 18,1 për qind, që paraqet nivelin dukshëm më të lartë sesa minimumi i kërkuar rregullativ 12 për qind. Niveli i lartë i kapitalizimit tregon se bankat kanë inkuadruar

mjaft shumë kapital vetjak, i cili mund të përdoret për t'i absorbuar tronditjet e mundshme negative pa rrezikuar mjetet e investitorëve.

Performansë në përgjithësi të kënaqshme regjistruan edhe sektorë të tjerë financiarë në Kosovë. Sistemi pensional shënoi rritje të arkëtimit të kontributeve pensionale dhe regjistroi kthim pozitiv nga investimet, duke bërë kështu që të shtohet vlera e kursimeve pensionale. Vlera e përgjithshme e aseteve të sektorit pensional arriti 1,65 miliard euro, me një rritje prej 16 për qind.

Sa i përket sektorit të sigurimeve, vlera e gjithsej primeve të shkruara bruto në vitin 2017 shënoi një rritje prej 3,9 për qind, përderisa në të njëjtën periudhë, gjithsej dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimit shënuan një rritje vjetore prej 17,8 për qind. Sektori i sigurimeve në këtë vit regjistroi performansë pozitive për dallim nga vitet paraprake, kur karakterizohej me humbje.

Përmirësimi performansës reflektohet në masë të madhe nga masat rregullore të ndërmarra nga rregullatori Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe përmirësimin e praktikave të menaxhimit të kompanive të sigurimit.

Sektori mikrofinanciar dhe jobankar vazhdoi të shërbejë si burim i rëndësishëm i financimit, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe ekonomitë familjare.

Në vitin 2017, vlera e gjithsej kredive të këtij sektori arriti 143,9 milionë euro, që paraqet një rritje prej 32,1 për qind. Norma mesatare e interesit në këtë sektor arriti në 22,6 për qind.

Për vitin 2018, parashikimet e Bankës Qendrore sugjerojnë se norma reale e rritjes ekonomike do të luhatet nga 4,2 në 4,4 për qind. Bazë kryesore e rritjes pritet të jenë investimet të cilat parashihet të shënojnë rritje reale prej 10,1 për qind, bazuar në parashikimet për rritje të investimeve publike 25,8 për qind dhe investimeve private 5 për qind.

Në vazhdim më lejoni t'ju paraqes një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të Bankës Qendrore për vitin 2017. Në cilësinë e rregullatorit financiar gjatë vitit 2017, BQK-ja gjatë vitit 2017 ka bërë një unë të vazhdueshme në avancimin e legjislacionit sekondar dhe në harmonizimin e këtij legjislacioni me direktivat e Bashkimit Evropian dhe me standardet ndërkombëtare, duke krijuar kështu një kornizë rregulative, që promovon zhvillim të shëndoshë të sistemit financiar.

Në këtë kuadër vlen të theksohen aktivitetet lidhur me përafrimin e kornizës rregulative për mbikëqyrjen e bankave me Kornizën e Bazelit dhe mbikëqyrjes së sigurimeve me solvencën 1. Në funksion të sigurimit të një procesi të licencimit financiar transparent gjithëpërfshirës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2017 ka rishikuar politikat, procedurat dhe

praktikat e licencimit dhe regjistrimit për të gjitha institucionet financiare, në mënyrë që të sigurojë një kornizë dinamike efikase dhe të strukturuar të licencimit dhe regjistrimit të institucioneve financiare.

Si rrjedhojë, numri i institucioneve financiare të licencuara nga Banka Qendrore në vitin 2017 ka shënuar rritje, duke kontribuar kështu në rritjen e konkurrencës në tregun financiar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar të bëjë mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, për të siguruar operimin e tyre në përputhje me ligjet dhe kornizën ligjore në fuqi.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar t'u ofrojë institucioneve shtetërore, institucioneve financiare dhe publikut të gjerë shërbime përkatëse bankare, si dhe ka siguruar një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme. Po ashtu, kemi vazhduar të ofrojmë infrastrukturë efikase financiare duke siguruar një sistem efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave ndërbankare.

Rritja e vazhdueshme e vlerës së transaksioneve përmes këtij sistemi, përveç që reflekton rritjen e aktivitetit ekonomik, flet edhe për rëndësinë e këtij sistemi në rritjen e formalitetit në ekonominë e vendit, duke zëvendësuar pagesat me para të gatshme. Menaxhimi i mjeteve që janë në përgjegjësi të Bankës Qendrore ka vazhduar të bëhet nëpërmjet investimeve në institucionet financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta, likuide, me një vlerësim kreditor superior.

Në shërbim të informimit të rregullt të publikut dhe autoriteteve vendimmarrëse... (*ndërprerje e incizimit*) dhe të publikojë materiale të ndryshme analitike, të cilat pasqyrojnë zhvillime ekonomik në vend.

Po ashtu, funksioni statistikor i Bankës Qendrore ka avancuar në harmonizimin e mëtejme të statistikave sipas standardeve ndërkombëtare. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar dhe vazhdojmë t'i kushtojmë edhe avancimit të funksionit të brendshëm të Bankës Qendrore, duke siguruar një qeverisje të mirë, korporatave, me ç'rast kemi ndërtuar sistem të qëndrueshëm të kontrollit të brendshëm. Ashtu siç paraqitet edhe në pasqyrat financiare të prezantuara në raportin vjetor, performansa e Bankës Qendrore vazhdon të jetë e kënaqshme, duke u karakterizuar me një rezultat financiar pozitiv.

Sa i përket bashkëpunimit të jashtëm, dëshiroj të theksoj, në veçanti aktivitetin e Bankës Qendrore në fushën e edukimit financiar nëpërmjet të cilit po synojmë të rritim njohuritë e publikut rreth sektorit financiar.

Në rrafshin ndërkombëtar, gjithashtu e kemi pozicionuar me sukses Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duke siguruar kështu përfaqësimin dhe anëtarësimin në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrjes së Pensioneve, nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit me Autoritetin Bankar Evropian, si dhe për herë të parë është ftuar të marrë pjesë në takime të rregullta të këtij institucioni, bashkë me autoritete të tjera mbikëqyrëse të rajonit dhe Ballkanit Perëndimor.

Në përmbyllje të diskutimit tim dëshiroj të theksoj dhe t'ju falënderoj për vëmendjen dhe t'ju siguroj se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar që të vazhdojë së realizuari objektivat që dalin nga Ligji i Bankës Qendrore, duke zbatuar me përpikëri të gjitha funksionet e saj në shërbim të stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për ekspozenë tuaj. Z. Mehmeti, uluni! Nëse keni pyetje, nëse deputetët dëshirojnë të bëjnë pyetje. Është nder për ne që të kemi sonte këtu për të raportuar. Fjalën e ka znj. Safete Hadërgjonaj në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar guvernator,

Të nderuar kolegë deputetë!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017. Raporti i Bankës Qendrore ka qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, është dorëzuar brenda afatit ligjor në Komision.

Raporti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ofron të gjitha të dhënat për gjendjen ekonomike në përgjithësi, për ekonominë e Kosovës që përfshin sektorin real, sektorin fiskal, sektorin e jashtëm dhe sektorin financiar, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe institucioneve të tjera të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Përveç kësaj, raporti përmban shënimet e siguruara për autoritetin, komunitetin financiar dhe publikun, si dhe për zhvillimet e brendshme dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar që ka pasur Banka Qendrore, për operacionet dhe punën e Bankës Qendrore gjatë vitit financiar që ka përfunduar, objektivat e politikave të saj dhe ngjarjet që kanë ndikuar në ekonominë e Kosovës, si dhe një parashikim mbi ekonominë në vitin vijues.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin dhe ka vlerësuar se i njëjti përmban të dhënat dhe informatat që kërkon ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka z. Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit kryesues!

E para, fillimisht, si grup parlamentar po deklarojmë se do ta votojmë raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017. Po ashtu, e falënderojmë z. Mehmeti për një paraqitje mjaft të gjerë të këtij raporti në këtë seancë.

Sigurisht se bazohemi edhe në rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa siç e dha znj. Hadërgjonaj. Po ashtu ne konsiderojmë se ky raport përmban elemente të rëndësishme dhe në një mënyrë është një udhërrëfyes i mirë për Qeverinë e Kosovës për hartimin e politikave zhvillimore. Pra, një bazament i të dhënave të duhura për hartimin e politikave zhvillimore. Duke e pasur parasysh këtë çështje dhe duke pasur parasysh që ministri aktual i Financave ka qenë udhëheqës i këtij institucioni të rëndësishëm, që ai së paku do ta ketë parasysh këtë raport për të hartuar edhe buxhetin e Republikës së Kosovës si dhe kornizat afatmesme buxhetore, 2019-2021.

Ne duhet të mësohemi si institucion që duhet të bazohemi në të dhënat që i kanë institucionet kaq të rëndësishme, siç është BQK-ja. Pra, ky është një bazament shumë i mirë për të hartuar politika zhvillimore për vendin. Në qoftë se Qeveria jonë dhe në qoftë se ministri aktual Hamza do të bazohen në këtë raport, atëherë do ta ketë shumë më lehtë për të propozuar një buxhet për vitin 2019, e sidomos për kornizat afatmesme buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka znj. Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë!

Dëshiroj të falënderoj guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës për këtë prezantim të detajuar që e bëri këtu sot për aktivitetet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2017. Po ashtu, për ofrimin e një raporti gjithëpërfshirës që neve si deputetë na lehtëson shumë punën në monitorimin e punës së këtij institucioni.

Para së gjithash, raporti vjetor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës konstaton se sistemi financiar në vend e ka një shkallë të kënaqshme të stabilitetit, i cili nënkupton se Banka Qendrore me sukses po e zbaton objektivin primar të saj që është ruajtja e stabilitetit financiar. Kjo për ne është shumë domethënëse, sepse stabiliteti i sektorit financiar nuk nënkupton vetëm qëndrueshmërinë e vetë institucioneve financiare, por është një shtyllë e rëndësishme e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik.

Sipas raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës vërejmë se ka një performansë të mirë bazuar në obligimet ligjore që ka ky institucion për nxitjen dhe mbajtjen e sistemit financiar stabil.

Banka Qendrore e Kosovës ka licencuar, por edhe ka mbikëqyrur institucionet financiare, siç janë bankat komerciale, sektorin e sigurimeve, sektorin pensional, sektorin e mikrofinancave dhe

institucionet e tjera jobankare. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur të përgatisë dhe të publikojë analiza ekonomike mbi ekonominë e Kosovës, ku shohim se ekonomia e Kosovës ka pasur rritje prej 3,7 për qind që është gjeneruar kryesisht nga rritja e investimeve, si dhe nga përmirësimi i pozicioneve neto-eksporteve si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave dhe sidomos rritjes së eksportit të shërbimeve.

Bazuar në shifrat e publikuara të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, sipas qasjes në prodhimin, rritja ekonomike në vitet për të cilat raportohet ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit të sektorit financiar, sektorit të ndërtimitarisë dhe sektorit të tregtisë. Edhe pse sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse prej 425 milionë euro, ka pasur një rënie prej 9 për qind si rezultat i rritjes së bilancit pozitiv të shërbimeve, llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore, prapë deficit i tregtisë së jashtme në mallra ka pasur rritje prej 7,6 për qind, duke arritur vlerën në 2,7 miliardë euro. Ky deficit i lartë është mbuluar nëpërmjet të ardhurave dytësore, të cilat paraqesin një të ardhur të pasigurt në të ardhmen, siç janë remitencat, që janë kategoria më e madhe në kuadër të llogarisë dytësore.

Remitencat kanë pasur rritje për 9,9 për qind, që ka arritur një vlerë prej 759,2 milionë euro, kurse investimet e huaja direkte kanë shënuar po ashtu rritje në vitin 2017, që vlen për t'u vlerësuar, sepse në të dhënat e viteve 2015-2016 kemi pasur një tendencë të rënies së investimeve të huaja direkte, kurse në vitin 2017 këto investime janë rritur për 30,8 për qind, duke arritur vlerën e 287,8 milionë euro.

Niveli i ulët i eksporteve dhe investimeve të huaja në njërin anë dhe niveli i transferteve zyrtare dhe remitencave që janë të pasigurta në të ardhmen mund të shkaktojnë rënie të rritjes së ekonomisë. Për ta ulur deficitin tregtar kërkohen masa të politikave strukturore për ta përmirësuar disbalancin e eksportit me import që do të kontribuonte në uljen e deficitit tregtar, duke rritur kapacitetet e brendshme që japin impakt në zëvendësimin e importit dhe rritjen e eksportit, duke pasur parasysh që në ekonominë tonë të tregut, megjithatë nuk është e frytshme përpjekja për të pakësuar konsumin e bazuar në mallra të eksportit, por do të ishte e dobishme çdo përpjekje për ta zëvendësuar importin me prodhimin vendas, të paktën të së njëjtës cilësi, jo duke vendosur pengesa, por duke bërë zëvendësimin e qëndrueshëm të importeve me ristrukturimin e ekonomisë dhe krijimin e një klime të përshtatshme për biznesin privat që janë konsistent në nxitjen e eksportit, prandaj mbetet obligim qeveritar që të ndërmarrë masa të duhura që të bëjë përmirësime dhe të krijojë kushte për rritjen e prodhimtarisë vendore që do të ndikonte në rritjen e eksportit.

Të nderuar deputetë,

Siç e kemi parë edhe nga raporti vjetor financiar i Qeverisë, po ashtu shohim edhe nga ky raport se sektori fiskal është karakterizuar me rritje të të hyrave prej 5,3 për qind dhe shpenzimeve për 5 për qind. Borxhi publik si përqindje e bruto-produktit vendor është 16,6 për qind, që siç është

diskutuar shpesh edhe në këtë sallë të këtij Kuvendi ka pasur rritje për 2 për qind krahasuar me vitin 2016, që ka qenë 14,6 për qind.

Të nderuar deputetë,

Është me rëndësi të theksohet edhe stabiliteti që ka qenë së sektorin financiar, ku sipas raportit shohim se ka një qëndrueshmëri në këtë sektor, për arsye se kreditë joperformuese kanë qenë në rënie dhe ka një rënie në 3,1 për qind krahasuar me vitin 2016, që ka qenë 4,9 për qind, që domethënë se ka një performansë të mirë sa u përket kredive joperformuese. Vlera e kredie është 5,2 miliardë euro, apo ka pasur një rritje të kredive në 11,5 për qind. Rritja e kredive ka qenë kryesisht për sektorin e tregtisë, ku ka pasur rritje për 26,2 për qind, të bujqësisë 13,4 për qind dhe të prodhimit 9,3 për qind. Ka zvogëlim të normave të interesit në kredi në mesatare prej 6,8 për qind, që duhet të vlerësohet, meqenëse ka qenë kërkesë e vazhdueshme që këto norma të shkojnë në drejtim të rënies.

Burimi kryesor i financimit të sektorit financiar vazhdojnë të mbeten prapë depozitat e mbledhura brenda vendit në vlerë prej 3,1 miliardë euro, apo këto depozita kanë pasur një rritje vjetore prej 6,8 për qind.

Nga raporti vërehet se sistemi pensional ka pasur rritje, në sektorin e sigurimeve ka pasur vlerë të rritur të primeve, gjë që do të thotë se Banka Qendrore ka bërë një mbikëqyrje të mirë të këtyre sektorëve, pra edhe të sektorit pensional edhe të sektorit të sigurimeve dhe të institucioneve të tjera që janë institucione bankare, institucione mikrofinanciare dhe ato financiare jobankare.

Unë dua ta ngre edhe një shqetësim, të cilin e kam ngritur edhe herë të tjera, që ka të bëjë me mikrofinancat që veprojnë si OJQ me status të beneficuar, të organizatës që e ka statusin e organizatës joprofitabile dhe nuk paguan tatim, derisa në anën tjetër krijojnë fitim. Këto institucione e kanë rritur vlerën e kredive, sidomos në vitin e fundit dhe çka është më e keqja këto institucione u japin kredi ekonomive familjare që janë në nevojë, janë në gjendje të vështirë financiare, por norma e këtyre kredive është shumë e lartë dhe sipas raportimeve të Bankës Qendrore është 22,6 për qind.

Mbetet obligim i këtij Kuvendi që të punojë intensivisht në përmirësimin e Ligjit për institucionet mikrofinanciare që ta rregullojë statusin e institucioneve financiare, që këto institucione të mos kenë statusin e përfituesit publik, por të veprojnë si mikrofinanca dhe të mbikëqyren nga Banka Qendrore.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar me kujdes raportin dhe ka dhënë rekomandimin që të miratohet një raport i tillë dhe ftoj të gjithë deputetët e Parlamentit që ta miratojnë raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë!

Grupi parlamentar Nisma Socialdemokrate e ka shqyrtuar me kujdes raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Po ashtu, e falënderoj guvernatorin për një ekspozitë që e paraqiti dhe njëkohësisht i uroj për detyrën dhe i uroj të ketë suksese në drejtimin e BQK-së.

Ajo që dua të theksoj, mendoj se parafolësit i thanë disa çështje, por unë do t'i them pak më ndryshe, meqenëse është edhe guvernatori këtu dhe besoj e jam i bindur se është dashur të jetë edhe Qeveria këtu, sepse është tepër me rëndësi kur e kemi në trajtim raportin e Bankës Qendrore të Kosovës.

Nëse i shikojmë vlerat dhe të dhënat që i ka shtruar ky raport, shihet se nuk mund ta kemi dhe ndonjë dëshirë dhe entuziazëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në vend. Nëse i shikojmë raportet ndërmjet eksportit dhe importit, nëse shihen këto vlera, kjo e jep një pasqyrim jo shprehëdhënës për një zhvillim ekonomik që është duke ndodhur në vend. Nëse shihet investimi i huaj direkt, edhe këtu kemi ngecje, dhe kjo nuk na garanton ndonjë të ardhme më të mirë sesa kemi pasur deri tani.

Ajo çka dua të them për remitencat, i nderuar guvernator, remitencat jo që po e vazhdojnë qëndrueshmërinë, është mirë që po vazhdojnë, por ato ndoshta janë bërë ndoshta të hyrat e vetme që po e ruajnë stabilitetin e vendit dhe të familjeve tona. Unë e kam këtë mendim dhe do ta shfrytëzojë rastin që ata njerëz kudo që punojnë që me paratë e tyre jo vetëm që po i mbajnë familjet tona, por po e ruajnë edhe stabilitetin e vendit dhe mirëqenien e familjeve tona.

Nëse shikohet në një çështje që e preku deputetja Hadërgjonaj, që kemi të bëjmë me mikrofinancat, dhe nëse shikohet ajo pjesa tjetër që edhe te bankat komerciale kemi rënie të normës së interesit në 6 për qind, besoj se ju pajtoheni që këto banka komerciale i kanë shmangur kreditimet për ekonominë e mesme dhe ekonominë familjare, duke i bartur dhe orientuar ato drejt ekonomisë që ekskluzivisht t'u nënshtrohen dhe të marrin kredi vetëm në sektorin e mikrofinancave, i cili e ka një normë të lartë të interesit, që do të thosha jo larg atyre fajdeve që jemi mësuar t'i dëgjojmë atyre kuluareve të ndryshme, 22,8 për qind është një normë jashtëzakonisht, e cila e rëndon dhe nuk e lejon fare të zhvillohet ekonominë e mesme dhe ekonominë familjare, sado që rritet numri i kredimarrësve aty.

Ndoshta duke ju dëgjuar juve dhe duke lexuar raportin e krijojmë bindjen se qytetarët tanë janë më të disiplinuarit në kthimin e kredive. Por, asnjëherë nuk dëgjojmë se nga po i marrin ata ato para për kthimin e atyre kredive, të cilat i marrin, jo nga zhvillimi dhe nga ajo që e prodhon

kredia si huamarrje, sidomos në mikrofinanca, por edhe ato para që ata i kthejnë i marrin nga remitencat dhe nga prindërit, vëllezërit, nga familjarët e tyre që punojnë në vendet e jashtme.

Prandaj, ne bëjmë thirrje, sidomos Kuvendit dhe Komisionit për Buxhet që të ndryshohen këto politika, sidomos në organizimin dhe dhënien e licencave dhe ligjin për funksionimin e mikrofinancave që pajtohemi që janë organizata jofitimprurëse, por në realitet janë bërë një barrë e rëndë, dhe ndoshta është një bashkëpunim shumë i ngushtë i këtyre mikrofinancave me bankat komerciale, e cila po e them edhe një herë e rëndon tej mase kredimarrësin, i cili është i detyruar të marrë kredi. Unë bëj thirrje që duhet të ndryshohen këto ligje që janë në fuqi tani për tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Besoj që sugjerimet nuk po dyshoj, ose ka argumente, ose s'ka argumente, prandaj besoj se edhe përgjegjësit e kanë parasysh, sepse edhe marrëveshjet dhe lejet e funksionimit të veprimit që janë bërë me leje të Qeverisë, me leje të institucioneve të Republikës së Kosovës. Nuk është e lehtë që tash ne të fillojmë t'i shkarkojmë dhe ta ndryshojmë gjendjen, sepse kostoja mund të jetë më e madhe për ne si shtet, sesa kostoja e atyre që dëmtohen.

Atëherë të tjerë të paraqitur nuk ka, zoti guvernator, a dëshironi t'i thoni dy fjalë të tjera, apo ta përfundojmë?

Atëherë konsideroj se edhe kjo pikë e rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017 është shteruar dhe po besoj që në seancën e ardhshme do të bëhet votimi. Edhe një herë, faleminderit, zoti guvernator, po shpresoj që do të kemi përmirësime në funksionimin e sistemit bankar në Kosovë dhe gjithashtu në rritjen e buxhetit për Kosovën. Faleminderit!

33. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, zonjën Sala Berisha-Shala, për arsyetimin e raportit të Komisionit Funkcional. Zonja Berisha, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar,
Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë dhe kolege deputete,

Ju të pranishëm,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 16.05.2018 shqyrtoi raportin vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017.

Në bazë të nenit 15.2 të Ligjit nr.03L-051 për Aviacionin Civil, jo më vonë se më 31 mars të çdo viti kalendarik, drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil duhet t'i përgatisë Kuvendit një raport gjithëpërfshirës vjetor. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 16.05.2018 shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2017, të cilin e paraqiti para deputetëve drejtori i Aviacionit Civil. Komisioni vlerësoi se raporti i punës për vitin 2017 i parashtruar nga Autoriteti i Aviacionit Civil është në pajtim me neni 15.2 të Ligjit nr.03L-051 për Aviacionin Civil dhe i rekomandon Kuvendit për miratim me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Autoriteti i Aviacionit Civil e ka dorëzuar raportin vjetor financiar në Kuvend që e ka shqyrtuar Komisioni për Buxhet dhe Financa më 25. 7. 2018. Komisioni e ka vlerësuar si pozitiv këtë raport dhe ka dhënë rekomandim për miratimin e tij, meqenëse i plotëson të gjitha parakushtet, të cilat parashihen me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Gjatë shqyrtimit të raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e këtij institucioni, të cilët u janë përgjigjur shumë çështjeve të cilat kanë qenë në fokus të interesimit të anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Buxheti fillestar i ndarë për Autoritetin e Aviacionit Civil ka qenë në shumën prej 925 mijë eurove, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë në vlerë prej 873 mijë e 762 euro, kurse buxheti i shpenzuar ishte 839 mijë e 594 euro, apo buxheti i këtij institucioni është shpenzuar 96%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë për paga dhe mëditje, si zakonisht këto institucione të pavarura i shpenzojnë qind për qind, për mallra dhe shërbime 88%, kurse për shpenzime komunale 98.47%. Autoriteti i Aviacionit Civil është një autoritet që realizon edhe të hyra. Ky institucion ka realizuar të hyra prej 1 milion e 865 mijë e 64 euro. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rekomanduar që ky raport financiar të përkrahet nga Kuvendi dhe rekomandojmë të votohet për.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha e kërkon fjalën në emër të grupit, me siguri!

SALA BERISHA-SHALA: Tani po e shfrytëzoj rastin t'i them disa fjalë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe që në fillim në emër të PDK-së e shprehim mbështetjen tonë për raportin vjetor të punës të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Autoriteti i Aviacionit Civil është një nga rregullatorët më të rëndësishëm në gamën e rregullatorëve dhe institucioneve të pavarura të Kosovës, të cilët i përgjigjen Kuvendit të Kosovës. Ai rregullon një nga sektorët, të cilët Kosova është konsideruar vazhdimisht me një përparësi krahasuese, edhe pse në një treg, ose në një mes jashtëzakonisht të vështirë, duke pasur parasysh se ka shumë aeroporte përreth vendit, të cilat i bëjnë konkurrencë aeroportit ndërkombëtar "Adem Jashari" të Prishtinës, ndërkohë që ky autoritet që i përgjigjet Kuvendit e kryen jashtëzakonisht mirë punën e vet dhe vlen të përmendet se është një raport gjithëpërfshirës, i cili ndër vite është mbështetur vazhdimisht pa asnjë kundërshtim nga anëtarët e komisioneve, të cilët përfaqësojnë subjektet politike në komision parlamentar.

Risi te ky autoritet, për dallim nga autoritet e tjera, është se deputetëve u dërgon për çdo muaj buletin informativ të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil, kështu që kanë mundësi të njoftohen edhe deputetët rreth punës së këtij autoriteti. Mirëpo, ajo që mendoj se duhet të jetë një përmbushje ose një përcaktim qind për qind i punës së tij është mungesa e monitorimit të ligjit nga ana e Kuvendit ose e deputetëve, ose mungesa për ta parë drejtpërsëdrejti, për së afërmi vështirësitë apo mangësitë që kanë në zbatimin e ligjit dhe ta shohin punën e tyre direkte, duke i vizituar kohë pas kohe edhe këtë rregullator, por edhe rregullatorët e tjerë që i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.

Edhe një herë po them, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim raportin e punës. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim, Qeveria nuk është këtu. Atëherë konstatoj që edhe shqyrtimi i raportit vjetor për Autoritetin e Aviacionit Civil për vitin 2017, pra diskutimet për raport janë shteruar. Votimi bëhet kur ta kemi kuorumin e duhur në seancë.

36. Propozimi i grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Atëherë kemi propozimin e grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare. Nuk ka nevojë të votohen fare këto, janë të miratuara pothuajse, po unë po i lexoj çfarë kërkesash ka dhe se është miratuar edhe në Kryesi.

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve të komisionit parlamentar si në vijim:

Deputetja Emilija Rexhepi propozohet anëtare e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në vend të deputetit Ahmet Isufi.

Grupi Parlamentar i Nismës Socialdemokrate ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare si në vijim:

Deputeti Ethem Arifi propozohet anëtar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në vend të deputet Enver Hoti.

Deputeti Veton Berisha propozohet dhe miratohet anëtar në Komisionin e Zhvillimit Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri, Zhvillim Rajonal në vend të zotit Bilall Sherifi.

Deputeti Veton Berisha propozohet anëtar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione në vend të deputetes Albulena Balaj-Halimaj.

Deputeti Ethem Arifi propozohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në vend të deputetit Zafir Berisha.

Deputeti Zafir Berisha propozohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në vend të deputetit Haxhi Shala.

Kjo është e shteruar, domethënë gjithçka është përfunduar dhe ju uroj të gjithëve që të filloni me angazhimet tuaja në komisionet përkatëse.

Atëherë po vazhdoj me pikën 35:

35. Propozim-vendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj kryetaren, respektivisht zëvendëskryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonjën Hadërgjonaj, që të paraqesë dhe të arsyetojë propozim-vendimin. Zonja Hadërgjonaj, e keni fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuar kryetar,

Nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Mua më vjen mirë që më në fund në Kuvend ka ardhur ligji për pagat dhe ne një herë e përgjithmonë ta zgjidhim problemin e caktimit të pagave në këtë formë siç po e bëjmë këtë dhe

siç e kemi bërë edhe për caktimin e pagave të disa institucioneve të tjera. Dua të besoj dhe të shpresoj shumë që do të punohet seriozisht në ligjin për pagat, në mënyrë që të mos përballemi me një problem të tillë, sepse është një problem që është përcjellë nga viti në viti dhe tash kemi ardhur në një situatë të tillë që të marrim një vendim në këtë formë për pagat e institucioneve, të cilat janë të pavarura.

Në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 05L-100 për ndihmën shtetërore, Komisioni i Ndihmës Shtetërore është organ i pavarur vendimmarrës për ndihmë shtetërore, i përbërë nga pesë anëtarë, ekspertë të pavarur në fushën e ndihmës shtetërore të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Anëtarët e komisionit emërohen nga Kuvendi dhe kanë mandat trevjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Procedura për përzgjedhjen e tyre tashmë ka filluar, është shpallur dhe mbyllur konkursi dhe sipas ligjit është bërë një çështje e tillë, domethënë është shpallur dhe është mbyllur konkursi. Komisioni përzgjedhës në përbërje nga kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kryetari i Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe kryetarja e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal do të vlerësojnë aplikacionet e kandidatëve dhe do ta hartojnë raportin për Kuvend, ashtu siç e ka paraparë Ligji për ndihmë shtetërore.

Duke u bazuar në Ligjin për ndihmë shtetërore, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në cilësinë e Komisionit Funkcional, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2018, pasi diskutoi për nevojën e përcaktimit të pagës për kryesuesin dhe anëtarët e këtij komisioni, si parakusht për shpalljen e konkursit dhe përzgjedhjen e tyre, i propozoi Kuvendit që me vendim të caktojë nivelin e pagës për kryesuesin prej 1145 eurosh bruto në muaj dhe anëtarët e komisionit 1044 euro, bruto, në muaj.

Vendimi i Kuvendit për nivelin e pagave duhet të fillojë të zbatohet nga data e emërimit të këtyre anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, respektivisht nga data e përzgjedhjes së kryesuesit nga vetë anëtarët e komisionit dhe vendimi të jetë i vlefshëm deri në miratimin e ligjit përkatës për pagat, i cili rregullon edhe pagat e funksionarëve të lartë publikë. Buxheti për pagat e tyre duhet të sigurohet nga Kuvendi i Kosovës nga kategoria e subvencioneve dhe e transferove, përmes ndarjeve shtesë buxhetore që do të duhej të bëhej nga Ministria e Financave. Ndërkaq, selia e punës së këtij komisioni do të duhej të ishte në objektin e Ministrisë së Financave, pranë Departamentit për Ndihmë Shtetërore, i cili organ vepron në kuadër të Ministrisë së Financave dhe siguron asistencë profesionale dhe administrative për komisionin në lidhje me veprimet ligjore për ndihmën shtetërore në përputhje me Ligjin për ndihmë shtetërore.

Sa për informacion të deputetëve të këtij Kuvendi, Komisioni për Buxhet dhe Financa me rastin e propozimit të nivelit të pagave të anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore ka marrë si

model: krahasimi i mesatares së pagave të dy agjencive të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit, puna e të cilëve është pak a shumë e ngjashme edhe me këtë komision. Rekomandojmë që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta bëjë miratimin e këtij propozim-vendimi dhe të krijohet mundësia e kryerjes së procedurave të konkursit ashtu siç e ka paraparë Ligji për Ndihmë Shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Qeveria nuk ka përfaqësues. Grupet parlamentare nuk janë paraqitur për të diskutuar, andaj konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës si diskutim është shterur. Në momentin që do të ketë kuorum, do të votohet.

Atëherë kemi pikën e 38, pika e 37 nuk mund të shqyrtohet sot, sepse kemi zgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit të RTK-së.

38. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 (një) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar

Përmes administratës së Kuvendit është kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 (një) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Ftoj kryetarët, respektivisht përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë deputetët për formimin e këtij komisioni. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së që t'i propozojë dy deputetë për anëtarë të komisioni. Nuk është këtu. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së që t'i propozojë dy deputetë për anëtarë të këtij komisioni. Zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues.

Grupi Parlamentar i PDK-së tashmë i ka proceduar emrat, anëtarë do të jenë deputeti Andin Hoti dhe deputetja Evgjëni Thaçi-Dragusha.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka anëtarët: Valon Ramadani dhe Adem Mikullovi. Grupi Parlamentar i PSD-së ka propozuar për anëtar të komisionit zonjën Shqipe Pantina. Grupi Parlamentar i AAK-së duhet ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të parë të komisionit. Zoti Isufi, e keni fjalën.

AHMET ISUFI: Grupi Parlamentar i AAK-së e propozon Rasim Selmanajn.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj, në emër të AAK-së. Ftoj Grupin Parlamentar të Listës Serbe që ta propozojë një deputet për anëtar komisioni. Lista Serbe nuk është këtu. Ftoj kryetarin, respektivisht kryetarin e Grupit Parlamentar të Nismës që ta propozojë një deputet për

anëtar të komisionit. Zoti Sherifi, e keni fjalën. Zotit Sherifi fjalën, ose zotit Hoti, sepse nuk po i punon kartela.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues. Qenkam ulur në vend të huaj! Propozoj deputeten Albulena Balaj-Halimaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi 6+ e ka propozuar zotin Albert Kinolli për zëvendëskryetar. Shpresoj që në mbledhjen e ardhshme edhe grupet e tjera do të propozojnë të ngarkuarit e vet.

39. Propozimi për zëvendësimin e dy (2) anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar emërimin e dy anëtarëve në këtë komision. Ftoj kryetarin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, zotin Dardan Sejdiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë kërkesën e komisionit. Nuk është këtu. Atëherë, e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së që ta propozojnë një deputet për anëtar të komisionit në vend të deputetit Blerim Kuqi. A keni ndonjë emër? Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Në vend të kolegut Kuqi, propozohet Donika Kadaj-Bujupi.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista Serbe nuk është këtu edhe ata mund ta plotësojnë. Në seancën e ardhshme e kryejnë edhe ata.

40. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues nga Grupi Parlamentar i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve

Unë kam pasur një kërkesë, por proceduralisht duhet t'ia jap fjalën zonjës Donika Kadaj-Bujupi që të shprehë qëndrimin dhe mendimin e saj për debatin e sotëm.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar.

Ne konsiderojmë që kjo temë përfshin dhe shfaq interes për më shumë se një numër të caktuar të deputetëve, të cilët jemi sonte në sallë. Andaj, konsiderojmë që është e nevojshme ta shtyjmë për seancën e radhës, me qëllim më të mirë që të gjejmë mënyrën më të mirë, do të thotë metodën më të mirë që të aplikojmë këtë projektrezolutë, e cila besojmë që do të kthehet në rezolutë në seancën e radhës. Meqë sonte nuk kemi kuorum për votim, po kërkojmë që edhe debatoi të shtyhet për seancën e radhës. Dhe ju kisha lutur që mundësisht, kjo vlen për të gjithë, por edhe

për shefat e grupeve parlamentare, që të mos jetë pikë e fundit e rendit të ditës, sepse meriton më shumë vëmendje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë konstatoj që pikat e mundshme për t'u shqyrtuar mbi bazën e kuorumit parlamentar dhe rregullave që i kemi për debat i kemi kryer. Kryetari e ka kërkuar fjalën.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ju falënderoj për punën e jashtëzakonshme që e keni bërë sot. Më lejoni vetëm t'ju njoftoj se në Ditën e Demokracisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka arritur të përfundojë 22 pika, duke falënderuar vullnetin tuaj. I kisha ftuar edhe nga ky përfundimi i seancës së sotme kolegët e opozitës që të vijnë dhe bashkërisht të punojmë, në mënyrë që të realizojmë edhe aprovimin, përkatësisht ratifikimin e disa marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat janë vërtet të jashtëzakonshme.

Falënderoj kolegët e opozitës nga Partia Socialdemokrate dhe Alternativa Demokratike për pjesëmarrjen e tyre sot. Faleminderit shumë, po vërtet janë disa pika ratifikimi me 2/3, janë të Bashkimit Evropian, janë dhjetëra milionë euro, janë programet e IPA-s, është shumë me rëndësi të kemi një pjesëmarrje edhe të opozitës. Kur flas për opozitën, e kam vëmendjen de dy partitë kolege, po ashtu që të kemi vendimmarrje dhe t'i përfundojmë ato çfarë na takojnë përballë qytetarëve dhe përballë vendit.

Faleminderit! Mirupafshim në seancat e radhës.

KRYESUESI: E shpall këtë seancë të mbyllur dhe seancën e ardhshme e thërret Kryesia, sipas rregullave që ka, qoftë vazhdimin apo seancën e re.

* * *

E enjte, më 20 shtator 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 13 shtator 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në vazhdimin e seancës plenare të 20 shtatorit 2018.

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të filluar më 13 shtator 2018.

Vazhdojmë me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim, i kemi pyetjet parlamentare, për të cilat deputetët herën e kaluar nuk kanë qenë në seancë për shkaqe tërësisht objektive. Sot do të vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës, në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit.

1. Koha për pyetje parlamentare

Koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta, në orën 17:30 përfundon kjo pikë e rendit të ditës. Për këtë seancë parlamentare janë parashtruar 20 pyetje parlamentare.

Deputeti Frashër Krasniqi ka pyetje për ministrin Abelard Tahirin, jo! Ok!

Haxhi Avdyli nuk është, pyetje për ministrat të cilët janë aktualisht këtu. Edhe Valentina Bunjaku s'është. Rasim Selmanaj ka pyetje për ministrin Skender Reçica. Nuk është ministri, a dëshiron ta bësh pyetjen?

RASIM SELMANAJ: Pyetjen dua ta bëj kur është i pranishëm ministri, se s'ka logjikë.

KRYETARI: Atëherë, vazhdojmë tutje. Zoti Kurteshi po ashtu nuk është, ka dy pyetje, Arbër Rexhaj ka pyetje për ministrin Bedri Hamza. Edhe ai nuk është. Po ashtu, edhe një pyetje Arbër Rexhaj për ministrin Skender Reçica. Deputeti Avdullah Hoti po ashtu s'është. Shqipe Pantina ka pyetje për Bajtush Gashin, s'është ministri. Atëherë, Bekim Haxhiu ka pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar ministër Bytyqi,

Parlamenti i Kosovës më 28 tetor 2016 e ka miratuar Ligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, ku me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe kriteret për

ushtrimin e profesioneve të rregulluara. Ky ligj është në përputhje me direktivën e Bashkimit Evropian, Parlamentit Evropian dhe Këshillin e Evropës të datës 7 shtator 2005 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale. Me këtë ligj rregullohet mënyra, organizimi dhe funksionimi për profesionet e rregulluara dhe zbatohet për çdo person, i cili kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar në Republikën e Kosovës. Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës janë, sipas këtij ligji: profesioni i mjekut, stomatologut, farmacistit, infermierit, mamisë, fizioterapeutit, veterinarit, arkitektit, inxhinierit dhe të gjitha fushave të mësimdhënësve dhe të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, edukatorit, psikologut, punëtorit social, pedagogut, ekonomistit dhe juristit.

Ligji parasheh formimin e Këshillit shtetëror për profesionet e rregulluara që përbëhet nga pesë anëtarë, të cilin e themelon ministria. Gjithashtu, me këtë ligj parashihet themelimi i Agjencisë Shtetërore të Provimeve të Kosovës, e cila themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e ministrisë përkatëse, gjegjësisht Ministrisë së Arsimit. Provimi shtetëror për profesionet e rregulluara, i obliguar sipas këtij ligji, ka për qëllim vlerësimin e njohurive dhe aftësive të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të rregulluar për të realizuar garanci publike, për përgjegjësitë që sjellin ushtrimi i profesioneve të rregulluara. Provimi shtetëror është i obligueshëm për bartësit e arsimit të lartë publik dhe privat.

Prandaj, i nderuar ministër, ju bëj këtë pyetje: përse nuk po zbatohet Ligji nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, i cili u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 28 tetor 2013. Kur pritet të organizohen provimet shtetërore për profesionet e rregulluara? Faleminderit!

KRYETARI: Po, zoti ministër, fjala është për ju.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetët,

Të nderuar ministra,

Faleminderit, deputet, për pyetjen tuaj, pra siç e theksuat edhe ju në pyetjen tuaj, ligji është miratuar më 2015 dhe deri më tani nuk ka gjetur një zbatim. Realisht, çështja kryesore e moszbatimit të ligjit nga 2015 ka qenë mungesa e buxhetit për themelimin e Agjencisë për profesionet e rregulluara dhe si pasojë nuk ka mundur të jetësohet kjo agjenci.

Duke parë këtë situatë dhe ne si ministri nga marrja e detyrës nuk kemi siguruar buxhet të mjaftueshëm, atëherë janë bërë disa lëvizje të tjera që ta zbutim situatën në fillimet e funksionimit të këtij ligji. Veprimi i parë, i cili është bërë me rregullimin e ri të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë për rifunksionalizimin, është formuar një divizion i veçantë që

do të merret me profesionet e rregulluara për ta ndihmuar procesin e fillimit të zbatimit të këtij ligji. Kështu, në këtë fazë jemi në bisedime së bashku edhe me Shqipërinë, me Ministrinë e Arsimit, që të bëjmë një komision të përbashkët për përpilimin e këtyre provimeve që do t'i nënshtrohen pastaj profesionistët në këto profesione, të cilat janë caktuar në ligj, në mënyrë që pastaj në të dy vendet, pra të jenë profesionet e pranuar pa pasur nevojë që t'u nënshtrohen procedurave të tjera.

Po ashtu, jemi në fazën kur në pjesën regjionale është duke u biseduar edhe për njohjen e katër profesioneve të rregulluara, ku ne tashmë jemi duke kryesuar si ministri këtë komision që besoj që shumë shpejt do të zgjidhet edhe kjo çështje. Pra, me këto iniciativa unë besoj që ligji do të fillojë të jetësohet, po ashtu është përpiluar tashmë edhe draft udhëzimi i parë administrativ që lidhet me këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Gjithsesi, Bekim Haxhiu ka pyetje shtesë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër!

Faleminderit edhe për sqarimin, shpresoj që vërtet të vazhdoni me punën që të jetësohet miratimi apo zbatimi i këtij ligji, por kam pyetje shtesë, sepse edhe me Ligjin për provimin e maturës shtetërore parashihet digjitalizimi i provimit shtetëror të maturës, edhe kur e kemi miratuar këtë ligj në Komisionin Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është paraparë që edhe ky provim shtetëror të jetë i digjitalizuar.

Pra, pyetje shtesë është: kur pritet që provimi i maturës shtetërore dhe provimi shtetëror për profesionet e rregulluara të jetë provim i digjitalizuar?

KRYETARI: Urdhëro, ministër, fjala për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Për maturën doli pyetje shtesë, por gjithsesi është një projekt për digjitalizimin e maturës, është bërë një punë e madhe, akoma nuk është funksionalizuar, por është në finalizim projekti dhe besoj që nëse gjithçka shkon mirë, vitin e ardhshëm mund të fillojë zbatimi i maturës, ndërsa lidhur me çështjen e digjitalizimit të profesionit të rregulluar, në së pari do të fillojmë ta zbatojmë ligjin, pastaj do të gjejmë mundësinë ndoshta edhe për digjitalizim. Faleminderit!

KRYETARI: A ke më pyetje shtesë, zoti Haxhiu? Jo, e ke edhe një pyetje, e ke për Pal Lekajn menjëherë, vazhdoje!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Këtu jemi për të bartë shqetësimet e qytetarëve, besoj se në funksion të asaj janë edhe ministrat që t'i zgjidhin ato probleme.

I nderuar ministër Pal Lekaj,

Me Ligjin për buxhetin L-020 të vitit 2018 janë ndarë mjetet për ndërtimin e mbikalimit në lagjen Mecina në fshatin Klinë e Epërme. Ndërtimi i mbikalimit në Klinë të Epërme në shumën 50 mijë euro, pas ndërtimit të rrugës me katër korsi Skenderaj - Klinë e Epërme kalimi i rrugës është bërë i pamundshëm dhe shumë i rrezikshëm për banorët e Lagjes Mecinaj dhe të banorëve të tjerë që kanë shtëpitë në anën tjetër të rrugës. Në veçanti kalimi i rrugës është bërë shumë i rrezikshëm për fëmijët që shkojnë në shkollën fillore "Idriz Berani" në Klinë të Epërme dhe si pasojë e mungesës të një mbikalimi, janë shkaktuar disa aksidente edhe me fatalitet në këtë aks rrugor. Prandaj, me Ligjin për buxhetin e vitit 2018 kemi planifikuar dhe ndarë mjetet për ndërtimin e këtij mbikalimi në lagjen Mecinaj në Klinë të Epërme. Pyetja është: kur pritet të përfundojë ndërtimi i mbikalimit në lagjen Mecinaj në Klinë të Epërme, projekt i miratuar me buxhetin e vitit 2018?

KRYETARI: Po, ministër, fjala për ju.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryetar Veseli!

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket pyetjes që e shtrove, me vend, ne do të punojmë në atë drejtim që të përfundojë në këtë vit, kemi pasur probleme sa u përket procedurave, por tani janë zgjidhur dhe mendoj që shumë shpejt do të fillojmë me projektin dhe të përfundojë sipas parashikimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, pyetje shtesë ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër për njoftimin. Gjithashtu, sipas informacionit që kam, edhe problemet, të cilat kanë qenë pronësore në rrugën që ndërtohet me katër korsi Klinë e Epërme - Skenderaj janë zgjidhur nga kryetari i Komunës së Skenderaj, prandaj pyetja ime është që kur pritet të përfundojnë edhe ato pjesë të mbetura në gjysmë në këtë aks rrugor?

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shumë me vend, zoti ministër!

MINISTRI PAL LEKAJ: Sa i përket shpronësimit, është e vërtetë që duke iu falënderuar kryetarit të Komunës, ne kemi bërë zgjidhjen, tani projekti është duke vazhduar dhe mendoj që në afatin çfarë është nënshkruar kontrata do të përfundojë. Ne jemi të vendosur dhe e kemi thënë që do të jemi të saktë me fillimin e punimeve, por edhe me implementimin korrekt të kontratave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit z. ministër për punën dhe kryetarit të Komunës së Skenderajt për angazhimin, sepse ka mbetur i hapur projekti.

Janë edhe dy pyetje të deputetit Naser Rugova. Nuk është këtu. Salih Salihu, por kryeministri vetëm sa lëvizi. Urdhëro, deputet!

SALIH SALIHU: Pyetja është rreth kycjes së Vitisë në autostradën “Arbën Xhaferi” në fshatin Gërllicë, është në interes për qytetarët. Pasi nuk është kryeministri këtu, e kisha përsëritur pyetjen herën tjetër, ose nëse ka disponim ministri Pal Lekaj të përgjigjet? Zoti ministër, a doni të përgjigjeni në vend të Kryeministrit?

KRYETARI: Po, po, mundet, sepse e ka autorizuar kryeministri dhe jep përgjegjësi.

SALIH SALIHU: Atëherë, zoti ministër, qytetarët e Komunës së Vitisë ka tre vjet që kërkojnë që Vitia të ketë qasje në autostradën “Arbën Xhaferi” në pikën më të afërt, në fshatin Gërllicë. Qeveria e kaluar vazhdimisht ka premtuar se do ta bëjë këtë gjë, por nuk e bëri.

Kërkesën për kycje të Vitisë në autostradën Prishtinë - Hani i Elezit e kemi shtruar edhe te ministri Pal Lekaj, i cili na pati premtuar se më 15 shtator do të fillojnë punimet për realizimin e këtij projekti.

Megjithatë, pyetja është për kryeministrin kështu: Zoti kryeministër, a do të fillojnë punimet më 15 shtator? Aty u pa që më 15 shtator punimet nuk filluan, sepse pyetja është bërë pak më herët, më 13 shtator, dhe më 15 shtator dolën në vendin e ngjarjes zëvendësministri, por jo ministri Lekaj, dhe jo kryeministri. Pyetja zoti ministër i Infrastrukturës është: A do të ketë kycje Vitia aty dhe kur do të filloni me projektim dhe kur do të filloni me realizimin e këtij projekti?

Ju e dini shumë mirë se keni qenë në vendin e ngjarjes, na keni premtuar publikisht se punimet do të fillojnë më 15 shtator, punimet po shtyhen për arsye se keni probleme me Bechtel-Enka-n, ndërkaq qytetarët po mbesin pa u kyçur në autostradë.

Kërkojmë kështu konkretisht në afat kohor kur do të filloni me realizimin e këtij projekti se përndryshe ju e dini mirë se qytetarët çfarë kërkesash kanë pasur ndaj juve dhe ata janë në gjendje të dalin edhe në protesta, por për hir të raporteve që janë krijuar ndërmjet jush kur keni komunikuar me ta, d.m.th. e kemi gjetur një komunikim që t’ju japim pak kohë.

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju me informacione, aq sa keni. Faleminderit!

MINSTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet,

Është e vërtetë që ju kam premtuar në takimin që e kemi pasur të përbashkët edhe me shoqërinë civile, edhe me qytetarët, por keni qenë edhe ju i pranishëm.

Ne nuk kemi hequr dorë nga vendimi ynë që është marrë në Komitetin Ndërmintor dhe nuk kemi hequr dorë nga kyçja e Gërlicës në autostradën R-6. Prandaj, është e vërtetë që kërkoj falje që nuk kam mundur të jem i saktë në kohë për shkak të problemeve që i kemi pasur me kompaninë Bechtel-Enka dhe nuk i kemi sqaruar të gjitha gjërat dhe mu për këtë projekti është shtyrë për disa ditë.

Por, unë mendoj se kjo do të fillojë dhe t'ju befasojmë për të mirë.

KRYETARI: A ka pyetje shtesë nga deputeti?

SALIH SALIHU: Zoti ministër, a jeni takuar me zëvendësministrin tuaj pas takimit që ai ka pasur me qytetarë më 15 shtator për t'i koordinuar punët, sepse ai thotë se mbase Bechtel-Enka nuk po e bën këtë punë, duhet të kontraktohet një kompani kosovare që ta kryejë këtë punë.

Por, fillimisht duhet të fillohen procedurat e projektimit dhe këtu duhet të dakordoheni që të ndani buxhet, sepse pastaj duhet ekstra buxhet që duhet planifikuar për vitin 2019. A jeni takuar me zëvendësministrin, a jeni informuar saktë se çka na ka premtuar atë ditë që ka dalë ai më 15 shtator?

KRYETARI: Ministër!

PAL LEKAJ: Është e vërtetë se zëvendësministri ka ardhur atë ditë me autorizimin tim dhe unë konsultohem çdo ditë me të, në mëngjes dhe në fund të orarit dhe bisedojmë për të gjitha ato obligimet ditore që i kemi marrë.

Është e vërtetë se e di edhe çka ju ka thënë sa i përket fillimit të projektimit, por kur ju thashë se kam për t'ju befasuar, unë kam pasur kontakt me drejtorin e Bechtel-Enkës dhe kam biseduar dhe ne pothuajse veç kemi filluar projektimin që do të ndodhë shumë shpejt dhe atëherë bashkërisht do ta fillojmë edhe kyçjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

ka kohë që banorët e fshatit Tërn ballafaqohen me problemet që lidhin rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj. Deri tash janë bërë jashtëzakonisht shumë premtime, por nuk kanë ndodhur asgjë konkrete. Do të doja të di nga ju si qëndron çështja tani dhe kur do të fillojë ndërtimi i kësaj rruge?

KRYETARI: Kërkoj falje i nderuar ministër, por kemi problem me teknikën vërtet dhe nuk mundja të jua jap fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet,

Sa i përket këtij projekti është e vërtetë se ka filluar që dy-tre vjet. Është e vërtetë se kemi pasur shumë probleme, është e vërtetë se para se të procedohet është ndërprerë procesi.

Tani, pas zotimit të dhënë, ne i kemi ndjekur të gjitha procedurat dhe është kryer procedura sa i përket Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Ka pasur ankesa dhe lënda ka shkuar në OSHP apo në 'Gjykatën e Tenderëve' dhe sot kam marrë vendimin nga OSHP-ja që procesi është rikthyer prapë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe është afati 5-ditor që ne duhet t'i përgjigjemi dhe pas përfundimit të këtij procesi ne jemi të gatshëm të fillojmë. Ka pasur protesta edhe në rrugë, ka pasur edhe njerëz që i kanë provokuar qytetarët, por të jeni të bindur se ne jemi të vendosur që të jemi në shërbim të qytetarëve, e jo të politikave ditore sikur disa që po i keqpërdorin qytetarët.

Unë kam thënë se do të jemi këmbëngulës që ai projekt është i domosdoshëm dhe duhet të përfundojë. Ka qenë edhe kryeministri në vend dhe u ka premtuar. Por, nuk guxojmë që ne t'i shkelim procedurat dhe tani t'i japim përparësi si në kohën e atyre kur ka vendosur jo ligji, por individi. Prandaj, në këtë drejtim, unë me përpikëri do t'i zbatoj të gjitha procedurat që janë sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Në atë moment që do të nënshkruhet kontrata, unë jam i vetëdijshëm që puna do të fillojë në bazë të kontratës. Dhe, ju lutem, sado që keni thënë se jemi qeveri e asfaltit, nuk ka ditë që nuk kam kërkesë nga shumë deputetë, nga të gjitha partitë politike, por edhe nga qytetarët, që nuk kërkojnë rrugë për t'u shtruar. Prandaj, ne nuk po shtrojmë asfalt mbi asfalt, por i kemi rrugët që janë të paasfaltuara, që janë të domosdoshme dhe unë mendoj dhe kërkoj përkrahjen tuaj që të më mbështetni prapë me buxhet dhe unë do t'i kryej të gjitha punët dhe kërkesat tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka pyetje shtesë nga deputeti Faton Topalli?

FATON TOPALLI: Po. I nderuar ministër,

Procedurat e tenderimit dhe ankesat mund të vazhdojnë edhe më tutje. Ky është bërë një problem serioz për Qeverinë, por edhe për qytetarët, sepse nuk po arrijnë t'i zgjidhin problemet që ata i kanë.

A ka Qeveria ndonjë projekt apo a ka për projekt ndryshimin e ligjit i cili do të mundësonte që projektet e caktuara të mos shtyhen për shkak të tenderimit?

KRYETARI: Ministër, fjala për ju!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet,

Sa u përket ligjeve, mund të them se asnjë dokument nuk është i vdekur dhe nuk mund të përmirësohet. Ne i dimë dobësitë e prokurimit publik, Ligjit për prokurim publik, dhe është koha e fundit që ne të ndryshojmë diçka. Përndryshe, të gjitha këto stërzgjatje të tenderëve janë bërë për shkak të ligjit dhe për shkak të atyre divergjencave që janë ndërmjet OSHP-së dhe zyrave të prokurimit. Prandaj, sa më shpejt që ju ta ndryshoni ligjin, ta amendamenti ligjin, aq më mirë është dhe unë jam pro kësaj iniciative. Faleminderit!

KRETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetë të nderuar,

Kemi edhe dy pyetje, ministrja dhe kryeministri nuk janë këtu! Zonja Shqipe Pantina dëshironi tani apo, pasi është pyetja e parë. Shqipe Pantina, pyetje për ministren Dhurata Hoxha.

SHQIPE PANTINA: Ministrja nuk është këtu, por unë po e shtroj më shumë edhe si kërkesë, nëse tashmë nuk ka ndodhur. Kosova merr pjesë vetëm në cilësinë e vëzhguesit në OGP-në, ose partneriteti për qeverisje të hapur, dhe Kuvendi, përkatësisht Forumi për Transparencë, i cili e përfaqëson Kuvendin në këtë iniciativë nuk mund të bëhet anëtar i plotë, sepse fillimisht Qeveria duhet të anëtarësohet, dhe në emër të Qeverisë kërkesën për t'u anëtarësuar duhet ta bëjë Ministria e Integriteteve.

Arsyeja pse Kosova nuk është anëtare deri tani është se në bordin e kaluar ka qenë pjesë edhe Serbia. Mirëpo, tani nuk është më dhe është një mundësi e mirë që Qeveria jonë ta përsërisë kërkesën, sepse anëtarët e bordit kanë qasje shumë më miqësore ndaj Kosovës dhe mundësitë për t'u anëtarësuar janë shumë më të mëdha. Kështu që unë tani po e shtroj më shumë si formë kërkesë, nëse Ministria e Integriteteve tashmë nuk ka aplikuar ta bëjë atë në një afat sa më të shpejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin. A dëshironi ta lini kur të vijë kryeministri? Urdhëro!

DRITON ÇAUSHI: Nuk e kam të qartë, kryeministri ishte këtu dhe nuk e di nëse do të kthehet në vazhdim të seancës, apo jo?

KRYETARI: Jo, tash për këtë seancë, ose e bën pyetjen ose lini, e shfrytëzoni në seancën tjetër.

DRITON ÇAUSHI: Nëse më lejohet, vetëm çështjen po e përmendi, për ta bërë pyetjen. Pra, është fjala për një fabrikë të përpunimit të mbetjeve shtazore, e cila do duhej ta kishte filluar punën në vitin 2017, e aktualisht të gjitha mbetjet nga thertoret, restorantet mbeten në deponi të rregullta të zakonshme, duke e rrezikuar seriozisht shëndetin e qytetarëve, pra shëndetin publik, dhe kjo është përgjegjësi e agjencisë. Nuk kemi asnjë përgjigje për këtë. Sidoqoftë, duke e

konsideruar si tepër të rëndësishme, po e bëj këtë pyetje në radhën tjetër kur kryeministri të jetë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Labinot Tahiri, urdhëro!

LABINOT TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ministri sapo shkoi! Edhe unë e kam të njëjtën pyetje lidhur me fshatrat me të cilat kam organizuar protesta. Në mënyrë juridike e sqaroi shumë mirë deputeti Faton Topalli dhe ministri, por një fjali nga ai rrodhi këtu në Kuvend, kur tha: “Ka edhe prej atyre individëve që i provokojnë qytetarët”. Duhet ta kuptojë mirë gjithkush se unë nuk kam ardhur këtu me një votë, por kam ardhur me votat e atyre qytetarëve, të banorëve, dhe derisa të realizohet ajo, unë nuk do të pushoj së organizuari protesta, sigurisht që kërkesa ka qenë e banorëve, e jo e imja për protesta.

Vetëm një pyetje; a kryhet para Vitit të Ri apo jo, që prapë t’i dërgojmë ata buldozerë të gjithë që ta bllokojmë rrugën? Sepse ndryshe nuk po funksion sa i përket anës së Ferizajt, dhe kjo ishte e tëra. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Po e shoh reagimin e zonjës Teuta Haxhiu. Zonja Teuta Haxhiu, artistëve dhe gazetarëve kurrë mos u dil përpara! E bën pyetjen me shkrim, pastaj... Ne sot kemi kaluar një mori projektligjesh, ratifikuam marrëveshje ndërkombëtare, e di se jeni lodhur, faleminderit! Do ta vazhdojmë seancën, ju ftoj pastaj në një moment të caktuar. Javën e ardhshme, po! Jo sot jo, por në javën e ardhshme ju njoftoj. Faleminderit dhe urime të gjithë qytetarëve tanë për disa marrëveshje shumë të rëndësishme, të votuara sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

* * *

E hënë, 15 tetor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 13 shtator 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Janë aktualisht 60 deputetë në sallë. I kisha ftuar grupet parlamentare, do të mbajmë pauzë edhe 10 minuta në sallë këtu.

60 deputetë janë aktualisht në sallë.

Jemi duke i thirrur edhe publikisht, edhe përmes ziles, po i thërras edhe tash nëpërmjet foltores. 61 duhet edhe shkojmë në votim.

(Pauzë)

KRYETARI: Grupet parlamentare i kisha lutur në qoftë se vazhdojmë seancën, le t'i thërrasin deputetët të kthehen në sallë. Aktualisht janë 62 deputetë, por në sallë nuk janë 62.

(Pauzë)

KRYETARI: Para se të shkojmë në një pazë, do të bëj thirrjen e fundit në qoftë se dëshirojnë deputetët të kthehen në sallë. Kjo për ndryshe, në rrethana të cilat jemi, aktualisht janë 60 deputetë në sallë, 2-3 janë jashtë, të cilët janë të vetëdijshëm se kuorumi nuk po arrihet për faktin e tyre, do të thotë shefat e grupeve parlamentare ta kenë parasysh, kjo është situata reale.

Japim 15 minuta pauzë, herën tjetër kur të vijmë, nëse për pesë minuta nuk ka kuorum, ta keni parasysh, nuk do të toleroj që individë të caktuar të përcaktojnë fatin tonë, fatin e Kuvendit, se ka veç individë të caktuar që po tentojnë të demonstrojnë para nesh personalitet.

Zafir, veç katër vota i duhen opozitës, po të them publikisht, ti edhe nja 2-3 i ke atje, të cilët po frikohen, më së shumti ata frikohen të shkojmë në zgjedhje, bashkë me opozitën.

Pesëmbëdhjetë minuta jemi në pauzë, pas 15 minutave, 5 minuta do të rrimë në sallë, në qoftë nuk ka kuorum, e vazhdojmë ditën e enjte seancën e rregullt, pastaj e vazhdojmë këtë seancë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

(Mungon një pjesë e incizimit)

SAFETE HADËRGJONAJ: ...së paku tri herë më të lartë.

Ndërkohë amendamenti 10 ndryshohet si në vijim.

“Neni 15, paragrafi 7, riformulohet si në vijim:

“Autoriteti bazuar në llogaritjet i përcakton ofruesit shërbimit universal postar të drejtën e kompensimit për shërbimet universale postare si dhe përcakton nivelin e kompensimit mbi bazën e kostos neto. Në çdo rast, kompensimi kryhet vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore”.

Ky është raporti, në qoftë se seanca pajtohet që me këto ndryshime që sapo i lexova, të votojmë në pako amendamentet, të cilat janë gjithsej 23 amendamente në Ligjin për shërbimet postare, në fakt në Projektligjin për shërbimet postare që pritet të shndërrohet në ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të konstatoj edhe një herë atë çfarë kryetarja e komisionit e tha.

Ne tani votojmë në fakt 21 amendamente, 2 amendamente largohen.

Nga këto amendamenti 2, 6, 7, 8, 9 dhe 10, në qoftë se pajtoheni, futen në pakon e të gjitha këtyre amendamenteve 21, me ndryshimet dhe rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL, të cilët i ka sjellë.

A ka dikush kundër, që t'i vë të gjitha bashkërisht?

Atëherë po votojmë me dorë 21 amendamente, 2 janë larguar, amendamenti 2 dhe 6 janë larguar, 21 amendamente të gjitha bashkërisht me rekomandimin e Komisionit FunkSIONAL dhe me ndryshimet të cilat janë bërë në raportin plotësues.

A ka dikush kundër, 66 deputetë janë. Abstenim?

66 deputetë për.

E votojmë projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë në mënyrë elektronike, votojmë tash:

A votojmë edhe një herë...

58 deputetë, nuk ka kuorum.

Po votojmë edhe një herë, i kisha lutur kolegët deputetë, janë aq sa e konstatojmë më herët, votojmë edhe një herë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

66 deputetë janë në sallë.

67 deputetë janë në sallë, ky është rezultat i votimit, do ta provojmë edhe një herë në fund të seancës, nuk është kuorumi i mjaftueshëm as për ta konstatuar.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme kanë shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

Ju njoftoj se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se projektligji me amendamentet e propozuara nuk përmban asnjë implikim buxhetor, me përjashtim amendamentet 28 dhe 29, të cilët përmbajnë implikime buxhetore.

Janë gjithsej 45 amendamente të miratuara. Në qoftë se doni, shkojmë drejtpërdrejt, raportin e kemi nga Komisioni FunkSIONAL.

Unë do t'i vë në votim ato të cilat janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, të gjitha përnjëherë, në rend të parë, pastaj pa përkrahjen a në propozim të një grupi parlamentar do të shkoj një për një. A të shkojmë kështu?

Do t'i vë në rend të parë vetëm ato të cilat janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL të gjitha bashkërisht.

Amendamenti 3, votohet,

Amendamenti 4, votohet,

Amendamenti 6, votohet,

Amendamenti 8,

Amendamenti9,

Amendamenti 10,

Amendamenti 11,

Amendamenti 12,

Amendamenti 13

Amendamenti 14,

Amendamenti 15,

Amendamenti 16,

Amendamenti 17,

Amendamenti 18,

Amendamenti 22,

Amendamenti 23,

Amendamenti 30,
Amendamenti 34
Amendamenti 35,
Amendamenti 36,
Amendamenti 37,

Amendamenti 39, është propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 42, 41 po ashtu propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 45.

Do të thotë këto amendamente, të cilat janë të evidentuara në protokoll nga përmendja ime votohen të gjitha bashkërisht, janë në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është kundër? Nuk ka kundër. Abstenim, nuk ka.

67 deputetë janë në sallë, të gjitha miratohen.

Lista serbe, unë do t'i marr të gjitha amendamentet të cilat janë propozuar nga Lista serbe, në qoftë se pajtohet Lista serbe, të gjitha bashkërisht t'i vë në pako në votim, në qoftë se s'kam reagim nga Lista serbe, unë filloj t'i përmend një për një.

Amendamenti 1, propozimi i Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Jo, duhet shkuar një nga një, se qenkan të komplikuar, janë 2-3 propozime, ju e dini e kem në bazë të procedurave, shkojmë e votojmë secilin propozim në bazë të saj edhe pastaj kalon amendamenti.

Amendamenti 1.

Propozimi i Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Vëmendje, ju lutem.

67 deputetë janë në sallë, administrata të mbani vëmendje.

A ka abstenim? Dukagjin, a është abstenim, se dora ishte ngritur. Jo.

Një është abstenim, të gjithë janë kundër, nuk aprovohet.

Nga 67 deputetë, 9 janë për, një abstenim, të tjerët janë kundër.

Amendamenti 2.

Janë dy propozime,

E votojmë në rend të parë propozimin e Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? Propozim i Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër, vëmendje?

A ka abstenim? Një abstenim.

Sa deputetë janë në sallë, 67. Kisha pasur dëshirë të mbahet shënim nga administrata.
66 deputetë e përkrahin propozimin e Komisionit FunkSIONAL.

Tani shkojmë te propozimi i dytë, është propozim i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Abstenim, propozimi i dytë.

67 deputetë, 9 janë për, pjesa tjetër është kundër, do të thotë kalon amendamenti i propozuar varianti a, propozimi i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 5.

Me pesë propozime.

Nën një, e votojmë vetëm propozimin e Komisionit FunkSIONAL.

Kush është kundër propozimit të Komisionit FunkSIONAL? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Votohet me 67 deputetë për amendamentin 5, varianti A.

Tash janë katër amendamente, propozimi b, c, d, e, propozimet e Listës serbe, të gjitha i vëmë bashkërisht.

Lista serbe, a pajtoheni t'i vë katër variacionet bashkërisht. Pajtohen.

Kush është për, ju lutem për vëmendje. Abstenim? Nuk ka abstenim.

Kundër janë shumica e deputetëve.

Për ishin 9 deputetë.

Sa deputetë i kemi në sallë, ta kemi vëmendjen.

58 deputetë kundër,

68 deputetë janë në sallë.

Kalon amendamenti 5, propozimi i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 7.

Tri propozime.

Njëjtë është situata, shkojmë me propozimin e Komisionit FunkSIONAL, varianti A.

Kush është kundër? Nuk ka kundër.

Abstenim, nuk ka.

Shumica janë për.

Propozimi i Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, po ashtu e pyes Listën serbe për dy amendamente, a i vendosim prapë bashkërisht b dhe c në votim. Kryetari po thotë po.

Kush është për, amendamentin 7, pika b dhe c, ju lutem.

Abstenim?

68 janë për, nga 68, pjesa tjetër është kundër, do të thotë kalon amendamenti 7, propozimi i Komisionit Funksional.

Amendamentet 19, 20, 21, 24, 25, 26, 27, Lista serbe, janë propozime tuaja. A mund të shkojmë në pako?

Shkojmë në pako deri te amendamenti 27, këto të cilat i përmenda.

Kush është për këto amendamente të cilat i përmenda, ju lutem vëmendje?

Abstenim?

Atëherë, 8 deputetë janë për, nga 67 deputetë prezentë në sallë. Nuk kalojnë këto amendamente.

Amendamenti 28.

Janë dy propozime, të dy propozimet janë pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Nën një, është propozimi i Komisionit Funksional.

Kush është kundër? A ka abstenim?

67 deputetë votojnë për.

Propozimi i Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit Funksional, varianti B.

Kush është për, Lista serbe vëmendje?

A ka abstenim?

67 deputetë, pjesa tjetër është kundër, ishin vetëm 8, atëherë kalon variacioni A, amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Propozimi i Listës serbe pa përkrahje të Komisionit Funksional dhe pa përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kush është për amendamentin 29?

Urdhëro, zonja kryetare!

Më falni, kolegë, zonja kryetare, urdhëro!

SALA BERISHA-SHALA: Te amendamenti 28 i kemi dy propozime pa përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Zonja Berisha-Shala, vëmendje, e kemi përfunduar, tani jemi te amendamenti 29.

SALA BERISHA-SHALA: Të lutem kryetar, se është mirë, këtu janë dy propozime, është propozimi i Komisionit Funksional dhe propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, te amendamenti 28, që ka të bëjë me 20% e tantumës.

KRYETARI: Zonja Berisha-Shala, edhe një herë, ne i votuam dy variacionet, kaloi variacioni A.

SALA BERISHA-SHALA: Më fal, pra!

KRYETARI: Ta keni parasysh, nuk është me rëndësi, po për atë e pashë të arsyeshme ta konstatoj.

Amendamenti 29.

65 deputetë në sallë janë.

Kush është për amendamentin 29, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, pa përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozim i Listës serbe, urdhëroni kush është për? Lista serbe vëmendje, se përkthimin nuk di a po e marrin mirë, të jemi korrektë.

A ka abstenim? Pjesa tjetër është kundër. Nuk kalon amendamenti 29.

Amendamentet 31, 32, 33, 38, 40, 43, 44 janë të gjitha propozime të Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Lista serbe, kam nevojë verifikimin, kryetar, nga ju, a pranoni t'i vë në pako, të gjitha bashkë, pasi janë të gjitha propozime tuaja. Po e shoh reagimin pozitiv.

Atëherë votohen të gjitha këto amendamente në pako, janë të Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Vëmendje!

66 deputetë janë në sallë.

Abstenim?

Pjesa tjetër, 8 deputetë janë për, pjesa tjetër është kundër.

Kemi kaluar amendamentet apo nuk kemi kaluar të gjitha amendamentet, 45.

I ftoj deputetët të votojnë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash!

Nuk ka kuorum të mjaftueshëm për votim. Do ta provojmë edhe një herë në fund.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Këtë projektligj Kuvendi e ka tërhequr nga rendi i ditës në seancën plenare të mbajtur më 5 qershor, gjithashtu ju njoftoj se Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar që amendamenti numër 6 në këtë projektligj, i propozuar nga deputeti Nait Hasani, të riformulohet.

Zonja Duda Balje, në emër të komisionit, ju lutem, fjala për ju.

DUDA BALJE: Faleminderit, kryetar!

Votimi në këtë ligj duhet 2/3 e deputetëve, ne sot nuk kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve.

Në emër të komisionit lus ta shtyjme edhe një herë për një seancë tjetër, nëse ka mundësi.

KRYETARI: Propozimi është nga zonja deputete, në emër të komisionit, shumë i qartë. A e shtyjme edhe për një seancë.

A jeni për ta shtyrë, a ka dikush kundër. Nuk ka kundër, do ta shtyjme për seancën e radhës.

12. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e tij, votojmë raportin vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujërat për vitin 2017.

Votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar, 55 për, 8 kundër dhe një abstenim.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullator për Ujërat për vitin 2017.

13. Votimi i raportit vjetor të performansës të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017

Edhe këtë raport Komisioni FunkSIONAL i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Votojmë raportin vjetor të performansës të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017 me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

64 deputetë kanë votuar,
56 për, 8 kundër dhe asnjë abstenim.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të performansës të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017 me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

14. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017

Po ashtu Komisioni FunkSIONAL i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij.

Votojmë raportin vjetor, votojmë tash:

66 deputetë kanë votuar.
57 për, 7 kundër dhe 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017.

15. Votimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017

Po ashtu Komisioni FunkSIONAL i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij.

Votojmë raportin vjetor për vitin 2017, votojmë tash:

Faleminderit!

64 deputetë kanë votuar. 53 për, një kundër dhe 10 abstenime.

Kuvendi miratoi raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2017.

16. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e tij. E votojmë raportin vjetor të RTK-së për vitin 2017, tash.

66 deputetë kanë votuar. 33 për, 26 kundër. 7 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2017.

17. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017

Po ashtu, Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e tij. E votojmë këtë raport për vitin 2017, tash.

64 deputetë kanë votuar. 53 për, 8 kundër, 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2017.

18. Votimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e tij. E votojmë këtë raport vjetor tash.

63 deputetë kanë votuar. 53 për, 1 kundër, 9 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2017.

19. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij, votojmë tash.

61 deputetë kanë votuar. 51 për, 2 kundër, 8 abstenime.

Miratohet raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017.

20. Votimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore

Votojmë Propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, kështu na ka ardhur, votojmë tash.

63 deputetë kanë votuar. 59 për. 4 abstenime.

Më lejoni të bëj një konstatim, i cili ka ndodhur gabim, për hir të protokollit, por edhe për hir tuajin. Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2017, nuk ka kaluar, për arsye se edhe pse kanë votuar 33 deputetë për, nuk janë 34 ta kalojnë. Ka qenë mesi, ky është konstatimi. 66 deputetë ishin prezentë, është votim i rregullt, s'ka nevojë edhe një herë, për arsye se 66 deputetë kanë votuar. Vetëm konstatimi ka qenë gabim, është 33, është dashur të jenë 34.

Kuvendi e miratoi vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, ashtu siç e konstatuam mënyrën e votimit.

21. Votimi i propozimit të grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Të nderuar deputetë, seancën e kaluar ju kemi njoftuar me propozimet e këtyre dy grupeve parlamentare për zëvendësimin e deputetëve nëpër komisionet parlamentare, andaj sot vazhdojmë me votimin e propozimeve. Kërkoj nga ju që vetëm me ngritje dore të deklaroheni për propozimet e grupeve parlamentare, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe PSD-së.

A jeni për? A ka kundër? S'ka kundër. Abstenim s'ka.

Kuvendi i miratoi propozimet e grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

56 deputetë janë në sallë.

Para se të futem, të përgatitet administrata për votimin, kemi votim të fshehtë. Përgatitni kushtet teknike, unë do t'i kthehem edhe një herë votimit të atyre, të cilat s'kanë kaluar edhe një herë.

S'ka më votime, jemi në votim të zgjedhjes së tre anëtarëve të Bordit. Unë vetëm po futem edhe një herë për arsye se në momentin që i votojnë këto, deputetëve do t'u japim pauzë pas rezultatit.

Votimi i anëtarëve të Bordit, në qoftë se dëshironi, ose mund të vazhdojë edhe në rundin e dytë. A ka mundësi vëmendje vetëm t'i bëj dy votimet, të cilat janë formale? Pikën 23 dhe 24.

23. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar

Grupet parlamentare i kanë propozuar deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar, si në vijim: Grupi Parlamentar i LDK-së: Arban Abrashi, Imet Rrahmani. PDK: Evgjëni Thaçi Dragusha, Andin Hoti, Vetëvendosje: Valon Ramadani, Adem Mikullovc. Valon Ramadani është kryetar i komisionit. Grupi Parlamentar i PSD-së ka propozuar për anëtar të komisionit Shqipe Pantina, Grupi Parlamentar i AAK-së zëvendëskryetarin e parë Rasim Selmanaj. Grupi Parlamentar i Listës serbe Jasmina Zhivković, anëtare. Grupi Parlamentar Nisma, Enver Hoti, Grupi Parlamentar 6+ e ka propozuar për zëvendëskryetar të dytë të komisionit Albert Kinollin.

A ka dikush kundër? Abstenim? Sa deputetë janë në sallë? 67 deputetë.

Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar. Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të RTK-së nga komuniteti shqiptar që të veprojë në përputhje me nenin 26 të Ligjit mbi RTK-në dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

24. Votimi i propozimit për zëvendësimin e dy anëtarëve të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar deputeten zonjën Donika Kadaj Bujupi, në vend të deputetit Blerim Kuçi për anëtar të komisionit.

Grupi Parlamentar Lista serbe, nëse dëshirojnë ta plotësojnë komisionin me një deputet nga Grupi Parlamentar, urdhëroni, propozojeni. Zoti Sasha Milosavljeviq, a keni propozim?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička Grupa Srpska lista će svog kandidata poslati u pismenoj formu u toku dana.

KRYETARI: Vetëm se sot nuk mund ta aprovojmë në qoftë se s'kemi emër. A ka mundësi sot, se s'mund ta aprovojmë, duhet edhe një herë në seancë. Ok!

Atëherë, a ka dikush kundër këtij propozimi të AAK-së? Abstenim?

Aprovohet me 67 deputetë. Lista serbe pritët ta plotësojë.

22. Zgjedhja e tre anëtarëve të Bordit të RTK-së

Unë do të procedoj, Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar biografisë, si dhe ka zhvilluar intervistimin e kandidatëve dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit të RTK-së, nga gjashtë kandidatët e propozuar.

Zonja Xhevahire Izmaçu, në emër të Komisionit ad hoc, të lutem fjalën e keni të paraqisni rekomandimin e komisionit.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së në bazë të nenit 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25.07. dhe 31.07.2018, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e tre anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehur. Për tri pozita për anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar propozohen për votim gjashtë kandidatët si në vijim: Emira Bajçinca, Agron Gashi, Vilma Biba, Sali Bashota, Lirim Geci dhe Arlinda Demiri. Kuvendi bën përzgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit nga gjashtë të propozuarit. Anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës emërohen me mandat trevjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ju njoftoj se në pajtim me nenin 26, zgjedhjen e dimë të gjithë, është shumica e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, me votim të fshehtë nga kandidatët e propozuar zgjidhet anëtar i Bordit. Për tri pozita për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptare janë propozuar: Emira Bajçinca, Agron Gashi, Vilma Biba, Sali Bashota, Lirim Geci dhe Arlinda Demiri.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar.

Elmi Reçica nga Partia Demokratike e Kosovës, kush është në komision?

ELMI REÇICA: Ne propozojmë deputetin Hajdar Beqa.

KRYETARI: Partia Socialdemokrate, kush është në komision?

DARDAN SEJDIU: Deputeti Frashër Krasniqi.

KRYETARI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, kush është në komision? Blerim Kuçi, të lutem, Donika Kadaj-Bujupi, a po? Po, Donika Kadaj Bujupi, ky është propozimi. Ju kisha lutur, të mos bëj unë konstatim, grupi parlamentar. Urdhëroni, zonja Donika!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Deputeti Rasim Selmanaj është prej Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, zonja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala, predsedniče! Lista srpska predlaže za člana komisije Adem Hodža.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi nga Nisma Socialdemokrate.

BILALL SHERIFI: Deputetin Veton Berisha.

KRYETARI: Faleminderit! Albert Kinolli nga 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar 6+ e propozon deputetin Bahrim Shabani.

KRYETARI: Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë për formimin e Komisionit votues. Duhet 61 deputetë, nuk janë. Sa deputetë janë në sallë, ju lutem? Pa 61 deputetë Gjykata Kushtetuese çdo vendim e vë në pikën zero, s'kemi nevojë ta maltretojmë veten. Deputetët le të kthehen vetëm në votim, prezencë formale, fizike.

(Ndërhyrje)

S'ka lidhje, më mirë është të mos bëjmë asnjë lëshim dhe nuk do ta bëj asnjëherë. Ju lutem, deputetët të kthehen në sallë vetëm edhe një votim formal, më vjen keq. Ka të bëjë me vendimmarrjen, e cila është për anëtarët e Bordit që zgjidhën për tre vjet, nuk ka nevojë ta kontestojë askush. Po të ishte vetëm formale për ndonjë procesverbal apo diçka, mund ta bëjmë edhe pa 61. Lutem deputetët vetëm të bëhen 61, se shumica janë në bufe, thërras publikisht që të kthehen në sallë edhe procedojmë pastaj vetëm në votim. Në momentin që administrata më bën me shenjë se janë bërë 61, unë vetëm formalisht e vë konstatimin.

Sa deputetë janë në sallë, Administrata?

Ju kisha lutur, vetëm një moment, zonja deputete. Deputetë, ju lutem, nga bufeja na duhen në sallë. Sa deputetë janë, të lutem? Po, qëndroni vetëm, sa deputetë janë aktualisht?

Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, për çështje që janë vendimmarrje nuk lejoj të ketë shkelje. Sa deputetë janë në sallë? Janë mbi 61 deputetë në sallë. A janë 61 apo 62? 61 deputetë janë në sallë.

Me ngritje dore, kush është kundër? Abstenim? A janë të gjithë për?

Shkojmë në votim, komisioni të zërë vend e të fillojmë menjëherë me listën për votim.

Hajdar zë vend, së bashku me komisionin. Ju lutem komisioni zini vend, fillojmë menjëherë me votimin:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albert Kinolli, Albin Kurti, Albulena Balaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Dukagjin Gorani, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliçaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Famire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Kadri Veseli...

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

...Memli Krasniqi, Fisnik Ismajli, Fitore Pacolli, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqaj, Haxhi Avdyli, Haxhi Shala, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku-mungon, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila...

Mund të votoni edhe te kjo kutia këndeje.

...Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Salihu, Sali Zyba, Sami Kurtesi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Syla, Shkumbin Demalijaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Srgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani,

Verica Çeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Moisiçloviq.

Sa për njoftim për deputetët që nuk janë në sallë dhe ata që janë në sallë, ne menjëherë pas kësaj vazhdojmë me rendin e ditës, që është debati. Kështu që nuk është mirë të mos jeni në sallë. Debatin e vazhdojmë me aq deputetë sa janë, në qoftë se nuk vijnë ne e përfundojmë debatin dhe pastaj të mos ankohet dikush që debati nuk është mbajtur. Në qoftë se dikush nuk ka votuar, votimi është akoma i hapur, mund të vijë.

VETON BERISHA: Të nderuar deputetë,
Në emër të Komisionit votues për emërimin e 3 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, para juve paraqesim votat nga ju.

Nga deputetët, kanë votuar gjithsej 65 deputetë dhe votat janë për kandidatët:

Vilma Biba, Lirim Geci, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Vilma Biba, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Vilma Biba, Lirim Geci,
Sali Bashota,
Vilma Biba,
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Lirim Geci, Arlinda Demiri,
Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Vilma Biba, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Arlinda Demiri,
Emira Bajçinca, Agron Gashi, Lirim Geci,
Vilma Biba, Arlinda Demiri,
Sali Bashota, Lirim Geci, Agron Gashi,
Agron Gashi, Lirim Geci, Arlinda Demiri,
Vilma Biba, Sali Bashota, Lirim Geci,

Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Lirim Geci, Arlinda Demiri,
Lirim Geci, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
E pavlefshme,
Vilma Biba, Sali Bashota, Lirim Geci,
Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Vilma Biba, Sali Bashota,
Agron Gashi, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Vilma Biba, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Vilma Biba, Arlinda Demiri, edhe në herë, kërkohet falje!
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota dhe Arlinda Demiri,
E pavlefshme,
Agron Gashi, Lirim Geci, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Sali Bashota, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Vilma Biba, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Arlinda Demiri,
Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Agron Gashi,
Lirim Geci,
Agron Gashi, Vilma Biba, Sali Bashota,
Katër janë votuar, e pavlefshme,
Ermira Bajçinca, Agron Gashi,
Agron Gashi, Vilma Biba, Arlinda Demiri,
Agron Gashi, Sali Bashota, Lirim Geci,
Ermira Bajçinca, Sali Bashota, Lirim Geci,
Sali Bashota, Lirim Geci.

Dhe, e fundit: Agron Gashi, Vilma Biba, Lirim Geci.

KRYESUESI: Hajde z.Beqa, e keni fjalën t'i shpallni rezultatet.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit.

Të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë!

Raportojmë se Komisioni votues për emërimin e tre anëtarëve të Bordit të RTK-së paraqet këtë raport për rezultatet e votimit të tre anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Në mbështetje të nenit 65 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 26 të Ligjit nr. 04-L/46 për Radiotelevizionin e Kosovës, si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit më 18 tetor 2018, në përbërje nga një përfaqësues të secilës parti, nuk po i përmend emrat se janë aty, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve dhe Kuvendit për emërimin e tre anëtarëve të Bordit të RTK-së, në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018, konstaton se në votim për tre anëtarë të Bordit të RTK-së kanë marrë pjesë 65 deputetë. Të pavlefshme kanë qenë tri fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e tre anëtarëve të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar janë:

Ermira Bajçinca i ka fituar gjithsej 3 vota,

Agron Gashi i ka fituar 43 vota,

Vilma Biba i ka fituar 14 vota,

Sali Bashota i ka fituar 39 vota,

Lirim Geci i ka fituar 39 vota dhe

Arlinda Demiri i ka fituar 22 vota.

Në bazë të rezultatit të votimeve dhe numërimit që kanë marrë pjesë gjithsej 65 deputetë, janë zgjedhur tre anëtarë të Bordit ashtu siç është paraparë.

Janë zgjedhur Agron Gashi me 43 vota, Sali Bashota me 39 vota dhe Lirim Geci me 39 vota.

Urime për kandidatët!

KRYESUESI: Faleminderit. Të zgjedhurve u uroj sukses!

Jemi në pikën e radhës:

40. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetët nënshkrues nga GP i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve

Të nderuar deputetë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi mbështetur nga shtatë deputetë nënshkrues të Grupit Parlamentar të AAK-së ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar për shtesat e fëmijëve.

E ftoj zonjën Bujupi që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Urdhëroni, z. Nitaj!

MUHARREM MITAJ: I nderuar kryesues i seancës, Shumica e deputetëve e kanë kuptuar që menjëherë pas votimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së do të shkohet për drekë dhe nuk janë këtu. Unë sugjeroj, propozoj që të shkojmë në pauzë për drekë dhe më pastaj të kthehemi për debatin parlamentar.

KRYETARI: Unë i kam thënë, i kam treguar zonjës Bujupi, që do të vazhdojmë menjëherë me debatin, ajo nuk është këtu. Prandaj, nëse ajo nuk është këtu, unë jam i detyruar ta konsideroj të përfunduar debatin dhe ajo mund të bëjë një kërkesë të re për debat tjetër sa i përket kësaj çështjeje.

Ajo këtu ishte te unë, i thashë që vendimi është që të vazhdojmë me seancën, ta mbyllim edhe debatin. Unë mund të pres, mund të them “ok”, në orën 15:00, por besoj që atëherë do të jetë gjendja e njëjtë. Faleminderit!

Urdhëroni, z. Nitaj!

MUHARREM NITAJ: Zoti kryesues!

Meqenëse situata qenka kështu, zonja Bujupi për një minutë do të jetë në sallë dhe do ta paraqesë arsyetimin e debatit.

KRYESUESI: Ok! Po presim. Besoj që edhe deputetët tjerë do të vijnë.

(Ndërprerje diskutimi)

KRYESUESI: Zonja Bujupi, e keni fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ashtu siç e tha kolegu Nitaj, meqë shumica e kolegëve nuk janë këtu dhe ne do të kërkojmë votim nga të gjithë të rezolutës, e cila do të dalë nga ky debat, pa dallim subjektet politike, unë do të kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj që të shtyhet pas drekës, që i bie të fillojë në orën 15:00. Nëse jo, atëherë po filloj tani, mirëpo për shkak të pjesëmarrjes së të gjithë deputetëve dhe përpjekjes për unifikim pozitivë e opozitivë në këtë temë, ju kisha ftuar për mirëkuptim dhe ta nisim në orën 15:00.

KRYESUESI: Në rregull! Unë nuk kam asgjë kundër, por problemi ishte se kur nuk je këtu, kur nuk e ke propozimin konkret.

Atëherë, po e lëmë në orën 15:00 dhe e shohim nëse do të vijnë apo jo deputetët.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,
Po fillojmë pikën e njëzet e pesë të rendit të ditës:

25. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga shtatë deputetët nënshkrues nga Grupi Parlamentar i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur nga shtatë deputetë nënshkrues të Grupit Parlamentar ka parashtruar kërkesën për debat parlamentar në lidhje me shtesat e fëmijëve.

E ftoj deputeten zonja Donika Kadaj-Bujupi që në emër të propozuesit të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Zonja Bujupi, e keni fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shtesat për fëmijë janë një përpjekje e kamotshme, e kemi folur në fushata zgjedhore, disa nga ne edhe kemi premtuar, kemi marrë zotime që do ta realizojmë dhe jemi para një momenti kur si Kuvend mund të angazhohemi të gjithë bashkë, pa dallime partiake, sepse është çështje

strategjike e interesit kombëtar, në rend të parë, në mënyrë që shtesat e fëmijëve të përfulura aq shumë të bëhen realitet dhe jo më larg se vitin tjetër.

Janë dy arsyeje kryesore pse kjo konsideroj që duhet të ndodhë.

E para, barazia ndërmjet fëmijëve është parakusht për zhvillimin e tyre, pra përfshirja e tyre në arsim, luftimi i varfërisë, i kequshqyerjes, angazhimi për barazi dhe për solidaritet ndërmjet fëmijëve, është punë në të cilën duhet të investojmë të gjithë ne si të zgjedhur të popullit.

E dyta, Kosova është me popullatën nga më të rejat në Evropë, mirëpo ka një rënie të natalitetit, e cila prej vitit 2011 deri në vitin 2017 është e tillë, janë 70 mijë lindje më pak, të nderuar kolegë deputetë, në një periudhë kohore më pak se gjashtë vjet kemi 70 mijë lindje më pak.

Numri në rënie i lindjeve vjen si rezultat i disa faktorëve, siç është migrimi i popullsisë në drejtim të vendeve të Bashkimi Evropian, shtyrjes së martesave, rritjes së numrit të divorceve dhe, po e theksoj, mungesës së benefiteve apo shtesave të fëmijëve, të cilat ekzistojnë në çdo vend të Bashkimit Evropian, ndërsa institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë arritur ende të dizajnojnë politika, të cilat do të parandalojnë rënien e natalitetit, rrjedhimisht do të përkrahin rritjen e natalitetit në vend.

Pra janë dy çështje, e para, barazia dhe përkrahja ndaj fëmijëve, janë 500 mijë fëmijë të Republikës së Kosovës dhe propozimi është që shtesat për fëmijë t'i gëzojnë të gjithë pa dallim, prej moshës 0 deri në moshën 16 vjet.

Dhe, e dyta, që është po ashtu shumë e rëndësishme është që të kemi dhe të dizajnojmë politika për rritjen e natalitetit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi të informuar se Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar koncept-dokumentin për fushën e punës për ndryshimin e politikave të pushimit të lehonisë dhe hartimin e legjislacionit që do të ofrojë mbështetje për lehonat, me qëllim të rritjes së natalitetit dhe mbështetjes së lehonave të papuna përmes pagesës së kompensimit për gjashtë muaj mbi bazën 70% të pagës minimale. Sigurisht që kjo është për t'u përshëndetur, është një nismë fillestare, një angazhim i cili nuk ka ndodhur më herët, mirëpo nuk është i mjaftueshëm. Krahas kësaj, ne si deputetë kërkojmë që kësaj nisme, të cilën e përshëndesim, t'ia shtojmë edhe çështjen e shtesave të fëmijëve.

Për këto arsye dhe arsye të tjera, të cilat unë sot nuk do t'i përmend, besoj që edhe deputetët e tjerë do të më plotësojnë kolegët nga të gjitha subjektet politike.

Ne në emër të nënshkruesve, pra deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kemi propozuar këtë projektrezolutë, e cila besojmë që do të plotësohet edhe nga deputetë të tjerë, e që në vete parasheh dy rekomandime kyçe.

Rekomandimi i parë: çdo fëmijë në Republikën e Kosovës prej moshës 0 deri në 16 vjeç të gëzojë shtesa, çdo muaj, duke filluar nga 10 euro, pra duke filluar nga 10 euro, pastaj sipas buxhetit dhe mundësive buxhetore dhe numrit të fëmijëve për familje, kjo shumë të rritet dhe të shtohet.

Dhe, e dyta, rekomandimet nga rezolutat të zbatohen përmes buxhetit të vitit të ardhshëm, duke u shndërruar në kod, vijë buxhetore në kuadër të ministrisë përkatëse. Aktualisht nga kjo kategori e shpenzime mund të shfrytëzohen rreth 3% të buxhetit aktual.

Pra, janë rreth 500 mijë fëmijë në Republikën e Kosovës, nëse të gjithë pa dallim gëzojnë shtesa dhe ne do të angazhohemi që të jetë kështu, shuma e përgjithshme do të jetë rreth 3% e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë ju ftoj që pas debatit të votojmë së bashku këtë rezolutë. Më vjen shumë keq dhe është për keqardhje që as Vetëvendosja, as LDK-ja nuk janë këtu, sepse shtesat e fëmijëve janë për të gjithë, edhe për fëmijët e tyre dhe bojkotin ndaj këtij debati dhe kësaj seance flet që dikush është më i interesuar të promovojë interesa të ngushta partiake se që në fakt të jetë në interes të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së nuk është askush këtu, në emër të PDK-së, zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër i Çështjeve Sociale,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i bashkëngjitet në përkrahje të mocionit deputetes Donika Kadaj Bujupi dhe Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në këtë mocion për shtesat e fëmijëve.

Është diskutuar, siç u tha edhe nga kolegja, shpeshherë në Kuvend në kuadër të grupeve parlamentare, të komisioneve, në veçanti komisioneve parlamentare, sidomos në Komisionin për Punën dhe Mirëqenie Sociale, por edhe në grupin e Grave Deputete janë mbajtur tryeza të rrumbullakëta dhe janë zhvilluar debate në lidhje me përkrahjen institucionale të fëmijëve të Kosovës dhe për përkrahjen materiale të tyre, pra për shtesat e fëmijëve.

Mirëpo, nga këto konstatime prej diskutimit në diskutim nuk është gjetur një mundësi institucionale për t'i mbrojtur ata në këtë pikëpamje, pra si shtesë e fëmijëve dhe propozimet dhe konkludimet nga këto debate, propozimet nga këto tryeza të rumbullakëta gjithnjë janë arsyetuar në mungesë të buxhetit. Duke u nisur se tani propozimi vjen nga AAK-ja, pra partia e cila nxjerr kryeministrin zotin Ramush Haradinaj, unë besoj se janë zhvilluar diskutime edhe në lidhje me buxhetin dhe përkrahjen e buxhetit që të mund të realizojmë këtë qëllim sa human, ashtu edhe të domosdoshëm dhe të mund të sigurojmë shtesat e fëmijëve minimale siç i parasheh propozuesja prej 10 eurosh në muaj.

Është brengë rënia e popullatës në Kosovë, është brengë nëse si parametër quhet mortaliteti që ka qenë shumë i lartë, ai tani më fillon të zvogëlohet dukshëm, por megjithatë Kosova mbetet një ndër vendet me mortalitet të foshnjave më të larta në Evropë. Kjo me një rënie të vazhdueshme të mortalitetit, por nataliteti gjithashtu po bie.

Kosova mund të lavdërohet me ligje të avancuara që mbrojnë të drejtat e njeriut, pra në këtë pikëpamje dhe të drejtat e fëmijëve.

Ne kemi ligje për mbrojtjen e nënës dhe fëmijës si në pikëpamje sociale, por edhe shëndetësore, Ligjin për familjen, Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, të cilin e votuam sot paradite dhe shumë ligje të tjera, siç janë edhe ligjet në fushën e arsimit dhe të kujdesit që ata të kenë libra falas dhe të tjera.

Por rënie drastike prej vitit në vit kemi te foshnjat e porsalindura. Cilat janë shkaqet, a thua është vetëm shkak mungesa e shtesave të fëmijëve. Jo, natyrisht, faktorët janë shumë të llojllojshëm dhe secili në vete më i rëndësishëm se tjetri.

Unë do t'i përmend vetëm disa nga këta faktorë. Për shembull, shpërngulja e madhe e rinisë të moshës fertile, moshë fertile është moshë kur janë të aftë për lindje, kur kjo moshë shpërngulet nga Kosova, natyrisht që Kosova, me gjithë natalitetin, ajo mbetet duke u vjetruar.

Pastaj, lëkundja e institucionit shumë të rëndësishëm për një shoqëri, siç është jona sidomos, e martesës ose e familjes, për shkak të divorceve gjithnjë më të shpeshta.

Pastaj, hyrja në martesë në një moshë më të shtyrë se përpara dhe jetëzgjatja e martesës më e shkurtër, në këtë pikëpamje edhe lindshmëria më e vogël.

Edhe të gjitha këto vlera, po t'i studiojmë, ndryshojnë vitalitetin e popullatës, ndryshojnë strukturën e shoqërisë, pra si rrjedhim edhe paraqesin një pikëpyetje për zhvillimin ekonomik në të ardhmen.

Do t'i përmend edhe disa shkaqe të tjera që janë gjithashtu indikatorë të kësaj çështjeje, për të cilën po e diskutojmë, pra ndikimit në lindshmëri.

Papunësia e lartë e grave, por edhe shkelja e ligjeve të caktuara, të cilat Kosova i ka nxjerrë me kohë, e që është Ligji i punës, Ligji për pushimin e lindjes, Ligji kundër diskriminimit, i cili nuk po zbatohet si duhet gjatë punësimit të grave, pastaj fenomeni, të cilin nuk e kemi studiuar si shoqëri: shpërngulja e madhe e familjeve nga fshati në qytet, e që ndikon gjithashtu në numrin e anëtarëve të familjes, sidomos familjeve celula, që janë familje të vogla, me dy gjenerata, e jo me tri, ku gjenerata e tretë e merr përsipër shpeshherë kujdesin ndaj fëmijëve, e në anën tjetër nuk kemi institucione shtetërore të përkujdesjes së fëmijëve në këtë moshë.

Të gjitha këto, sigurisht ka edhe të tjera, janë çështje që duhet diskutuar.

Është edhe fenomeni që rënia drastike e natalitetit ndodh vetëm në shtetet e zhvilluara, ndërkaq që Kosova nuk hyn në këtë kuadër, por është një shoqëri tjetër dhe e dimë standardin tonë karshi këtyre vendeve që kanë një natalitet të ulët.

Kjo është shqetësuese sidomos për ne, sepse për këtë gjeneratë të re pos që dhamë çdo gjë nga vetja, u bë një sakrificë e madhe që ata të jetojnë në kushte dhe rrethana më të mira, besoj që e drejta e tyre dhe shtimi i natalitetit ose përmirësimi i kushteve të jetës të këtyre fëmijëve nuk besoj se rregullohet me një rezolutë, përkundrazi kujtoj që duhet të bëhet më shumë.

Duhet bërë më shumë, sepse shtetet e zhvilluara bëjnë shumë më shumë dhe duke stimuluar jo vetëm rritjen e natalitetit, po edhe duke krijuar kushte më të favorshme për rritjen e fëmijëve, duke pasur shtesa të denja për fëmijët dhe dalin në mbrojtje të përmirësimit të trungut të jetës.

Trungu i jetës në profesion quhet 'trungu i popullatës së një shteti' dhe Kosova në të kaluarën kishte trungun më të bukur të jetës në Evropë. Ndërkaq ky trung po fillon të lëkundet prej vitit në vit, ai po merr një formë tjetër dhe kjo duhet të na brengosë.

Këtu u përmendën statistikën nga kolegja se Kosova ka sipas moshës 662 mijë fëmijë të moshës 0-19 vjeç dhe të gjithë ata duhet të gëzojnë të drejtën, të cilën e propozojmë, por edhe kjo nuk është mjaft.

Propozimi që 3% e buxhetit të shkojë në favor të ndarjes të 10 eurove në muaj për fëmijët nuk do ta përmirësojë dukshëm gjendjen e tyre ekonomike, por do të tregojë një përkujdesje institucionale të shoqërisë, e cila ndoshta në kushte dhe rrethana të tjera do të mund të përmirësohej.

Në bazë të diskutimeve të gjertanishme, qoftë në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, qoftë në kuadër të deputetëve ose shoqërisë civile janë dhënë shumë propozime që Ministria për Çështje Sociale vlen t'i studiojë dhe të shohë edhe mundësi të tjera që ky buxhet të ketë mundësi më të favorshme se sa kjo shumë që propozohet. Për shembull, formimi i fondit për sigurime pensionale dhe sociale, ku do të hynte edhe faktori i solidaritetit dhe të gjithë të punësuarve me një shumë dhe përqindje të ulët, por që do të ishte shumë domethënëse për buxhetin që do të participonin edhe ata që s'kanë fëmijë, domethënë njerëzit që e kanë kryer këtë punë ose të tjerët që kanë të ardhura dhe mund të ndajnë për këtë fond, qoftë për nënën, qoftë për fëmijët, sepse ne sot kemi edhe të ardhura të lehonave shumë të ulëta ose disa fare nuk marrin ndihmë nga shteti për lindjet e tyre.

Në të kaluarën gjithashtu kemi pasur një propozim në mandatet e kaluara për pakot sociale ose pakot e ndihmës për të porsalindurit që u jepen fëmijëve posa të lindin me ndihmat dhe nevojat e domosdoshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje, regjia, fjalën deputetes!

FLORA BROVINA: Vetëm dy fjalë i kam, s'kam më shumë. Domethënë, dhe kjo mbeti si një ide, por nuk u realizua asnjëherë. Unë kërkoj që të shihet edhe kjo mundësi. Gjithashtu, mendoj se Kuvendi për këtë çështje duhet të debatojë edhe si për një resurs shumë të rëndësishëm ekonomik të shoqërisë tonë dhe të zhvillimit të Kosovës, sepse fëmijët, ardhmëria jonë është resursi më i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Prandaj, duhet një debat shumë i gjerë parlamentar dhe ndoshta një plan nacional për gjeneratën e re, të porsalindurit dhe fëmijët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate normalisht që e mbështet iniciativën e deputetes Kadaj-Bujupi, duke pasur parasysh se i mbështesim edhe politikat sociale.

Mirëpo, unë mendoj se një iniciativë e tillë do të duhej të vinte nga Qeveria, duke pas parasysh se Qeveria edhe ashtu tani që është në qeverisje gjatë fushatës elektorale e dimë shumë mirë se të tri subjektet politike në fushatë, gjegjësisht janë deklaruar dhe kanë premtuar shtesa për fëmijë, duke marrë parasysh edhe kryeministrin Haradinaj që ka thënë se çdo fëmijë do të ketë 20 euro shtesa. Po ashtu, edhe Partia Nisma Socialdemokrate, po edhe PDK-ja që, siç e dimë, jo vetëm tani në këtë fushatë, por prej pasluftës janë deklaruar shumë herë se do të ndajnë edhe nga 300 euro për çdo fëmijë të porsalindur. Mirëpo, siç e dimë, jemi 20 vjet pas luftës dhe gjendja është

kjo që është, prandaj kjo iniciativë është më se e domosdoshme dhe e vonuar, duke pas parasysh se 33% të fëmijëve jetojnë në varfëri, po ashtu 10% të fëmijëve janë përfshirë në punë, kurse 7% të fëmijëve punojnë edhe punë të rënda, që do të thotë se kjo ndihmon edhe në kushtet sociale.

Po ashtu, një ndikim, ndoshta jo edhe direkt, mirëpo e ka edhe në ngritjen e natalitetit, nuk do të them direkt, duke e pasur parasysh se shumë shtete të Bashkimit Evropian janë munduar që të ngritin shtesat, mirëpo nuk kanë mundur që të ngritin ndoshta edhe natalitetin, që do të thotë se duhen edhe politika të tjera në këtë drejtim. Që kemi rënie drastike të numrit të të lindurve, kemi! Vetëm për ilustrim të them se në vitin 2000 numri i lindjeve në Kosovë ka qenë 39 mijë, ndërsa në vitin 2017 numri i lindjeve është 23 mijë e 356 fëmijë të porsalindur. Sa i përket mocionit përmbajtjesor, te pika numër 1, ku thuhet “çdo fëmijë në Republikën e Kosovës prej moshës 0 deri 16 vjet të gëzojë shtesa çdo muaj me vlerë prej 10 euro”. Unë këtu nuk pajtohem sa i përket moshës, ku thuhet 0 deri 16, sepse duke pas parasysh me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, të miratuar në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara, ku neni 1 i kësaj konvente thotë që ‘fëmijë kuptohet të qenit prej 0 deri në 18 vjet’, çdo qenie njerëzore. Po ashtu edhe shkencërisht është vërtetuar se mosha fëmijërore është prej 0 deri në 18 vjet. Prandaj, unë po kërkoj që vitet të rriten, jo që të rriten për t’i ndihmuar mirëpo, duhet të rriten aq sa i përket nocionit “fëmijë”. Kështu që prej 0 deri në 18 vjet dhe propozoj që shuma prej 10 eurove të fillohet për një fëmijë 10 euro, më pastaj të rritet së paku për çdo fëmijë nga 5 euro. Meqenëse, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale është i pranishëm, unë po besoj se ai do të na përgjigjet, duke pasur parasysh se e dimë se ka iniciativë prej Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në një koncept-dokument, ku përfshihen edhe shtesat për fëmijë, prandaj ne duhet të dimë sa është kosto buxhetore, sa do të kushtojë dhe nëse, po shpresoj shumë se kjo do të votohet sot, kur do të fillojë së implementuari dhe se kur familjet tona, sidomos është shumë e mirëseardhur për familjet që janë në ndihmë sociale, kur do të marrin shtesat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë në emër të Nismës Socialdemokrate mbështes nismën e deputetes Donika Kadaj Bujupi dhe shpresojmë që vullneti i shprehur në këtë seancë apo vullneti i shprehur nga të gjithë deputetët në momentin e votimit do të merret seriozisht pastaj nga Qeveria që të hartojë një ligj sa i përket kësaj çështje, për shtesa të fëmijëve dhe ta sjellë qysh në projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, i cili besojmë që në muajin dhjetor do të kalojë.

Ndërsa, sa i përket çështjes se cila do të jetë shuma, 10 apo 15, mendoj se do të duhej t’i lihet Qeverisë që konform kapaciteteve buxhetore, të përcaktojë edhe shumën. Mirë do të ishte të mos jetë nën 10 euro, ndërsa mbi 10 euro, 15, apo 20, sado që ka mundësi buxheti i Kosovës ta përballojë pse jo, në fund të fundit ato para do të shkojnë te familjet kosovare dhe do t’i gëzojnë

fëmijët, prindërit, të cilët në këtë krizë të madhe të pafundësisë dhe të zhvillimit ekonomik në vend, do të ishin të mirëseardhura.

Kaq, sa i përket kësaj çështjeje dhe në punimet e mëtejme qoftë të kësaj seance deputetët e Nismës do të japin kontributin e tyre, si dhe pastaj edhe në komisione, sepse besojmë që kjo çështje do të kalojë edhe në komisione parlamentare pasi të ketë kaluar në Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Një iniciativë e tillë për rezolutë, për shtesa të fëmijëve, mendoj që është e vonuar, madje është dashur edhe më herët, por ne e përkrahim iniciativën e zonjës Kadaj Bujupi dhe po ashtu konsiderojmë se është një e drejtë themelore, e cila duhet të mundësojë që përmes ligjit të garantohet kjo ndihmë që u ofrohet familjeve, të cilat kanë fëmijë të moshave që u përmendën.

Po ashtu, konsiderojmë se kjo përkon edhe me gjendjen sociale ekonomike që ka Kosova dhe normalisht që bazohet edhe në strategjinë kombëtare, për shkak siç u cek edhe të rënies së natalitetit e që vërtet ne si popull vital kemi nevojë që të tregojmë edhe më tutje energjinë dhe vitalitetin që e ka populli ynë. Prandaj, e përkrahim si grup parlamentar dhe kërkojmë që sa më shpejt Qeveria ta krijojë bazën ligjore dhe familjet, të cilat do të kenë mundësi që të kenë fëmijë prej moshave të caktuara të marrin këtë ndihmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sa i përket kësaj iniciative, kjo projektrezolutë e cila ka ardhur nga kolegja deputete Donika Kadaj që të përkrahen fëmijët me një shtesë prej 10 euro, unë në emër të Grupit Parlamentar 6+ e përkrah, gjithashtu edhe për familjet tona që ne përfaqësojmë kjo kategori prej 10 euro do ta ketë vlerën pothuajse 100 euro për fëmijë, sepse kategorive të rënda sociale kur t'u jepen 10 euro për fëmijë do të thotë shumë, sepse ata me padurim e presin këtë.

I njëjti sistem është sikur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale që asnjëherë nuk e mori që ta zbusë kriterin për ato familje, kriteret për fëmijët, të cilët e gëzojnë asistencën sociale që posa t'i bëjë fëmija 5 vjet, këta ia ndërprejnë asistencën sociale. Kjo kurrkund në rajon nuk ndodh, përveç te ne në Kosovë dhe kategoria më e rëndë e familjeve preken me këtë kategori. Ne disa herë i kemi kërkuar, po edhe në këtë Kuvend që këto kritere të ndryshohen, sepse janë duke i prekur rëndë shtresat sociale, sidomos për ato familje të varfra po nga komunitetet tona, po edhe nga komuniteti shumicë, sepse një vlerë prej 70 eurosh apo 50 euro në muaj për kategoritë e rënda sociale është e barabartë me një pagë mesatare që e kemi ne si deputetë pothuajse 2 mijë euro.

Ata me padurim e presin pagën, atë shtesë e presin 100 euro, sepse me 100 euro planifikojnë ta kalojnë një muaj, kurse ne si deputetë nuk jemi në gjendje t'i zbusim kriteret që ato familje që së paku deri në 15 vjet apo 16 vjet, që t'i gëzojnë kategoria e asistencës sociale, rastet e rënda sociale ta gëzojnë këtë të drejtë. Unë asnjëherë nuk mund ta kuptoj, meqenëse është edhe këtu ministri, dallimi në mes të fëmijës 5 vjet edhe 5 vjet e një ditë. Asnjëherë nuk kam mundur të kuptoj këtë gjendje çka domethënë fëmija deri në pesë vjet e fiton të drejtën e asistencës sociale, e cila e merr një 70 euro, kurse kur t'i bëjë 5 vjet e një ditë nuk e ka atë të drejtë.

Kjo do të thotë që kategoritë e rënda sociale jemi duke i shkatërruar, nuk jemi duke i ndihmuar, por unë mendoj që ministri dhe Nisma, kur e kemi parë në fushatë, kanë dalë me deklaratat e tyre se së paku këtë kategori do ta ndihmojnë. Ne deri më tani ndoshta edhe i kemi duartrokatur, sepse rastet e rënda sociale nuk u interesojnë subjekteve politike, grupeve parlamentare, vetëm u intereson kush po i ngrit çështjet për asistencë sociale t'u ndihmohet kategorive të rënda, sepse me të vërtetë janë kategori që e meritojnë t'u ndihmohet. Unë besoj, meqenëse është ministri këtu, duhet ta marrë parasysh që kjo kategori prej 5 vjetëve të shkojë deri në 15 vjet apo 16 vjet, sikur janë kriteret në rajon, të jetë edhe në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Qytetarë,

Sigurisht që është një iniciativë jashtëzakonisht e rëndësishme, edhe pse u thanë shumë gjëra, është e vonuar, por më mirë vonë se kurrë.

Ne e përkrahim fuqishëm, por sigurisht që nuk pajtohem me të gjitha këto, për arsye që nëse ne duam ta zhvillojmë vendin tonë, nëse ne duam që ta pasurojmë vendin tonë, do të thotë pikërisht pasur vëmendjen te foshnjat, te ato foshnja deri sa të rriten, jo në 16, por në 18 vjet, dhe po ashtu të mos fillojë me një kosto minimale 10 euro, se është shumë qesharake. Unë propozoj që kjo kosto të jetë më e lartë dhe të shtohen domethënë në vend të 16 vjet, të jetë 18 vjet. Unë mendoj që nëse me të vërtetë ka filluar një iniciativë kaq e rëndësishme për vendin tonë, atëherë ta përkrahim të gjithë, ta ndihmojmë të gjithë dhe t'i bëjmë kriteret sa më të mira, të mos bëhemi koprracë, t'u japim mundësi të gjitha anëve të tjera, por të mos japim për fëmijët tanë. Kjo është pikërisht për fëmijët tonë, për gratë e Republikës së Kosovës, të cilat kanë vështirësi, pjesa dërrmuese nuk është në punë dhe te kjo pjesë është shumë e mangët, prandaj ne e kemi si obligim, si qytetarë që ta përkrahim fuqishëm dhe t'i kërkojmë që të ngrihen e të mos startojë me 10 euro, po le të jetë shumë më e lartë, s'po dua të them ndonjë shifër të caktuar, për arsye se besoj që edhe grupi do të punojë në këtë drejtim, por të ngrihet, të fuqizohemi për arsye që do të vijë dita kur nataliteti do të bjerë dukshëm.

Sigurisht ka edhe metoda të tjera, por kjo është kryesore. Secili që mendon të ketë fëmijë, duhet të mendojë edhe si t'i rrisë. Nëse nuk ka të ardhura, si mendon t'i rrisë. Unë e përgëzoj deputeten që ka marrë këtë iniciativë shumë të rëndësishme, i përgëzoj të gjithë deputetët që të jenë njëzëri, ta përkrahin, ta ngritin, të mos ndalemi në 10 euro, se e di që si të fillojë, pastaj një kohë të gjatë do të mbetet aq dhe nuk është ndonjë lëmoshë apo ndonjë përkrahje siç duhet, do të thotë nëse starton me 10 euro. Prandaj, nuk i kemi punët aq keq, nëse ne dimë t'i trajtojmë të gjitha gjërat dhe nuk kemi kujdes në projekte, sigurisht që kjo çështje do të jenë minimale, e cila nuk do të kenë ndonjë ndikim të theksuar në zhvillimin e Republikës së Kosovës, por përkundrazi, kjo do t'i japë një fuqi të përkrahjes së fuqizimit dhe zhvillimit nesër të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Prandaj, kur ne kemi mundësi që t'i rrisim fëmijët me kushte më të mira, sigurisht që e ardhmja e tyre, por edhe e Republikës së Kosovës do të jetë më e mirë.

Prandaj, AKR-ja e përkrah fuqishëm, por kërkon që minimumi të ngrihet dhe që afati të zgjatet deri në 18 vjet. Prandaj, starti do të jetë jo 10 euro, se është me të vërtetë shumë e vogël. Unë besoj që të gjithë deputetët do të pajtohen, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës dhe do të aprovojë një kosto shumë më të lartë, për arsye se është për fëmijët tonë, për të ardhmen tonë e të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mexhide Mjaku-Topalli.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot jemi këtu për të debatuar për shtesat e fëmijëve. Ajo çfarë dua të them në fillim të fjalës sime është se nataliteti në Kosovë po shënon rënie nga viti në vit, këtë e dëshmon raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që flet për 8 mijë fëmijë, foshnja më pak në vitin e fundit.

Sociologët konsiderojnë se shifrat e numrit të lindjeve do të bien ende gjatë viteve në vazhdim. Zhvillimi ekonomik dhe emancipimi i gruas kosovare ka ndikuar që në Kosovë për çdo vit të shënohet rënie e natalitetit. Brenda një viti sipas statistikave janë shënuar për afro 3 mijë lindje më pak. Edhe pse Kosova kishte numrin më të madh të lindjeve në Evropë, në krahasim me numrin e banorëve, në vitet e fundit numri i lindjeve ka shënuar rënie për më shumë se 10 mijë lindje më pak. Shkaktarë të rënies së natalitetit në Kosovë thuhet se janë kushtet e vështira ekonomike, Ligji i lehonisë, planifikimi familjar, si dhe emancipimi i femrës. Ndërsa, sociologët thonë se zhvillimi ekonomik dhe shkëputja e të jetuarit nga modeli kolektiv në atë individual, janë disa nga faktorët që çojnë deri te rënia e natalitetit. Po ashtu, sipas psikologëve, rënia e natalitetit që nga paslufta, e sidomos këto vitet e fundit mendohet se shkaktarë janë planifikimi më i mirë i familjes, migrimi i popullatës së re, e të tjerë. Ndërsa, sipas statistikave të ASK-së, popullsia aktuale e Kosovës pritet të rritet deri në mesin e viteve të 2030 dhe pastaj të bie deri në vitin 2050, si dhe së shpejti do të përballet me një fazë tranzicioni, ku deri në vitin 2030 gjysma e

popullsisë do të jetë mbi moshën 37 vjeç dhe deri në vitin 2050 gjysma e popullsisë do të jetë mbi moshën 46 vjeç. Popullsia nën moshën 18 vjeç parashikohet të bjerë me 1/5-tën, apo 20% nga viti 2015 deri në vitin 2030, me rënie të mëtutjeshme deri në vitin 2050.

Të nderuar deputetë,

Vendi ynë ka popullsi shumë më të re se vendet fqinja, sidoqoftë për shkak të strukturës aktuale të moshës ekziston mundësia që popullsia t'i nënshtrohet një procesi të plakjes në të ardhmen për shkak të lindjeve relativisht të vogla, që e ripërtërijnë piramidën e popullsisë nga fundi. Po ashtu, edhe migrimi i popullsisë në moshën për punë mund ta përshpejtojë këtë proces.

Të kuptuarit e këtij tranzicioni demografik dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm sa i përket adresimit të sfidave dhe mundësive në mënyrë adekuate dhe vendosjes së politikave adekuate është e një rëndësie të veçantë. Dritarja e mundësive për Kosovën është akoma e hapur, por do të mbyllet së shpejti dhe koha për veprim të politikave është kritike. Është e nevojshme bërja dhe zbatimi i duhur i politikave që në mënyrë të duhur do t'i adresonim mundësitë dhe sfidat, andaj bërja e një ligji të veçantë do ta garantonte një politikë më të qëndrueshme sa u përket këtyre kategorive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se potpredsednice Parlamenta!

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Želim da dam potpunu podršku mojoj kolegici Doniki u ovoj zajedničkoj ideji oko institucionalne podrške svoj našoj deci kojih ima više od pola miliona na Kosovu, uzrasta od šest pa sve do šesnaest godina, i uvrstimo u obavezan Budžet Republike Kosova kao prioritet povećanja nataliteta i podrške ne samo deci, nego i njihovim roditeljima, jer ako jedna porodica, gospodo, ima troje, četvoro ili petoro dece, i ako mi poslanici rezolucijom usvojimo više od deset evra na dete mesečno njihovo primanje da bude, onda će porodični mesečni budžet biti efikasniji i produktivniji za egzistenciju celokupne njihove porodice.

Ovom inicijativom i ja kao poslanik iz redova manjinskih zajednica stavljam akcenat posebno na decu, odnosno mladu populaciju iz redova Bošnjačke nacionalne zajednice koja pretežno živi u ruralnim mestima, počev od Prizrenskog regiona, Župe i Podgora, zatim Gore, okolnih sela opštine Peć, Istok, Leposavić, Mitrovica, deca koja svakodnevno putuju do svojih okolnih škola i njima je u ovom momentu najpotrebnija finansijska podrška naše države zbog mnogo čega, počev od velike nezaposlenosti, najbližih ukućana, velika siromaštva, ali loših socio-ekonomskih uslova celokupne njihove familije.

Poštovani kolege poslanici,

Svi zajedno trebamo podržati ovu inicijativu i uzeti maksimalno učešće u ovome i zbog socijalne politike naše zemlje, koja nam je u ovom momentu jako potrebna jer statistički podaci nam govore da unazad desetak godina natalitet kao globalni problem države je u velikom padu, te mi ovom inicijativom dajemo podršku i mladim bračnim parovima oko planiranja njihovih budućih porodica. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Thirrja e debatit për diskutim lidhur me aplikimin e shtesave të fëmijëve është mirëpritur sigurisht nga të gjithë ne, por në veçanti nga prindërit të cilët do ta marrin një lehtësim për mirëqenie të familjes dhe ndihmë për rritjen e zhvillimit të tyre.

Fëmijët e kanë një rëndësi vendimtare për të ardhmen e vendit tonë dhe ne kemi obligim që të kujdesemi për krijimin e kushteve sa më të mira. Kosova është i vetmi vend i rajonit që nuk siguron të ardhura për familjet që rritin fëmijë, edhe pse unë nuk mendoj se do të ketë ndonjë lëvizje të madhe me këto shtesa që janë paraparë deri në dhjetë euro si të hyra familjare, porse ato janë të domosdoshme dhe ndikojnë dosido në rritjen e mirëqenies sociale të përgjithshme. Po ashtu, shtesat për fëmijë shmangin boshllëqet në mbulimin e të gjitha familjeve në nevojë.

Ato e përmirësojnë pozitën e familjeve më të varfra të cilat shpesh dështojnë të marrin, ose nuk përmbushin kriteret për asistencë sociale. Investimet në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë të domosdoshme për secilin vend që mbështet të drejtat e njeriut. Nëpërmjet investimit në fëmijë do të krijohet fuqi punëtore më e shëndoshë dhe më e kualifikuar, që mund të kontribuojë më shumë në zhvillim ekonomik, duke përvetësuar teknologjitë dhe shkathtësitë e reja konform nevojave të tregut.

Investimet e pamjaftueshme sociale, pabarazia e theksuar dhe varfëria e lartë e pengojnë zhvillimin e një vendi dhe e dëmtojnë kohezionin social të tij.

Rezoluta e Parlamentit Evropian B70004/2014 për procesin e integritit të Kosovës në BE, me theks të veçantë në paragrafin 38, ku flitet për të drejtat e fëmijëve dhe varfërinë e fëmijëve, u bën thirrje autoriteteve kosovare për ta zbatuar plotësisht Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe rekomandon që politikat për varfërinë e fëmijëve të rishikohen, duke përfshirë modifikimin e skemës së asistencës sociale dhe krijimin e një benefiti universal për fëmijë. Praktikrat dhe modelet nga shtetet tjera të rajonit dhe Evropës janë të ndryshme lidhur me shtesat për fëmijë,

kjo sa i përket moshës së fëmijëve, numrit të fëmijëve në familje, si dhe shumës së shtesave për fëmijë.

Sa i përket moshës, shtetet kryesisht e kanë vendosur si kufi moshën 18-vjeçare. Sa u përket këtyre modeleve, disa shtete e praktikojnë modelin e shtesave universale për fëmijë, që nënkupton transfere të pakushtëzuara për të gjitha familjet me fëmijë, pa marrë parasysh nivelin e të hyrave familjare, apo statusin e punësimit të anëtarëve të familjes. Modelet po ashtu mund ta përfshijnë edhe përcaktimin apo përshkallëzimin e pagesave, bazuar në të ardhurat vjetore të familjes, numrit të fëmijëve në familje, apo edhe përshkallëzimin e shtesave sipas moshës së fëmijëve.

Unë mendoj se ne duhet të analizojmë me kujdes dhe të vendosim modelin më të përshtatshëm për rrethanat e Kosovës, gjithmonë duke pasur për bazë si kriter kryesor mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Kosova nuk e zbaton asnjë skemë sociale, apo përfitime për fëmijë. Shtesat për fëmijë janë si një nevojë emergjente, sepse në mënyrë automatike ndikon në zbutjen e varfërisë në familjet me nevojë. Sipas disa hulumtimeve të organizatave joqeveritare, që merren me të drejtat e fëmijëve, thuhet se në Kosovë rreth 33% të fëmijëve jetojnë në varfëri, 10% e fëmijëve janë të përfshirë në punë, rreth 7% punojnë në punë të rënda dhe të rrezikshme.

Në Kosovë pagat janë të vogla, por tash, siç e dini, Ligji i pagave është në Kuvend dhe besoj që ka për të ndryshuar kjo statistikë dhe shtesat do të ndikojnë në buxhetin familjar. Ne duhet të kemi legjislacion dhe harmonizim të legjislacionit në mënyrë që kjo nismë të trajtohet me seriozitet dhe në Ligjin e Buxhetit, që pritet të vijë në Kuvendin e Kosovës, duhet të përfshihet edhe ky buxhet për shtesat e fëmijëve.

Kosova njihet si vend me moshë të re të popullsisë, por fatkeqësisht viteve të fundit ka një rënie të natalitetit, gjë që është brengosëse. Vendet e rajonit, por edhe më gjerë, për shkak të rënies së natalitetit për çdo lindje po shpërndajnë benefite të shumta në mënyrë që popullata të nxitet për lindje të reja, ndërsa në Kosovë deri më sot nuk është bërë asgjë. Le të fillojmë me dhjetë euro, ashtu qysh është propozuar me rezolutë, le të jetë një nismë e mbarë dhe sipas rritjes ekonomike dhe sipas buxhetit që posedon Kosova, shtesat e fëmijëve mund të rriten. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Xhavit Haliti,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e përgëzoj iniciuesen e këtij debati për iniciativën e mirë dhe të qëlluar. Realisht si deputet dhe Parlamenti i Kosovës kur diskutojmë për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët, për një jetë më të mirë për ta, nuk do të duhej që kjo sallë e Kuvendit të jetë e zbrazët, por do të duhej të ishte e tëra e mbushur dhe të diskutojmë për të bërë më shumë e më mirë për fëmijët tanë, për fëmijët e Kosovës, sepse këtu jemi për ata. Apo ndoshta edhe botëkuptimi i të qenët deputet viteve të fundit ka pësuar ndryshime dhe shumica janë duke menduar se këtu janë për të ardhur në mënyrën më të shpejtë të pushteti, ose të përfitimi për vete.

Çka do të duhej të diskutonim sot përveç shtesës për fëmijë duhet të diskutonim edhe për më shumë të drejta për ta, sepse është më se evidente se në Kosovë dhuna fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve është e madhe. Rastet që paraqiten edhe në medie, por edhe që raportojnë organizatat ndërkombëtare dhe ato vendore për ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve është e madhe dhe ne do të duhej ta bënim një debat të tërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për një arsimim dhe shëndetësi më të mirë për ta.

Ne po diskutojmë sot për shtesat për fëmijë, por fëmijët e Kosovës ende nuk kanë sigurim shëndetësor. Ne ua japim dhjetë euro në muaj, edhe njëzet, edhe pesëdhjetë, edhe njëqind, por janë njëqind raste që shkojnë për trajtime jashtë vendit në mungesë të sigurimeve shëndetësore dhe rastet e fundit janë edhe ato kur fëmijët e Kosovës shkojnë për shërim në Beograd, sepse këtu nuk mund ta marrin sigurimin e duhur shëndetësor. Ne e kemi miratuar Ligjin për sigurime shëndetësore në vitin 2014 dhe po shkojmë në fundin e vitit 2018, e jemi larg të arriturës së asaj për të ofruar sigurime shëndetësore, që të mbroheshin edhe fëmijët dhe shëndeti i tyre, por edhe i gjithë popullatës në tërësi.

Duhet të punojmë më shumë, sepse me këtë propozim mendoj se do të zvogëlohet pabarazia të fëmijët, të kategoritë sociale që kanë nevojë për mbështetje dhe përkrahje nga shteti dhe benefitet pastaj do të ishin edhe nga ajo që tha edhe në rritjen dhe shtimin e popullsisë, sepse vërtet kemi një rënie viteve të fundit të shtimit të popullsisë dhe besoj që me hapa të tillë, por edhe me një strategji që do të duhej të vinte nga Ministria dhe nga Qeveria, strategji konkrete se si të shkojmë edhe kah avancimi i të drejtave të fëmijëve, nga një zvogëlim i pabarazisë në arsim, në shëndetësi dhe në siguri, sepse këto janë sfida, të cilat edhe organizata ndërkombëtare UNICEF-i në Kosovë i ka paraqitur si sfidat kryesore të pabarazisë të fëmijët në Kosovë, ku vetëm 3,5 për qind e fëmijëve parashkollorë e vijnë në mësimin, pra janë të angazhuar në angazhimet parashkollorë apo edukimin parashkollor që e marrin, ndërsa 80 për qind e tyre vijnë në arsimimin parafillor.

Pra, kemi ende punë për të bërë për të arritur edhe te shtesat, të cilat besoj që kishin për të kontribuar në këtë drejtim. Mendoj që përveç këtij debati do të duhej të organizonim debat ku këto fraksione, apo këto inatet tona politike po shpërfaqen dhe kur pothuajse 80 për qind e sallës është bosh, kur diskutojmë për të ardhmen e fëmijëve të Kosovës, e kjo nuk do të duhej të ndodhte. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit. Në fund, fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Në një debat të thirrur kuptohet muaj më parë, por që nuk është një temë e re, por është një seriozitet që sinqerisht do të duhej të na tharrasë secilin deputet dhe secilin subjekt politik që të ulemi dhe të mendojnë për një shqetësim që nuk është që po e kuptojmë sot, por është shqetësim i vazhdueshëm për rënien e natalitetit në Republikën e Kosovës.

Tani debati i thirrur sot nga Grupi ynë Parlamentar është jo vetëm kërkesë e vazhdueshme gjatë fushatave, por sinqerisht burimin e ka pikërisht te familjet, mbi të gjitha te nënat. Unë si nënë e katër fëmijëve them që pak fëmijë kemi lindur dhe për t'i motivuar familjet për të lindur, çdo qytet, çdo shtet në rajon e ka të rregulluar një çështje të tillë.

Po, do të fillojmë me 10 euro, që është shumë simbolike, por në këtë rast për të bërë politika, sepse nuk mund të flasim në aspektin financiar, si shumë ekspertë, duhet të ndalemi, është minimumi, mirëpo të ndalemi të gjithë së bashku pa interesa të subjekteve politike dhe të fillojmë ta implementojmë një kërkesë të tillë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Por, mbi të gjitha, jo vetëm për fëmijët, unë pajtohem se fëmijë është që nga mosha 0 deri 18 vjet, por e kemi diskutuar edhe me Donikën më herët, mirëpo janë shumë arsye që e kemi propozuar moshën 0 deri 16 vjet. Mirëpo, në qoftë se propozimet e grupeve të tjera parlamentare janë për 0-18, pse jo, është me interes edhe të të gjithë neve. Mirëpo, duhet të ndalem edhe një herë se çfarë ndikon në rënien e natalitetit. Janë shumë faktorë, pra. Fëmijën e lind nëna, e rrit nëna, e ku është preokupimi i shtetit? Mbrojtja e tij, pra mezi po arrijmë ta kalojmë një ligj për mbrojtjen e fëmijëve në lexim të parë, pas shumë e shumë kohe.

Në mandatin e kaluar erdhëm deri në përfundim dhe nuk mundëm ta kalojmë ligjin për mbrojtjen e fëmijës. Çka bën shteti atëherë për fëmijën?

E atëherë t'i bëjmë hapat e parë, në mënyrë që të fillojmë me një simbolikë pra materiale, por mbi të gjitha është mbrojtja, ruajtja dhe atë që e tha edhe kolegu, arsimimi dhe shëndeti i fëmijës. Mirëpo, për mua, edhe një herë, për rënien e natalitetit në Kosovë janë edhe shumë faktorë të tjerë. Mbi të gjitha, themi që bizneset në sektorin privat duhet t'u krijojnë lehtësira, ose të mendojnë në politika që ju krijojnë lehtësira në mënyrë që të pranojnë të punësojnë nëna të reja,

apo nëna, qoftë që janë shtatzëna apo që kanë fëmijë të vegjël, ngase sinqerisht këto diskriminohen, apo nëse dikush e kupton që një nënë ka aplikuar dhe është shtatzënë, ajo nuk vjen në shprehje për t'u punësuar. Këto janë fakte, këto janë fakte që na drejtohen shumë herë. Nënat të cilat fatkeqësisht obligohen, detyrohen pra, ose e ndërpresin që të mos lindin më shumë fëmijë, ose në kushte jo të mira pra ta rritin një fëmijë, por të mos mendojnë për më shumë se një fëmijë.

Po, një iniciativë shumë e mirë, jo vetëm që kërkon mbështetje, por të mendojmë edhe për politika të tjera për kompensimin e familjeve që lindin një, dy, tre fëmijë e kështu me radhë. Pra, t'i kompensojmë familjet, jo vetëm materialisht, por edhe të kenë lehtësira të tjera. Pse të mos mendojmë për ata që kanë nevojë edhe për strehime, në qoftë se vërtet e kanë të nevojshme.

Pra, këto politika nuk mund t'i bëjmë vetëm, mirëpo janë me interes për të gjithë neve, prandaj secili prej grupeve parlamentare duhet t'i japë rekomandime të veta në këtë nismë, nismë të mbarë tonën, sepse e kemi thënë vazhdimisht dhe tani nuk e kemi shumë për lavd se nuk është risi, mirëpo kërkojmë mbështetjen e të gjithëve, sepse fëmijët janë të të gjithëve dhe pa qenë fëmijë nuk mund të jesh as deputet, as i rritur. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit. Zonja Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër i vetëm që të kemi sot këtu!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë që e përcillni seancën,

Sot e kemi një debat interesant, kërkesa për një rezolutë e cila i mundëson shtesat e fëmijëve në vendin tonë, zhvillohet për herë të parë, edhe pse në fillim të mandatit realisht qeverisës e kemi pasur domethënë në planprogram dhe besoj që është e Kryeministrit, por sigurisht që kjo temë do të diskutohet një ditë kur do ta kemi komplet Kabinetin dhe dikush do t'i drejtohet me një pyetje parlamentare.

Është një temë që ka pasur nevojë të diskutohet, por të jemi të sinqertë është edhe një temë shumë popullore për të cilën normalisht që secili grup politik po besoj që kishte për të pranuar me të vërtetë një kërkesë të tillë, mirëpo ne e dimë se nuk do të jetë e mundur që edhe shumë shpejt të realizohet. Për këtë duhet të jemi të sinqertë, sepse ne për këtë më shumë duhet të llojmë në komisionet përkatëse, edhe vetë në Ministrinë e Financave, bashkë me ministrin e Punës që e kemi sot të pranishëm, ndërsa diskutimet që i kemi sot nuk janë që sot e tutje do të përfundojmë me një rezultat pozitiv dhe do të kemi mundësi që ta realizojmë këtë.

Unë mendoj pak më ndryshe në qasjen tek mundësia e dhënies së shtesave dhe çështja e natalitetit. Pra, është fakt që e kemi një natalitet në rënie dhe është një fakt jo i mirë mbyllja e

paraleleve. Mirëpo, unë konsideroj se këtu është edhe një element tjetër, pra është ngritja e vetëdijes qytetare, janë familjet e reja që krijohen dhe që sot e zhvillojnë numrin e fëmijëve në bazë të planifikimeve që i bëjnë.

Mirëpo, sigurisht se është një element shumë pozitiv nëse ne arrijmë të vendosim me rregullativë ligjore këtë mundësi. Pra, të kemi të hyra si të hyra të veçanta për fëmijët që unë personalisht kisha menduar se shumë më e mirë do të ishte në skema sociale, për shembull, të ndihmat e familjeve në nevojë, të zvogëlohet numri i atyre ndihmave dhe të rritet numri, pra për fëmijët të kemi rishikim të skemave sociale.

E dëgjuam se kjo i prek mbi 500 mijë fëmijë në vendin tonë dhe është numri prej 0 deri 16. Sigurisht që ne në momentin kur të na vijë kjo mundësi do ta rritim deri në 18, sepse e dimë se deri në 18 vjet ka nevojë, sepse familjet tona ende janë familje që jetojnë në mënyrë tradicionale dhe fëmijët jetojnë me ne jo deri në moshën 18, po mundësitë janë që të jenë me neve edhe më gjatë.

Po ashtu, ju e dëgjuat edhe kolegen time e cila prezantoi në emër të PDK-së, ky debat nuk do të përfundojë vetëm sot, është një debat i cili është ringjallur pas shumë temave të cilat ka nevojë që diskutojmë. P.sh., unë mendoj se me të vërtetë çështjet e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe çështjet e të drejtave të fëmijëve janë tema për të cilat kemi nevojë shumë më shumë t'i diskutojmë në Kuvend. Por, diskutimet tona pastaj të materializohen me punë konkrete që të materializohen me rezultate, sepse sot na shikojnë mijëra nëna. Veçanërisht shqetësimi im është për nënat të cilat nuk e kanë mundësinë të punojnë. Pra, se ndihmat sociale kur të arrijnë në familje e dimë se e prekin një interes konkret të ushqimi, të higjienës, mirëpo është numër shumë i vogël i mundësisë që të prekin interesin drejtpërdrejt të rritjes me kualitet të fëmijët.

Pra, nëse kjo ndodh që ne arrijmë të kemi një mundësi që t'i bëjmë shtesat e fëmijëve, atëherë mendoj se ka mundësi që edhe të vetëdijesohen edhe familjet tona, e jo ta marrim jo vetëm një ndihmë sociale dhe të mos i kurajojmë që të kenë një punë, ose të punojnë thjesht. Mirëpo, kështu në njëfarë mënyre e rritim edhe dembelinë shoqërore, pra shumë më mirë që të ndërrohen te skema sociale, të vendosim shtesat e fëmijëve dhe ta rishikojmë edhe një herë mundësinë se sa familje i kemi në skema sociale.

Sidoqoftë, debati është i qëlluar që të fillojë këtu, por punë kemi shumë në këtë drejtim. Unë e falënderoj kolegen time për iniciativën. Do ta mbështetim çdo iniciativë që ka qëllimin e mirë të rritë kualitetin e jetës në familjet tona në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën dhe pastaj zoti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë!

Është shqetësues fakti që numri i lindjeve nga viti në vit është duke rënë. Kjo dukuri ndikon drejtpërdrejt në plakjen e popullsisë, pra mosha mesatare e popullsisë shkon duke u plakur dhe fakti që ne Kosova mburremi me rininë dhe moshën mesatare më të re në Evropë, nga viti në vit kjo pasuri po zhduket ende pa i shfrytëzuar përparësitë e saj.

Ja disa statistika në vijim: Në vitin 2014, në Kosovë kishim 32 369 lindje; në vitin 2015 kishim 31 433 lindje, gati një mijë lindje më pak, përderisa më 2016 në Kosovë kishte 30 331 lindje, papë rreth një mijë lindje më pak. Edhe më shqetësues është fakti se në vitin 2017 kishim rreth 23 000 lindje, që d.m.th. numri është duke rënë në mënyrë shumë drastike.

Aprovimi i kësaj rezolute është një mundësi e mirë që Qeveria të dëshmojë përkushtim në reformimin e politikave familjare, për më shumë solidaritet dhe barazi për fëmijët e Kosovës. Uroj të jetë një javë e mbarë, sot shtesat e fëmijëve, të enjten ushtria dhe besojmë shumë deri në fund të vitit edhe vizat, apo liberalizimi i tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mërgim Lushtaku e ka fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht e përgëzoj deputeten për iniciativën për debatin për shtesat për fëmijë. Edhe unë personalisht me ardhjen time si deputet në këtë Kuvend e kam parë të nevojshme dhe kam bërë hulumtime të ndryshme dhe më vjen mirë që Donika, jo vetëm në këtë mandat, por edhe në mandatin e kaluar e ka ngrehur si çështje, që nuk është vetëm shqetësim i Kosovës, por besoj që është edhe i Ballkanit dhe problematikë e gjithë Evropës.

Për mendimin tim është mirë që kësaj dukurie, kësaj çështjeje t'i bëjmë një hulumtim të mirë, edhe një studim të mirë, para se të vendosim politika, ose para se ta vendosim me një ligj të caktuar.

Sigurisht që ne kërkojmë nga Qeveria që të jetë më azhure në këtë drejtim që t'i rregullojë politikën në të mirë të familjeve, kryesisht në rritjen dhe edukimin e tyre, pasi, siç e përmendën edhe parafolësit e mi, janë shifra dhe statistika alarmante për shoqërinë kosovare dhe në këtë drejtim besoj se për ne si kuvendarë është shumë e rëndësishme që të marrim hapa për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Sigurisht se nuk mjafton vetëm me rezoluta, pasi unë e kam parë që me ardhjen tonë në këtë Kuvend kemi e ngrehur shumë rezoluta, edhe para neve, edhe kuvendet e tjera, edhe deputetë të

tjerë në mandatet e tjera kanë ngrehur dhe kanë miratuar në Kuvend dhe kanë miratuar rezoluta të ndryshme, por fatkeqësisht nuk e kemi një rezultat pozitiv në zbatueshmërinë e këtyre rezolutave. Po kemi problem në zbatimin e ligjeve, e të mos flasim në zbatimin e rezolutave.

Ne e dimë se në ngritjen dhe uljen e kombeve faktori njeri është burimi kryesor dhe për këtë arsye besoj që ne duhet ta kemi një fokus të veçantë te familja, pasi është qeliza kryesore e shtetit dhe besoj që krijimi i familjeve të reja, sidomos gjeneratave të reja, kemi parë që kanë vështirësi të jashtëzakonshme për shumë shkaqe, njëra ndër to edhe papunësia, është pasojë që kemi rënie të natalitetit.

Në këtë drejtim, besoj është e mirëseardhur ideja për shtesat për fëmijë ose ka mundësi të ketë edhe shtesa për lindje të fëmijëve, pasi edhe në rajon kemi shembuj të ndryshim sesi stimulohet rritja e natalitetit. Shtesa për fëmijë është element kyç për lehtësimin e familjeve, jo vetëm për rritjen, por edhe për edukimin dhe formësimin e identitet dhe dinjitetit të çdo fëmije.

Sigurisht që fëmijët janë e ardhmja e këtë vendi sikurse e çdo shoqërie tjetër dhe në këtë drejtim besoj që e kemi edhe mbështetjen time personale. Besoj që, nuk mjafton siç thashë edhe më herët vetëm ta krijojmë një rezolutë, por besoj që si propozim konkret imi është që ta krijojmë një grup punues brenda grupit parlamentar në Parlament bashkërisht me Qeverinë që t'i bashkërendojmë aktivitetet tona në këtë drejtim dhe të shikojmë në vazhdimësi sesi po zbatohet ky ligj.

E dimë se Kuvendi zakonisht miraton ligje, shumë pak ka iniciativa të drejtpërdrejta që formojnë dhe hartojnë ligje ose projektligje. Në këtë drejtim, besoj që është edhe vullneti i grupeve të ndryshme parlamentare që të ecet përpara dhe ta bëjmë një bashkërendim edhe me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe ta hartojmë një projektligj që është në të mirën e qytetarëve të vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

E di që tashmë thuajse vetëm se u shtor debati në këtë drejtim, por duke qenë një kohë të gjatë në politikë e di që nuk ka pasur fushatë e as parti politike që nuk kemi premtuar që do ta bëjmë, do ta bëjmë, do ta bëjmë, shqyr që erdh në Kuvend të Kosovës dhe po diskutojmë për një të drejtë e cila në vende të zhvilluara të botës nuk është temë.

Shpresoj, sikurse thotë populli: “T’i shtrijmë këmbët sa e kemi jorganin”. Mirë do të ishte që kjo vlerë të jetë më e madhe, por duke e njohur realitetin në Kosovë, gjendjen buxhetore, natyrisht se duhet të startojmë me 10 euro, pastaj me kalimin e kohës shpresoj që do të mund t’i avancojmë edhe vlerat buxhetore. Në të njëjtën kohë çfarë do të ishte me shumë rëndësi, sikur ta gjenim një

formë për shembull, sot kur kemi ardhur në Kuvend, vetëm në semaforë i shihni 30-40 fëmijë tërë ditën, në minus temperatura në çfarëdo kushtesh ne i shohim aty. Do të thotë, edhe në këtë drejtim ministria duhet ta gjejë një formë sesi duhet të trajtohet ky problem, ngase ky është problem jo vetëm në kryeqytetin tonë, por në të gjitha qytetet e Kosovës, dhe kryesisht janë fëmijë nën moshën 10-vjeçare. Pastaj, tjetra për të cilën mendoj se është shumë me rëndësi, domethënë këto janë edhe disa kushte që ne jemi të detyruar që t'i plotësojmë në mënyrë që të bëhemi anëtar i UNICEF-it, sepse janë disa standarde të cilat kërkohen të plotësohen nga ministri.

Për këtë arsye, sa më shpejt që e gjejmë një zgjidhje ligjore, por në të njëjtën kohë edhe në harmoni me Ministrinë e Financave do të ishte mirë që të paktën të mendohet që në vitin e ardhshëm të startohet me implementim.

Natyrisht e përgëzoj Donikën për këtë nismë të sotme dhe shpresoj që edhe kolegët e tjerë nga opozita do të jenë të pranishëm kurdo që e hedhim në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit kryesues.

Do të jem pak më i shkurtër, sepse zoti Lushtaku e tha një pjesë të asaj që edhe unë e kam menduar, edhe është shumë e rëndësishme që të bëhet harmonizimi i kësaj rezolute me grupet parlamentare, por edhe me Qeverinë.

Ne sot nuk duhet të ngutemi, e as edhe ndoshta edhe për një kohë të shkurtër nuk duhet të ngutemi për ta votuar një rezolutë, por duhet ta shikojmë mundësinë e harmonizimit edhe të grupeve parlamentare, por edhe të Qeverisë. Po ashtu, unë kisha pasur dëshirë që ministri në emër të Qeverisë t'i shohë politikat e Qeverisë lidhur me familjen, por në këtë pjesë edhe politikat që kanë të bëjnë me fëmijët. Ta dëgjojmë edhe ministrin në emër të Qeverisë. Por, gjithsesi duhet harmonizim. Për shembull, PSD-ja e tha një ide interesante; për çdo fëmijë të ketë një rritje progresive të ndihmës, që është ide interesante që ta shohim edhe koston financiare që të duket edhe më e arsyeshme.

Ajo që ka bërë sot Donika dhe grupi parlamentar, ose deputetët që e kanë përkrahur Donikën, ne i falënderojmë sepse kemi bërë një debat më se të nevojshëm, por si përfundim kjo duhet ta ketë një harmonizim. Jo të ngutemi sot që të votojmë, por as të ngutemi në votim. Të bëhet harmonizimi ndërmjet grupeve parlamentare, edhe me grupet parlamentare të cilat janë duke e bojkotuar këtë seancë, pse jo edhe me ta, e sidomos me Qeverinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ke kartelën e Ahmet Isufit. Jepja pra Ahmet Isufit fjalën. Zoti Nitaj!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe pak sqarim! Në fakt, nisma e deputetes Kadaj-Bujupi, e mbështetur nga grupi i deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nuk ka ardhur pa një dakordim paraprak, nuk ka ardhur pa një kalkulim paraprak, nuk është që e kemi bërë krejt në krye më vete.

Në fakt, e kemi konsultuar edhe Qeverinë, e kemi konsultuar edhe kryeministrin dhe prandaj e kemi nxjerrë në Kuvend. Sigurisht se ka propozime edhe mundësi shumë të mëdha. Unë i kuptoj kërkesat që shuma e mjeteve për shtesat e fëmijëve të mos jetë, dikush e cilësoi qesharake, por e kuptoj edhe më duket sqarimi më i mirë që është dhënë për këtë çështje nga deputeti Sherifi, ‘të mos bëjmë pazar pa hanxhiun’, paratë i ka Qeveria e Kosovës. Besoj që është mirë që ta miratojmë rezolutën pa specifikuar se cila do të jetë lartësia e të ardhurave për kokë të fëmijëve në shtesat e tyre dhe këtë ta lëmë në diskrecionin e Qeverisë, e cila do ta harmonizojë në përputhje me kapacitetet financiare që ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka ministri Reçica. Kërkoj falje për diskriminim që nuk ta kam dhënë fjalën më herët!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për debatin dhe temën që sot bashkërisht të gjithë ju deputetë, por edhe unë në emër të Qeverisë me shumë me vëmendje i dëgjova të gjitha diskutimet dhe ky debat i cili ka të bëjë me trajtimin meritore të fëmijëve, i cili ka të bëjë me trajtimin meritore të së ardhmes së fëmijëve, ky debat i cili ka për temë trajtimin e mirëqenies së fëmijëve po vjen në kohën kur ne si Qeveri dhe përkatësisht në kohën kur ne si ministri pothuajse jemi fare në fund që këtij Kuvendi t’ia sjellim një projektligj i cili do ta prekë edhe fushën e shtesave të fëmijëve.

Jorastësisht si Ministri të Punës, vitin 2018 e kemi quajtur vit të reformave, dhe shpeshherë jam pyetur se çka do të thotë kjo “Vit i reformave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”? Po, vit i reformave, sepse ky vend vërtet ka nevojë për reforma që prekin dhe përmirësojnë mirëqenien e çdo qytetari. Ju them me shumë përkushtim, me shumë vëmendje që brenda këtij viti të parë të qeverisjes kemi vërejtur që shumë çështje të cilat prekin në esencë mirëqenien e qytetarëve ka pasur nevojë për një reformë.

Po bisedojmë për fëmijët sot, po flasim për fëmijët, për shtesat e fëmijëve, dhe pa dashur është bërë për të gjithë ne brengë rënia e natalitetit. Dhe, unë e shtroj pyetjen; nuk është dashur që të bëhet nataliteti në Kosovë brengë si rezultat i buxhetit. Po t’i dëgjojmë me vëmendje të gjitha diskutimet që bëjnë këtu, vërehet qartë që realisht nuk qenka bërë nataliteti brengë e këtij vendi në mungesë të buxhetit, por në mungesë të iniciativave, në mungesë të ndërmarrjeve, dhe jorastësisht sot unë i referohem një shifre zyrtare nga Ministria e Arsimit që më 1 shtator kemi pasur në banka (shkolllore) 16 mijë fëmijë më pak. Kjo është shqetësuese për të gjithë ne dhe për

secilin qytetar dhe për secilin pushtetar. Jo vetëm për ne që jemi sot këtu, por edhe ata që kanë qenë para nesh.

Kujdesi dhe mbrojtja e fëmijëve tanë është detyrë dhe obligim i gjithsecilit prej nesh si pjesë e kësaj shoqërie, nisur nga familja dhe deri te institucionet përgjegjëse për ofrimin e mbrojtjes së fëmijëve. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për zhvillimin e politikave sociale, hartimin e legjislacionit, standardeve dhe planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, me theks të veçantë mbrojtjen e fëmijëve.

Me qëllim të ngritjes së avancimit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në muajin qershor të këtij viti Qeveria e ka aprovuar Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, i cili sot në parim është miratuar edhe nga ky Kuvend. Ky ligj rregullon mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë formë tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e tyre.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ofron mbështetje për skemat e pagesave për kategori të caktuara dhe specifike për mbrojtjen e fëmijëve dhe këto janë: Përkrahja e familjes që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar, pagesa e strehimit familjar për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe të braktisur, pagesa apo shtesa për fëmijë aplikohet edhe te familjet përfituese nga skema e asistencës sociale. Po ashtu, disa fëmijë përfitojnë edhe nga disa skema të tjera të pagesave dhe përfitimeve nga skemat e kategorive të dala nga lufta dhe skema e kategorive tjera të pensioneve dhe beneficioneve të ndryshme.

Këto do të thotë janë beneficione të cilat Ministria Punës i ndanë për disa kategori të caktuara të fëmijëve.

Të nderuar deputetë,

Sa u përket ftesave për fëmijë, më lejoni t'ju njoftoj se shtesat për fëmijë bëjnë pjesë në njërin nga nëntë sistemet për sigurimet sociale; krahas pensionit kontribuues, pensioni invalidor i punës, pensioni familjar, pensioni i paaftësisë së përkohshme, sigurimi shëndetësor, sigurimi nga aksidentet në punë dhe sëmundje profesionale, sigurimi nga papunësia, kompensimi për pushimin e lehonisë.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, siç e ceka fare në fillim të diskutimit tim, tashmë është fare në fund të draftimit të projekt-koncept-dokumentit për reformën e sistemit pensional. Dhe, në këtë koncept-dokument parashihet krijimi i fondit për sigurime sociale, në të cilin në një të ardhme të afërt do të instalohet edhe sistemi i shtesave për fëmijë.

Sipas të dhënave zyrtare, numri i fëmijëve në moshën 0-14 mund të jetë rreth 450 000 fëmijë, andaj nëse fillohet me zbatohet me një skeme të fëmijëve duhet të përcaktohet qartë mënyra e financimit dhe mbulimit të kostos për pagesën e shtesave për fëmijë.

Për këtë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është duke punuar në koncept-dokumentin të cilin e ceka për reformën pensionale me qëllim që shtesat për fëmijë të realizohen pa ndonjë ngarkesë shtesë për Buxhetin e Kosovës. Siç e ceka më lart, fondi për sigurimet sociale do të jetë ai që fëmijëve tanë do t'u sigurojë sigurimin që ne po përpiqemi sot, me shumën që u diskutua këtu; 10 apo 20, apo ndryshe.

Me krijimin dhe aprovimin e ndonjë politike të re lidhur me shtesat e fëmijëve duhet të kemi kujdes në harmonizimin ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si dikaster përgjegjës për mirëqenien e qytetarëve dhe të gjitha institucioneve të tjera duke e pasur parasysh se në të kaluarën kemi pasur politika e ligje që kanë rënë ndesh me njëra-tjetrën. Dhe, pikërisht ne si ministri me reformat që jemi duke i bërë gjatë këtij viti jemi në funksion të kësaj që u cekë më lartë përfshirë këtu Reformën në Ligjin për Marrëdhënien e Punës, përfshirë këtu në Ligjin për lehonat, ligj i cili për herë të parë në historinë më të re të Kosovës trajton lehonat dhe pushimin prindëror, si lehonat e punësuara, si lehonat e papunësuara për të cilat deri me tani nuk është ngritur asnjë zë i vetëm për to.

Të mos harrojmë, po të shikohen shifrat, statistikat e lindjeve të vitit 2017 dhe po të krahasohen lehonat e punësuara me ato të papunësuara, është një shifër që ka dallime shumë të larta, dhe deri më tani asnjëherë nuk është ngrehur zëri që nëna lehonë e papunësuar të trajtohet me meritë dhe të trajtohet si duhet në vendin tonë.

Konsideroj se me krijimin e fondit për sigurime sociale do të zgjidhen edhe çështjet e shtesave për fëmijë, ashtu siç e ceka edhe më lart, njëkohësisht duke ndikuar në ngritjen e mirëqenies së fëmijëve dhe duke mos e ngarkuar Buxhetin e Kosovës edhe ashtu të rënduar. Fare në fund dua të theksoj se përveç këtyre reformave, përveç Ligjit për marrëdhënie të punës, përveç Ligjit për lehonat, përveç reformës të sistemit pensional, si ministri deri në fund të këtij viti në kuadër të reformave do të bëjmë reforma sa i përket sistemit të shërbimeve sociale dhe të asistencës sociale.

Po të shikohen analizat dhe hulumtimet të cilat bashkërisht me ekspertë të Bankës Botërore i kemi bërë, nuk na bëjnë ndihemi mirë asnjëri prej nesh këtu e as te qytetari i vendit. Prandaj, jemi duke punuar me përkushtim dhe po e përsëris për të dytën herë që ky debat po kontribuon dhe po vjen në një moment kur ne jemi fare në kurorëzim të angazhimeve tona në reformat të cilat i ceka me radhë. Edhe njëherë ju përgëzoj shumë për debatin dhe ka qenë një debat që vërtet i ka munguar kohë të gjatë këtij Kuvendi dhe veshit të qytetarëve, sepse unë mendoj që qytetari

ka nevojë t'i dëgjojë këto debate të cilat janë në interesin e tyre, të cilat prekin e përmirësimin e mirëqenies së tyre. Faleminderit!

KYESUESI: Faleminderit! Për fund, zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën për të dhënë sqarime dhe për ta propozuar një draft-rezolutë për këtë çështje.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Më lejoni që t'i falënderoj të gjithë deputetët veç e veç për mbështetjen, T'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare, sidomos një pjesë të opozitës, e cila qëndroi dhe e dha kontributin e vet në një çështje që nuk është as individuale as partiake, por e interesit të përgjithshëm.

Shpresoj që deri në seancën e radhës, meqë u dhanë shumë propozime, ne do të mbërrijmë ta harmonizojmë një rezolutë të përbashkët, e cila do të na takojë të gjithëve. Pra, do të jetë një rezolutë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e ku shpresoj që deri në seancën e radhës do të vijin edhe dy grupet parlamentare të cilat munguan sot, në mënyrë që kjo rezolutë ta ketë përkrahjen e të gjithëve dhe të jetë e plotë. Është për keqardhje që sot nuk janë, sepse kjo është një çështje me interes vital. Është çështje interesi strategjik kombëtar për vendin dhe është krejt i pakuptimtë bojkoti, ose mospjesëmarrja.

I nderuar ministër, po ashtu ju falënderoj, ju përgëzoj për punën që bëni. Sigurisht që të gjitha këto propozime janë harmonizuar dhe janë në dakordim të plotë me kryeministrin Haradinaj, i cili pavarësisht ngarkesës së madhe buxhetore, na e ka dhënë dritën e gjelbër dhe e ka shprehur vullnetin e tij maksimal që do të angazhohet në implementimin e kësaj rezolute.

Pavarësisht sa shuma e cila fillon prej 10 eurove mund të duket simbolike, jo rastësisht po e them fillon prej 10 eurove, por sigurisht që nuk do të ketë kufizime. Do të jetë e tillë sa do të kemi mundësi buxhetore që ta mbulojmë dhe do të angazhohemi që kjo shumë të jetë sa më e madhe. Edhe njëherë, me shpresë që në seancën e radhës ta kemi rezolutën e harmonizuar, i ftoj edhe dy grupet tjera parlamentare që të jenë këtu dhe ta kemi për votim në pikën e parë të rendit të ditës, menjëherë pas harmonizimit. Edhe njëherë faleminderit shumë për gjithë kontributin tuaj!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Bujupi!

Debati është shteruar, nuk ka kuorum të mjaftueshëm për t'i votuar propozimet e juaja si propozues, si grup parlamentar dhe nismën tuaj. Shpresoj që në seancën e ardhshme do të ketë kuorum të mjaftueshëm. Mirupafshim në seancën e së enjtes. Ju kisha lutur që të vini me kohë, me qëllim që ta fillojmë punën me kohë.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*